

Manual for Sustainable return

Doracak
për kthim të
qëndrueshëm



Prirucnik
za Održivi
Povratak

Botim i janarit 2003

Doracak për kthim të qëndrueshëm

Parathënie	1
Shkurtesat	2

Pjesa I. Konteksti

Ambienti për kthim	1
Parimet udhëzuese	5
Zhvendosja	7
Spektri i kthimit	9
Aktorët kryesorë	11

Pjesa II. Udhëzimet vepruese

Procesi i kthimit	1
Procedurat përmbledhëse	1
Mekanizmat e koordinimit	5
Rolet dhe përgjegjësitë institucionale	9
Komponentët e proceseve të kthimit	19
Dialogu ndërtnik dhe marrëdhëniet e bashkësive	19
Vlerësimet dhe mbledhja e informatave	21
Vizitat shko dhe informo dhe shko dhe shiko	23
Procesi i projekteve të kthimit	27
Zbatimi i projekteve të kthimit	31
Kthimi i personave të zhvendosur	33
Kthimi individual	35
Raportimi mbi aktivitetet e kthimit	35

Pjesa III. Dokumentet e zgjedhura të kornizës politike

Koncept dokumenti i UNMIK-ut mbi të drejtën për kthim qëndrueshëm	1
Programi i qeverisë për bashkësi	7
Deklarata e Asociacionit të Kuvendeve Komunale mbi integrimin dhe kthimin	9
Rezoluta e Kuvendit të Kosovës mbi kthimin	11
Standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e pakicave dhe të personave të zhvendosur	13

Shtojcat

Shtojca 1A. Formati i përmbledhjes së profilit të vendit të kthimit . . .	1
Shtojca 1B. Formati i profilit të vendit të kthimit	3
Shtojca 2 Vlerësimi i sigurisë së fshatit	11
Shtojca 3 Sugjerime mbi intervistat e vizitave shko dhe shiko . . .	15
Shtojca 4 Korniza e koncept dokumentit	17
Shtojca 5 Kriteret për konsiderimin e koncept dokumenteve nga GPK-të	21
Shtojca 6 Vlerësimi i rrezikut të vizitës	23



Nevoja për krijimin e një dokumenti për të sqaruar procedurat dhe aktivitetet mbi kthimin u shtua gjatë sezonës së kthimit të vitit 2002, kur një numër i aktorëve të përfshirë në proceset e paraqitura janë ballafaquar me çështje të veçanta lidhur me zbatimin e projekteve të kthimit. Në muajin maj të vitit 2002 UNMIK-u formuloi strategjinë e vet të kthimit përmes një koncept dokumenti, *E drejta për kthim të qëndrueshëm*. Me të shpejtë, u bë e qartë se strategjisë kishte nevojë t'i shtohet një dokument, i cili do të mund të shërbente si udhëzues praktik lidhur me mënyrën e zbatimit të parimeve të shtruarra në koncept dokument. Gjithashtu, shtrohet nevoja edhe për një kornizë gjithëpërfshirëse, e cila nuk do shtronte vetëm procedurat e zbatimit të parimeve, mirëpo do të forconte dhe do të zyrtarizonte përpjekjet e koordinimeve të shfaqura më herët. Nga aktorët e ndryshëm të kyçur në këtë proces ka lindur nevoja për përgatitjen e një dokumenti, i cili do të: (1) zyrtarizonte koordinimin mes aktorëve, duke definuar rolet dhe përgjegjësitë, (2) krijonte procedurat vendim-marrëse në organet ekzistuese të koordinimit dhe (3) të propozonte një proces standard në të cilin projektet përkatëse të kthimit do të zhvilloheshin dhe themeloheshin.

Manuali për kthim të qëndrueshëm është zhvilluar në këtë frymë, që do të thotë duke pasur parasysh kërkesat e punëtorëve në terren. Në veçanti, qëllimi i tij është që të zbardhë më tutje tablotë e kthimeve duke siguruar udhëzime në detaje mbi rolet e grupeve punuese komunale dhe rajonale për kthimet. Prandaj, ky ka në shënjestër audiencën e gjerë, e jo vetëm organet ndërkombëtare të përfaqësuar në grupet punuese por, gjithashtu, edhe Institucionet e Përkohshme Vetqeverisëse (IPVQ), autoritetet e territoreve fqinje të Kosovës, refugjatët e zhvendosur brenda Kosovës dhe donatorët.

Manuali mbetet një tentim modest për të adresuar pyetjet e shtruarra që kërkojnë sqarim. Ka tendenca që *Manuali* të përdoret si një udhëzues bazuar në përvojat më të mira që kanë ndihmuar rezultatet më të qëndrueshme për kthimin e minoriteteve.

Manuali do të mbetet një dokument i gjallë, që do t'i nënshtrohet revidimit periodik, vlerësimit dhe zhvillimit. *Manuali* më tepër ka për qëllim të bëhet një udhëzues se sa të bëhet recetë, dhe si i tillë mundëson fleksibilitet dhe me të vërtetë inkurajon strukturat zbatuese për të pasqyruar rrethanat lokale dhe për të aprovuar udhëzimet përgjatë ndryshimit të rrethanave. Është zhvilluar në një mënyrë fleksibile për të marrë parasysh specifikat e rajonit të Kosovës. Problemet të cilat hasen në udhëzimet e ofruara dhe rekomandimet për përmirësimin do të mirren parasysh në rishikimet e ardhme.

Procedurat e përmbledhura më poshtë mbi procesin e kthimit janë projektuar për të qenë fleksibile dhe për t'u përgjigjur ambientit të paparashikueshëm në të cilin zbatohet procesi i kthimit. Për të thjeshtëzuar paraqitjen e procedurave është e kuptueshme që këto vlejnjë për kthimin e "ndihmuar" të grupeve të personave të zhvendosur/ refugjatëve dhe për paraqitjen e listave të projekteve të kthimit donatorëve për t'u përgjigjur nevojave të identifikuar të personave potencial për kthim, për çka kërkohet financim. Sidoqoftë, vet natyra e kthimeve spontane individuale, e cila deri më sot paraqet shumicën e kthimit të gjithmbarshëm mund të kërkojë një përgjigje më të përshpejtuar. Kapitulli në vijim i quajtur "Spektri i kthimeve" i adresohet kësaj çështjeje. Më tutje, ciklet e financimit të donatorëve dallojnë, dhe mund të mos përputhen me procedurat e skicuarra në vijim. Shpesh, donatori do t'i qaset Organizatës joqeveritare me ndonjë kërkesë për koncept dokument dhe/apo propozime të cilat ata mund ti financojnë. Në shumë nga këto raste, ekziston kufizimi kohor, dhe OJQ-të duhet të reagojnë shpejt për të siguruar financim. Për këtë arsye grupet punuese të komunave duhet të llogarisin që koncept dokumentet mund të dorëzohen për t'u nënshkruar nga ana e tyre gjatë tërë vitit, dhe se procedurat për nënshkrim të menjëhershëm duhet të kryhen. Udhëzimet vepruese përshkruajnë qasjen e thjeshtëzuar, e cila do të shfrytëzohet në këto rrethana.

Shkurtesat

AK	Administratori komunal i UNMIK-ut	OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
BE	Bashkësia Evropiane	PSHL	Profili i shpejtë i vendit
BKT	Bordi këshilldhënës teknik	PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
CIMIC	Bashkëpunimi civilo-ushtarak i KFOR-it	PZHBV	Personat e zhvendosur brenda vendit
CIVPOL	Policia civile e UNMIK-ut	RAE	Bashkësitë e romëve, ashkalinjëve, egjiptianëve
DÇBP	Drejtoria për çështje banesore dhe pronësore	RKSKB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
GKK	Grupi për koordinimin e kthimit	SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
GPK	Grupi punues komunal	UNHCR	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
GPK	Grupi punues mbi kthimin	UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
GPR	Grupi punues rajonal	VSHI	Vizita shko dhe informo
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes	VSHSH	Vizita shko dhe shiko
KB	Kombet e Bashkuara	ZKB	Zyra për kthime dhe bashkësi
KFOR	Forcat e Kosovës	ZBL	Zyra e UNMIK-ut për bashkësi lokale
KPA	Këshilli i Përkohshëm Administrativ	ZPSSP	Zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm
NATO	Organizata e Paktit të Atlantikut Verior	UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
OJQ	Organizatë joqeveritare		

Hyje

Në angazhimin aktiv për përkrahjen e kthimit të personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) dhe të refugjatëve në shtëpitë e tyre në Kosovë, është e nevojshme që të merret parasysh konteksti më i gjerë brenda të cilit është duke u realizuar kthimi. Në këtë seksion, *Doracaku për kthim të qëndrueshëm* ofron një paraqitje të shkurtër të ambientit social dhe politik në të cilin kthimi është duke u realizuar. Doracaku gjithashtu planifikon kushtet për të cilat duhet kujdesur në mënyrë që të respektohet kthimi i rregullt. Ky kapitull gjithashtu rishikon parimet të cilat duhet t'i udhëheqin aktivitetet që janë ndërmarrë nga ana e secilit aktor, së bashku me një analizë të shkurtër të bashkësive të synuara në procesin e kthimit. Kapitulli mbaron me një rezymë të gjerë të aktorëve kryesorë, përfshirë këtu institucionet ndërkombëtare dhe vendore.



Ambienti për kthim

Ambienti i favorshëm për kthim është ai që mundëson kthimin e sigurt dhe dinjitoz, gjë që pasqyron një ndryshim të rëndësishëm në situatën e cila fillimisht ka shkaktuar ikjen. Në mënyrë që kthimi të realizohet, përmirësimet janë shumë të rëndësishme në aspektin e sigurisë dhe të drejtave të pakicave, së bashku me garancionet ligjore për zbatimin e tyre. Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara (1999) detyron praninë ndërkombëtare të sigurisë (KFOR-in) që ta sigurojë një ambient të sigurt "në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen të sigurt në shtëpitë e tyre, ku mund të veprojnë prania civile ndërkombëtare, dhe ku mund të vendoset një administratë kalimtare", deri në momentin në të cilin prania civile ndërkombëtare të jetë në gjendje të marrë përsipër përgjegjësinë për të mundësuar "sigurinë dhe rendin publik". Prania ndërkombëtare civile (UNMIK-u) nuk është përgjegjëse vetëm për të "mundësuar kthimin e sigurt dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë", por gjithashtu, në një pikëpamje më të gjerë, për ta "mirëmbajtur ligjin dhe rendin civil" dhe për ta vendosur një polici vendore. Për këtë arsye, si KFOR-i, ashtu edhe UNMIK-u kanë përgjegjësi dhe role kryesore për të luajtur në kontekst të mbrojtjes së pakicave në

Kosovë, si dhe në kthimin e papenguar të refugjatëve dhe PZHBV-e.

Krijimi dhe mirëmbajtja e një ambienti të sigurt në kontekstin e marrëdhënieve të vështirësuar ndëretnike kërkon përgjigje që tejkalon sigurimin e mjaftueshëm të mbrojtjes policore dhe ushtarake. Ndalimi i thjeshtë i kërcënimeve të sigurisë pa iu adresuar shkaktarëve thelbësorë të pasigurisë dhe mostolerancës, në fund të fundit, do ta pengojë kthimin substancial, pasi që një kthim i tillë do ta sfidonte stabilitetin e pasigurt që është arritur. Për këtë arsye, në masë më të madhe është duke u zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe proaktive. Përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike është pjesa qendrore e kësaj strategjie, e cila synon një ndryshim rrënjësor të situatës së sigurisë. Si rrjedhojë, kjo duhet të mundësojë një numër më të madh të kthimit të pakicave.

Kthimi i pakicave etnike është përgjegjësi e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, por gjithashtu edhe e bashkësia ndërkombëtare, siç ceket në Kornizën Kushtetuese - "Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur nga Kosova do të kenë të drejtë të kthehen në shtëpitë e tyre, dhe ta rikthejnë pronën dhe pasurinë e tyre. Institucionet

dhe organet kompetente të Kosovës do t'i ndër-marrin të gjitha masat e nevojshme për ta ndihmuar kthimin e sigurt të refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në Kosovë, dhe do të bashkëpunojnë plotësisht me të gjitha përprjekjet e bëra nga UNHCR-ja dhe organizatat e tjera ndërkombëtare dhe joqeveritare në lidhje me kthimin e refugjatëve dhe të personave të zhvendosur."

Kthimi i pakicave gjithashtu është një standard kryesor përmes të cilit është duke u matur përparimi në Kosovë. Kjo është njohur përmes nënshkrimit të kryeministrit të vendosur në *Strategjinë e parimeve të përbashkëta për kthim*¹ dhe me miratimin, nga ana e Kuvendit të Kosovës, të *Rezolutës mbi të drejtat e bashkësive dhe pjesëtarëve të tyre dhe mbi kushtet për kthimin e PZHBV-e dhe refugjatëve*.² Këto dokumente u pasuan me deklarata të shumta publike të politikanëve të nivelit të lartë në përkrahje të kthimit dhe integritet të bashkësive pakicë; sidoqoftë, shumë gjëra mbeten për t'u bërë për t'i kthyer deklaratat e tilla në marrje të përgjegjësive dhe pranim të mirëfilltë të kthimit të pakicave në nivelet komunale dhe nivelet bazë. Zyrtarët shqiptarë të Kosovës ende kanë një tendencë të qartë që ta vështrojnë kthimin si përgjegjësi të bashkësisë ndërkombëtare, pa marrë përgjegjësi mbi vete.

Përfshirja e zyrtarëve shqiptarë të Kosovës kërkon fillimisht dhe kryesisht pranimin që PZHBV-të / refugjatët janë pjesë qendrore e elektoratit të tyre, me të cilët ata kanë obligim të komunikojnë. Cilësia dhe rregullsia e kësaj përfshirjeje dallon mjaft shumë nëpër rajone, me një shtrirje prej bashkëpunimit produktiv, në rastet më të mira, deri në bojkotim dhe pengim, në rastet më të këqija. Në shumicën e vendeve, pjesëmarrja e shqiptarëve të Kosovës në procesin e kthimit ka filluar vetëm në fillim, apo nga mesi i vitit 2002. Në përputhje me këtë, pjesëmarrja e autoriteteve të



bashkësive shumicë në strukturat e kthimit në shumicën e vendeve është në një fazë të hershme.

Po ashtu e rëndësishme është edhe gatishmëria e pakicave për të marrë pjesë në strukturat e IPVQ-ve dhe në ngjarjet që po zhvillohen. Përderisa romët, ashkalinjtë, egjiptianët dhe boshnjakët vullnetarisht iu kanë bashkangjitur administratës së re të Kosovës, pjesëmarrja e serbëve të Kosovës ka qenë sporadike në të shumtën e rasteve. Serbët e Kosovës kanë pak besim në administratën e tanishme të Kosovës për t'i mbrojtur të drejtat e tyre.

Edhe pse situata e sigurisë dhe efikasiteti i administratës për t'i mbrojtur të drejtat e pakicave është përmirësuar dukshëm që nga viti 1999, kjo megjithatë ka mundur kthimin e vetëm një numri të vogël të personave të zhvendosur. Marrëdhëniet jostabile ndëretnike, pasiguria dhe liria e kufizuar e lëvizjes, mungesa e besimit në sundimin e ligjit dhe në zbatimin e të drejtave pronësore, si dhe mungesa e mundësive materiale dhe ekonomike në vendin e kthimit vazhdojnë të ndikojnë dëmshëm në procesin e kthimit. Përmirësimet e mëturshme substanciale janë të nevojshme për ta mundur kthimin e personave të zhvendosur, pa marrë parasysh vendin e tyre të prejardhjes dhe përkatësinë e tyre etnike.

Perspektiva për kthim dallon në masë mjaft të madhe varësisht nga rajoni, madje edhe brenda çdo rajoni, si dhe ndërmjet grupeve të ndryshme etnike. Në disa vende, PZHBV-të / refugjatët, duke pasur dëshirë të madhe për t'u kthyer, e kanë arritur këtë nëpërmjet vendosjes së kontakteve me komunitatet dhe bashkësitë pritëse. Në vende të tjera, një rivendosje e tillë e dialogut dhe përfitimit të përkrahjes së bashkësive pritëse kërkon më shumë përprjekje dhe kohë.

Përderisa disa romë, ashkalinj dhe egjiptianë (RAE) kanë përjetuar përparime në marrëdhënie me popullatën shumicë,

¹ Dokumenti është i paraqitur në seksionin Dokumente të zgjedhura të kornizës politike të këtij doracak.

² Ibid.

siguria mbetet brengë kryesore, posaçërisht për romët. Shqiptarët e Kosovës i grupojnë romët me serbët e Kosovës. Sidoqoftë, në disa raste, kundërshtimi ndaj kthimit është i motivuar nga interesat materiale, siç janë zënia e shtëpive apo uzurpimi i tokës.

Kundërshtimi ndaj kthimit të serbëve të Kosovës është posaçërisht i përhapur dhe i ka rrënjët e thella, dhe shprehet në mënyra të ndryshme, që sillen prej demonstratave dhe armiqësisë së plotë, drejt përpjekjeve për t'i rivendosur marrëdhëniet ndëretnike, e deri te rastet e ngurrimit dhe zvarritjes. Në përgjithësi, bashkëveprimi në nivelin bazë ndërmjet bashkësive të ndryshme është ngritur me shpejtësi gjatë vitit 2002. Edhe pse kjo ka ndihmuar në ndërtimin e tolerancës ndëretnike, nuk do të thotë se kjo ka arritur në proces të pajtimit dhe të pranimit të kthimit pa ndihmë dhe përpjekje.

Përpos sigurisë, të drejtave të pakicave dhe marrëdhënieve ndëretnike, strehimi është një aspekt fundamental i procesit të kthimit dhe integritimit. Shtëpitë e pabanueshme apo të uzurpuara në mënyrë paligjshme, si dhe infrastruktura e dëmtuar, apo e shkatërruar sociale, e dobësojnë mundësinë e PZHBV-e / refugjatëve për ta ushtruar të drejtën e tyre të kthimit, pasi këta janë faktorë me rëndësi në lehtësimin e vetëpërkrahjes. Deri në kohët e fundit çështja e strehimit dhe rindërtimit ka qenë sekondare në vendimin e PZHBV-e / refugjatëve për t'u kthyer, pasi pengesa kryesore mbetet siguria. Sidoqoftë, çështja e rindërtimit, pa marrë parasysh a ka qenë në pyetje strehimi, infrastruktura sociale apo që të dyja, është duke u bërë përcaktues gjithnjë e më i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e kthimit. Gjithashtu, një pjesë mjaft e madhe e akomodimit që u përket personave të zhvendosur është zënë në mënyrë paligjshme. Mungesa e rindërtimit të shtëpive i shtyn PZHBV-të / refugjatët të kthehen në gjendje të zhvendosjes së brendshme, zakonisht në shtëpitë e familjeve strehuese, që janë të stërmbushura dhe të paqëndrueshme. Disa të kthyer mund të kthehen përsëri në vendin e tyre të zhvendosjes nëse nuk kanë mundësi të kenë qasje në ndihmë me rastin e kthimit të tyre. Për të njëjtën arsye, nëse, përveç strehimit, nuk i kushtohet vëmendje rehabilitimit apo rindërtimit të infrastrukturës sociale dhe shërbimeve publike tek bashkësitë që kthehen, bashkësitë e dobëta dhe të

paqëndrueshme vendore efektivisht ndalojnë mundësinë e kthimit të një numri më të madh të PZHBV-e / refugjatëve.

Gjithashtu duhet të bëhen përpjekje për përmirësimin e ambientit në të cilin PZHBV-të / refugjatët do të mund të ktheheshin; ky doracak mundohet ta përshkruajë mënyrën si PZHBV-të / refugjatët mund të kenë qasje në ndihma me rastin e kthimit dhe të marrin pjesë aktive në procesin e kthimit. Strategjia e kthimit e vitit 2003 i vë theks më të madh angazhimit të të gjitha bashkësive për



lehtësimin e kthimit krahasuar me procesin ekzistues, i cili kryesisht drejtohet nga ndërkombëtarët.

Në këtë kontekst, lehtësimi i procesit të kthimit meriton një qasje shumëplanëshe, duke marrë parasysh veçantitë e ambientit vendor dhe problemet të cilat paraqiten në secilin rast, për të siguruar se respektohet e drejta e secilit person për t'u kthyer.

Parimet udhëzuese

UNMIK-u e ka bërë të qartë politikën e vet ndaj kthimit në një koncept dokument mbi "*E drejta për kthim të qëndrueshëm*"³, në maj të vitit 2002. Ky koncept dokument paraqet parimet bazë të cilat e udhëzojnë qasjen e UNMIK-ut në procesin e kthimit. Më poshtë është paraqitur një përmbledhje e parimeve kryesore të cilat e udhëzojnë procesin e kthimit.

Qëndrueshmëria

Sigurimi i qëndrueshmërisë sociale dhe ekonomike për të kthyerit është shumë i rëndësishëm. PZHBV-të / refugjatët dëshirojnë të kthehen, dhe aftësia e tyre fizike për ta bërë këtë arrihet vetëm nëse ata janë në gjendje të jetojnë në mënyrë paqësore dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në bashkësinë e tyre. Katër kushte bazë nevojiten për të siguruar qëndrueshmërinë e kthimit: (1) siguria dhe liria e lëvizjes, (2) qasja në shërbimet publike (shërbimet komunale, shërbimet sociale, arsim dhe kujdes shëndetësor), (3) qasja në strehim (p.sh., nëpërmjet riposedimit të efektshëm të pronës, apo ndihmës në rindërtimin e shtëpive, në ato raste ku është e nevojshme) dhe (4) realizueshmëria ekonomike përmes qasjes së drejtë dhe të barabartë të mundësive për punësim.

Kthimi i bazuar mbi të drejtën

Ngjarjet në Ballkan kanë treguar se qasja e kthimit të bazuar mbi të drejtën ka më tepër gjasa për të siguruar kthime vullnetare dhe të qëndrueshme. Kjo qasje depolitizon çështjen e kthimit dhe zvogëlon tendencën për kthim të motivuar nga qeveria apo vendosjen e kushteve për realizimin e kësaj të drejte. Kjo e drejtë zbatohet për të gjitha bashkësitë etnike dhe për të gjitha vendet e zhvendosjes, qoftë ajo në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi, apo në vende të tjera.

Kthimi në vendin e prejardhjes

Bashkësia ndërkombëtare i jep prioritet ofrimit të ndihmës për të kthyerit në vendin e prejardhjes (kthimin në shtëpi të paraluftës,) kundrejt kthimit në vend të zhvendosur (kthimi përbrenda kufirit të paraluftës apo në komunë, por jo edhe në shtëpinë e paraluftës). Kjo qasje është esenciale si për arsye praktike, ashtu edhe për arsye parimore. Dhënia e

prioritetit kthimit në shtëpi të prejardhjes është më praktike, pasi që shumë prej tyre mund të kthehen në vend të zhvendosur, por mbajnë shpresë me arsye se eventualisht sërish të kthehen në shtëpinë e tyre të paraluftës, ku ata mund t'i rivendosin lidhjet e tyre me bashkësinë dhe sërish të integrohen. Në një ambient me burime të kufizuara duhet të theksohet opcioni më i dobishëm dhe më i realizueshëm i kthimit të drejtpërdrejtë në shtëpinë e paraluftës. Kjo çështje gjithashtu qartëson pse vënia e theksit në kthimin në vendin e prejardhjes është gjithashtu mënyra më e mirë për të siguruar respekt për të drejtën në kthim. Sapo të përkrahen kthimet në vendin e zhvendosjes, mundësia për t'u siguruar njerëzve alternativë të vërtetë për t'u kthyer në shtëpitë e tyre zvogëlohet, dhe do të ketë gjasa më të mëdha që zhvendosja e dytë të jetë e përherëshme. Përpos këtyre argumenteve, alternativa e sjelljes së tyre në vend me anë të aeroplanëve është refuzuar në diskutimet mbi kthimin e detyrueshëm nga jashtë.

Qasja nga poshtë-lart, dhe ajo e drejtuar nga PZHBV-të

Nevojat e të kthyerve identifikohen dhe përkrahen bazuar në shprehjen e interesit nga ana e të zhvendosurve. Kjo qasje është edhe parimore edhe praktike. Kjo pasqyron një qasje të bazuar në të drejta në të cilën individët janë në gjendje të marrin pjesë në vendimet që ndikojnë në ardhmërinë e tyre, dhe për t'u pajisur me informata të nevojshme për të marrë vendime të vërteta. Çështja më e rëndësishme është se planet e kthimit nuk do të konkretizohen pa pasur një angazhim të vendosur nga ana e personave të zhvendosur. Kjo gjithashtu pasqyron një llogaritje pragmatike sipas të cilës proceset që përfshijnë bashkësitë lokale dhe PZHBV-të kanë më së tepërmi gjasa për të qenë të qëndrueshme. E kundërta është gjithashtu e vërtetë: një qasje nga lart-poshtë ndaj të kthyerve në kontekstin e Kosovës ka gjasa që t'i vendosë qëllimet politike para të drejtave individuale dhe gjithashtu është, për shumë arsye, e paqëndrueshme për nga natyra.

³ Dokumenti është i paraqitur në seksionin Dokumente të zgjedhura të komizës politike të këtij doracak.

Angazhimi i tërë bashkësisë

Dialogu ndëretnik dhe aktivitetet e bashkësive janë primare për kthim të qëndrueshëm. Projektet e suksesshme të kthimit përfshijnë aktivitete specifike që kanë për qëllim përkrahjen e dialogut ndëretnik dhe inkurajimin e tolerancës dhe mirëkuptimit.

Është me rëndësi të ceket se iniciativat e tilla kërkojnë kohë për t'u zhvilluar dhe zbatuar, por përpjekja në fazat e hershme në procesin e kthimit mund t'i parandalojë vështirësitë e mëvonshme.

Projektet e kthimit të cilat ofrojnë ndonjë nivel të përfitimit për bashkësinë si tërësi kanë më tepër gjasa për të funksionuar.

Zhvendosja

Komiza ligjore

Sipas standardeve ndërkombëtare, refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtën fundamentale humane për t'u kthyer në shtëpitë e tyre, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, në mënyrë spontane, të organizuar apo të ndihmuar. Kjo është në pajtim me Rezolutën 1244 të OKB-së (1999), Kornizën Kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Këto standarde⁴ përbëjnë bazën për kornizën e UNMIK-ut për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe politikën e kthimit për Kosovën.

Definicionet

Persona të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) janë personat apo grupet që janë detyruar apo obliguar të largohen nga shtëpitë e tyre, apo vendet e zakonshme të banimit, posaçërisht si rrjedhojë e luftës së armatosur, apo përpjekjes për t'iu shmangur asaj, situatat e dhunës së përgjithësuar, shkeljet e të drejtave njerëzore apo katastrofat e shkaktuara nga natyra ose njeriu, dhe të cilët nuk kanë kaluar ndonjë kufi të ndonjë shteti të njohur ndërkombëtarisht. Në Kosovë, ne u referohemi këtyre individëve dhe familjeve të cilat jetojnë përbrenda kufije të Republikës Federale të Jugosllavisë si PZHBV.

Refugjati, sipas nenit 1 të Konventës së Gjenevës mbi Refugjatët, është "personi i cili gjendet jashtë shtetit të tij / saj kombëtar, apo banimit të zakonshëm; ka frikë të arsyeshme të ndjekjes penale për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësismit në ndonjë grup të posaçëm social apo mendim politik; dhe nuk është në gjendje apo nuk ka dëshirë që të jetë nën mbrojtjen e atij vendi, apo të kthehet atje, për shkak të frikës nga ndjekja penale."

Llojet e zhvendosjes

PZHBV-të / refugjatët brenda Kosovës dhe jashtë saj jetojnë në kushte të paqëndrueshme dhe shpesh të papranueshme në vende të cilat nuk janë vendi i tyre i prejardhjes. Vendi i zhvendosjes së familjeve dhe individëve kryesisht përcaktohet nga perceptimet e familjeve / individëve mbi nivelin e sigurisë së vendit dhe aftësinë e tyre për ta mbajtur një vendbanim të përkohshëm për shkak të pranisë së pjesëtarëve të tjerë të bashkësisë së zhvendosur që ofrojnë përkrahje dhe mekanizma të përballimit (p.sh. familjet mikpritëse).

Para vitit 1999, Kosova përbëhej prej fshatrave njëetnike dhe të përziera. Edhe pse shumica e



PZHBV-e / refugjatëve kanë ikur nga Kosova si pasojë e luftës, një numër mjaft i madh i pjesëtarëve të bashkësisë pakicë kanë mbetur në Kosovë. Disa fshatra, të cilat më parë kanë qenë shumetnike, janë braktisur, dhe një numër i madh i banorëve të tyre janë shpërngulur në fshatrat fqinje duke kërkuar siguri. Në shumë raste, personat që kanë jetuar në qytete dhe qytetëza më të mëdha shumetnike, siç është Prishtina, e kanë lëshuar vendin për të jetuar në qytetëza njëetnike, ku ata

mendonin se do të gjenin një ambient më të sigurt. Në disa raste, këta persona i kanë zënë shtëpitë e braktisura. Kjo mund të shpjegohet deri tek zhvendosja e dytë kur pronarët e parë dëshirojnë të kthehen, pasi nuk kanë ku të shkojnë. Përveç kësaj, këta persona shpesh janë të punësuar në fabrika apo institucione qeveritare në zona urbane dhe mund të mos jenë në gjendje të vazhdojnë ta mbajnë vetëvehten në një mjedis bujqësor.

Shumica e PZHBV-e / refugjatëve jetojnë jashtë Kosovës, në Serbi dhe Mal të Zi, dhe në IRJ të Maqedonisë, përderisa një numër më i vogël

⁴ Shih seksionin Dokumente të kornizës politike, Standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e pakicave të PZHBV-e.

gjithashtu jeton në vende të tjera të Evropës. Varësisht nga kapaciteti që bashkësia mikpritëse mund të pranojë, shumica e PZHBV-e / refugjatëve jetojnë me familjet mikpritëse apo në kampe. Shoqatat e PZHBV-e / refugjatëve janë formuar duke ofruar informata dhe ndërlikime dialogu për agjencitë e angazhuara në lehtësimin dhe menaxhimin e programeve të kthimit.

Situata në Kosovë nuk dallon në mënyrë rrënjësore. Familjet mikpritëse në vende urbane dhe rurale ofrojnë vendbanim për PZHBV-të / refugjatët, por akoma mbetet një numër i madh i familjeve të pakicave etnike që banojnë në objekte të menaxhuara të kampeve (p.sh. ashkalinjtë në kampin e Plemetinës dhe në komunën e Obiliçit dhe serbët në qendra kolektive në Brezovicë, komuna e Shtërpcës). Qasja e PZHBV-e / refugjatëve në shërbimet publike, lirinë e lëvizjes dhe mundësitë e jetesës ekonomike mbetet një sfidë.

Situata për pakicat në bashkësitë njëetnike dhe shumetnike në Kosovë, që është larg një situatë të kënaqshme, është përmirësuar gradualisht gjatë tri vjetëve të fundit. Sidoqoftë, liria e lëvizjes mbetet problem i vërtetë në Kosovë, dhe qasja në shërbimet përkatëse publike dhe mundësitë për punësim nuk janë zhvilluar në tërësi. Pjesëtarët e bashkësive pakicë vazhdojnë të jenë cak i ngacmimeve, kërcënimeve dhe dhunës së bazuar në përkatësinë e tyre etnike.


Spektri i kthimit

Dy kategori të përgjithshme të kthimit janë diskutuar shpeshherë: "të organizuara" dhe "spontane". Në fakt, këto dy forma të kthimit janë dy kuptime të ndryshme të spektrit të njëjtë, të bazuar në shkallën e organizimit ose të ndihmës së përfshirë. Çështja primare është që korniza vepruese të jetë fleksibile në masë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur secilit skenar të ndryshëm. Aksioni i duhur përcaktohet pjesërisht në atë se ku qëndron spektri i kthimit. Doracaku ka për qëllim ta drejtojë aksionin e përshtatshëm, me theks në shkallët dhe strukturat vepruese të cilat janë të nevojshme, dhe në raport me më shumë kthime të organizuara. Qasja shumësektorale, siç është theksuar në doracak, është vendimtare, duke mbuluar në hollësi të gjitha aspektet e mundshme të projektit të kthimit. Natyrisht, pasi secila situatë dallon nga pak, shumë projekte do të pasojnë në proces më të shkurtër sesa ky. Për shembull, në disa raste paraqitet vetëm një nevojë e vogël për dialog të zgjeruar ndëretnik, pasi rrethanat tashmë janë të favorshme për kthimin; së këndejmi përqëndrimi i vëmendjes do të jetë më i madh në përkrahje, si ndihma në rindërtim dhe në krijimin e të ardhurave. Në rastet e tjera, fondet tashmë mund të jenë në dispozicion dhe OJQ-të mund të jenë të gatshme të fillojnë - po, janë në pritje të miratimit nga grupi punues komunal. Asnjë nga këto nuk duhet t'i dekurajojë familjet individuale që të kthehen vetë, me ndihmë minimale. Në raste të këtilla, ndihma duhet të jetë në dispozicion për ta siguruar qëndrueshmërinë dhe integrimin e qetë pas kthimit.

Me rastin e të spektrit të gjerë të kthimit dhe llojeve të shumta të përgjigjeve të cilat ky spektër i përfshin, ekzistojnë dy pika kryesore. Së pari, strukturat bazë të procesit të kthimit (grupet punuese komunale dhe rajonale, grupi për koordinimin e kthimit dhe grupi punues për kthim) janë formuar për ta ofruar përkrahjen e plotë për gjithë vargun e aktiviteteve të kthimit. Prandaj, për shembull, grupet punuese komunale do ta luajnë rolin e tyre si në nënshkrimin e projekteve të organizuara të kthimit, ashtu edhe në identifikimin e përfituesve të mundshëm për ndihmë nga një fond fleksibil për kthime individuale.

Së dyti, asnjë vend që më parë është banuar nga personat të cilët aktualisht janë të zhvendosur nuk duhet të përjashtohet si "jo i favorshëm për kthim" në baza sociale, politike apo ekonomike. Vendet e

mundshme të kthimit gjithashtu bien në një spektër, bazuar në atë sa të favorshme ato janë momentalisht për kthimet. Duke marrë parasysh vargun e gjerë të aktiviteteve të mundshme të kthimit, është me rëndësi të mos përqëndrohemi vetëm në fushat të cilat aktualisht konsiderohen të favorshme për kthim. Në veçanti, ekziston mundësia e "depërtimit" për t'i bërë vendet individuale dukshëm më të favorshme për kthimin. Ky veprim do të kishte ndikim në një hapësirë të gjerë. Pasi secila situatë dallon, qasja shumësektorale duhet të mirëmbahet, megjithatë, me theks të ndryshëm të vendosur në çdo sektor për t'i pasqyruar nevojat e ndryshme të rrethanave vendore. Një nivel tjetër i prioritetit mund t'i jepet çdo sektori varësisht nga nevojat: (1) marrëdhëniet ndëretnike dhe integrimi i bashkësive, 2) qëndrueshmëria ekonomike, 3) infrastruktura dhe shërbimet e bashkësisë, 4) rindërtimi i shtëpive, 5) siguria dhe liria e lëvizjes. Përderisa ka mjete të ndryshme për ta filluar punën në vende të cilat janë më pak të favorshme për kthimin e tanishëm, nuk duhet mbështetur në masa të papërshtatshme për ta krijuar një ambient më të favorshëm për kthim. Për shembull, ndërmarrja e hapave për ta ndërtuar besimin në organet vendore për zbatimin e ligjit (dialogu, patrullimi i bashkësisë, patrullimi i shtuar) është e përshtatshme, por të jeni të varur nga pikat e caktuara të kontrollit dhe kufizimet e lirisë së lëvizjes për të garantuar siguri nuk është e përshtatshme.



Aktorët kryesorë



Bashkësia e donatorëve

Bashkësia e donatorëve luan një rol të rëndësishëm në realizimin e kthimit dhe në integrimin e bashkësive

pakicë në Kosovë. Bazuar në nevojat e identifikurara nga strukturat e kthimit, të përshkuara në doracak, së bashku me partnerët e saj kryesorë, donatorëve u paraqiten projekte me prioritete të ndërlidhura me kthimin dhe integrimin e të zhvendosurve në vendet e tyre të prejardhjes në Kosovë. Përpos pranimit të kërkesave për financimin e projekteve shumësektorale për financim, donatorët mund të luajnë një rol aktiv në proces duke marrë pjesë në grupet punuese rajonale në mënyrë që të ngritet afërsia e tyre me ambientin të cilin ata janë duke u përpjekur ta përkrahin.



Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes

IPVQ-të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në çdo fazë të procesit të kthimit dhe të integrimin të bashkësive pakicë.

Ardhmëria e një Kosove shumëtnike varet krejtësisht nga aftësia e zyrtarëve të qeverive lokale për t'i angazhuar të kthyerit e mudshëm në dialog, në nxitjen e tolerancës dhe pranimin e të drejtës së tyre për t'u kthyer, si dhe në inkurajimin e pjesëmarrjes së tyre në strukturat e përkohshme të qeverisë. Kthimi i suksesshëm dhe i qëndrueshëm varet nga aftësia e IPVQ-ve për ta siguruar qasjen e pakicave dhe të të kthyerve në shërbimet publike dhe sociale dhe inkurajimin e pranimit të të kthyerve në bashkësitë e tyre. Zyra e kryeministrit, ministrinë si dhe autoritetet komunale janë përgjegjëse për ta siguruar respektimin e të drejtave të pakicave, dhe që e gjithë legjislatura, programet dhe iniciativat, të respektohen plotësisht sipas të drejtave të bashkësisë pakicë.



Organizatave joqeveritare

Organizatave joqeveritare (OJQ-të) janë partnerët kryesorë zbatues në projektet e kthimit dhe integrimin.

OJQ-të gjithashtu paraqiten me një rëndësi të veçantë në angazhimin me bashkësitë e zhvendosura anembanë kufirit administrativ të Kosovës. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në grupet punuese komunale, përfshirë këtu definimin e përgjigjeve ndaj nevojave të përcaktuara. Një numër i madh i organizatave me mandate të ndryshme vepruese marrin pjesë në strukturat e koordinimit të kthimit dhe në bashkësitë e zhvendosura për të hartuar dhe zbatuar projekte. Këto mund të përqëndrohen në një sërë aktivitete: në dialogun ndëretnik dhe ndërtimin e besimit; në rindërtimin e shtëpive, në krijimin e të ardhurave, në zhvillimin e bujqësisë, në rehabilitimin e infrastrukturës; në përkrahjen për përmirësimin e shërbimeve publike dhe të bashkësisë.



Komesariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)

Mandati i përgjithshëm i UNHCR-së është për t'i mbrojtur refugjatët dhe për të gjetur zgjidhje afatgjata në gjendjen e refugjatëve.

Përveç kësaj, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara i ka dhënë mandatin UNHCR-së për t'u angazhuar për personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV) në ish-Jugosllavi. Sipas Rezolutës 1244, Shtojca 2, të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, kthimi i sigurt dhe i lirë i të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur duhet të kryhet nën mbikëqyrjen e UNHCR-së. Së bashku me UNMIK-un, UNHCR luan një rol kryesor, si në krijimin, ashtu edhe në zbatimin e politikës së kthimit, dhe është aktor aktiv në të gjitha nivelet e procesit të kthimit.



Zyra për kthime dhe bashkësi

UNMIK-u ka themeluar Zyrën për kthime dhe bashkësi (ZKB) në fund të vitit 2001 për t'u

përgjigjur përqëndrimit i cili është në rritje e sipër dhe mundësive për kthimin e pakicave në Kosovë. ZKB-ja luan një rol me rëndësi në ofrimin e udhëzimeve strategjike përsa i përket koordinimit të kthimit. Ajo gjithashtu përkrah përpjekjet ndërmjet shtyllave për t'i përmirësuar kushtet e jetesës dhe ofrimin e një ambienti të qëndrueshëm për kthim dhe për bashkësitë që mbeten në Kosovë.



SHTYLLA I

- Policia dhe Drejtësia

Policia e UNMIK-ut është autoritet për zbatimin e ligjit në Kosovë. Sipas Rezolutës 1244

të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK-u ka ofruar zbatimin e përkohshëm të ligjit, duke mbajtur një prani të policisë ndërkombëtare dhe duke vendosur një polici lokale. Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK), që është shërbim profesional dhe i pavarur. Policia e UNMIK-ut përqëndrohet në mbajtjen e rendit publik, parandalimin e krimit, kontrollimin e kufijve dhe të imigrimit.

Departamenti i UNMIK-ut për drejtësi administron gjykatat lokale dhe, me ndihmën e Policisë së UNMIK-ut, siguron qasjen e lirë dhe të drejtë në sistemin e drejtësisë për pakicat, duke përfshirë këtu edhe të kthyerit. Për të siguruar paanshmëri dhe pavarësi, UNMIK-u ka punësuar gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë për t'u ballafaquar me çështje delikate të cilat kanë të bëjnë me krime ndëretnike apo raste në të cilat ekziston ndonjë rrezik serioz i animit.



SHTYLLA II - Administrata civile e UNMIK-ut

Administratat komunale janë një aktor kryesor organizativ në procesin e kthimit. Ato

luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin që procesi të mbështetet në qasjen "nga poshtë-lart". Zyrtarët ndërkombëtarë të UNMIK-ut të cilët punojnë në komuna janë përgjegjës për menaxhimin e grupeve punuese komunale dhe për kujdesin që këto organe të jenë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë këtu përfaqësuesit e bashkësive të PZHBV-e / refugjatëve dhe zyrtarët e komunave. Me rastin e lehtësimit të punës nga ana e grupeve punuese komunale, komunat garantojnë përfshirjen e departamenteve të tyre në rastet kur kjo është e rëndësishme. Zyrtarët komunale me mandate të specializuara, siç janë planifikimet urbane, departamentet kadastrorë apo të bujqësisë, kanë një lidhje të posaçme për projektet e kthimit dhe mund të ndihmojnë në zbatimin e tyre të suksesshëm. Administratat rajonale të UNMIK-ut mbikëqyrin tërë procesin e kthimit, ofrojnë ndërlidhje ndërmjet komunave dhe mekanizmave qendrorë të koordinimit, dhe komunave u ofrojnë mbikëqyrje, koordinim dhe udhëzime.



SHTYLLA III - OSBE-ja

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) punon aktivisht në krijimin e një ambienti në të cilin

kthimi i qëndrueshëm mund të realizohet. Si shtyllë e UNMIK-ut për ndërtimin e institucioneve, OSBE-ja luan një rol të rëndësishëm në procesin e kthimit dhe integritet në Kosovë. Kryesisht, departamentet e OSBE-së për të drejtat e njeriut, për zbatimin e ligjit dhe për demokratizim, veprojnë për të siguruar që strukturat ekzistuese qeveritare, gjyqësore dhe demokratike veprojnë sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe legjislaturës së Kosovës, e cila është në fuqi, lejojnë qasje në shërbime pa diskriminim, dhe ngrisin mundësinë e të kthyerve për të qëndruar në Kosovë.



SHTYLLA IV

- Bashkësia Evropiane

Shtylla e katërt e UNMIK-ut nën udhëheqjen e Bashkësisë Evropiane (BE-

së), Shtylla e Bashkësisë Evropiane është duke punuar drejt ringjalljes dhe modernizimit të strukturës ekonomike të Kosovës. Duke mbikëqyrur dhe koordinuar rindërtimin e infrastrukturës fizike dhe duke drejtuar procesin e ndryshimit të menaxhimit, shtylla e Bashkësisë Evropiane është duke krijuar një ekonomi të bazuar në treg për t'ia ofruar Kosovës mundësinë e integritet të mëtejshëm ndër fqinjët e saj dhe në Evropë.



Forcat e Kosovës (KFOR-i)

KFOR-i është forcë ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO-ja, dhe është përgjegjëse për vendosjen

dhe mirëmbajtjen e "ambientit të sigurt në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen në siguri", sipas Rezolutës 1244, neni 9 (c), të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Nën këtë mandat, KFOR-i ka përgjegjësinë primare për të gjitha çështjet e sigurisë të cilat lindin gjatë procesit të kthimit. Gjithashtu KFOR-i luan një rol aktiv në çdo nivel të mekanizmit të planifikimit dhe koordinimit.

Procesi i kthimit

Procesi i kthimit i përshkruar në këtë doracak është gurthemel për suksesin e strategjisë për kthim në Kosovë. Seksioni i doracakut në vijim ofron një përmbledhje të procesit të kthimit, i cili duhet ta përbëjë bazën si për zhvillimin e projekteve të kthimit, ashtu edhe për zbatimin e tyre në vitin 2003 dhe më tej. Komponentët e përmbledhur në këtë proces nuk janë as të plotë dhe as të renditur në mënyrë kronologjike. Përveç kësaj, qasja e përshkruar në këtë doracak është vetëm pika fillestare e projekteve të kthimit, kështu që



ndryshimi, përmirësimi dhe modifikimi duhet t'u përshtaten nevojave dhe rrethanave në të cilat zhvillohen projektet e kthimit. Sidoqoftë, doracaku jep një kontribut të rëndësishëm duke qartësuar cili është procesi i parapëlqyer për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të kthimit dhe për t'u siguruar që qasjet e ndërmarra anembanë Kosovës janë në përputhje me parimet fundamentale të cilat e drejtojnë procesin e kthimit.

Procedurat përmbledhëse

Shprehja e dëshirës për t'u kthyer

Procesi i kthimit mbështetet thelbësisht në njohjen dhe përgjigjen ndaj dëshirës së shprehur të PZHBV-e / refugjatëve për t'u kthyer. Aftësia për t'u përgjigjur shprehjes së interesit për t'u kthyer është esenca e qasjes "nga poshtë-lart". Identifikimi i dëshirës për t'u kthyer shfaqet nga një sërë burimesh. Një mënyrë e përbashkët nëpërmjet të cilës personat e zhvendosur mësojnë për procesin e kthimit dhe kushtet në shtëpitë e tyre të paraluftës dhe bashkësinë e rrethit është nëpërmjet personave të mbetur në vend dhe personave të zhvendosur të cilët janë të zhvendosur afër shtëpive të tyre të mëhershme. Këta persona të zhvendosur, apo në disa raste edhe personat e mbetur, fillojnë procesin e kthimit, duke iu qasur bashkësisë ndërkombëtare, duke hyrë spontanisht në dialog me fqinjët e tyre të mëparshëm, vizitës në shtëpitë e tyre, ku edhe eventualisht bëjnë përfshirjen e pjesëtarëve të bashkësisë së tyre, të cilët janë të

zhvendosur më larg. Shumë persona të zhvendosur dhe refugjatë mësojnë nëpërmjet "vizitave shko dhe informo"⁵ (VSHI), dhe "vizitave shko dhe shiko"⁶ (VSHSH). Personat e mundshëm për t'u kthyer gjithashtu mbledhin informata nëpërmjet kanaleve të tjera, përfshirë këtu mediat dhe rrjetin jozyrtar të shkëmbimeve të thashethemeve, si dhe nëpërmjet projektit të përbashkët rajonal mbi kornizën e informimit.⁷ Shkëmbimi i informatave përmes vizitave shko dhe informo dhe vizitave shko dhe shiko, ofron një tregues të dëshirave dhe të nevojave të personave të zhvendosur për t'u kthyer. Shoqatat dhe organizatat e PZHBV-e / refugjatëve angazhohen me organizatat ndërkombëtare për t'i shfaqur nevojat e kthimit të bashkësive apo individëve të posaçëm. OJQ-të që punojnë me bashkësitë e zhvendosura, brenda Kosovës apo jashtë saj, gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm, duke u angazhuar me ata personat e interesuar për t'u kthyer, duke përkrahur përpjekjet për mbledhjen e

⁵ Vizitat shko dhe informo kanë për qëllim informimin e banorëve të zhvendosur mbi vendin e tyre të zhvendosjes, mbi gjendjen e tanishme të komunës, fshatit ose lagjes së tyre, dhe prandaj kanë për qëllim t'u mundësojnë që të marrin vendime të informuara më mirë mbi mundësinë e kthimit.

⁶ Vizitat shko dhe shiko ofrojnë mundësi për personat e zhvendosur që t'i vlerësojnë mundësitë e tyre për kthim, duke marrë parasysh situatën e tanishme në komunën e tyre. Personat e zhvendosur ftohen t'i vizitojnë shtëpitë e tyre të paraluftës si pjesë e një vizite të organizuar, ku ofrohen sigurimi dhe transporti, takimet informative, dhe takimet jozyrtare me fqinjët e mëparshëm.

⁷ Iniciativa rajonale mbi informimin është themeluar në qershor të vitit 2002 nga UNHCR, dhe takohet një herë në tre muaj për t'i tubuar zyrat e UNHCR-së nga Serbia, Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia, së bashku me një numër të zyrtarëve të UNMIK-ut për të diskutuar për nevojat e informimit të personave të zhvendosur në vendet e tyre të zhvendosjes. Vendi i takimit ndryshon. Strategjitë dhe hapat praktikë zhvillohen për ta përmirësuar qasjen e personave të zhvendosur në informata dhe zhvillimet të cilat ndodhin në vendin e tyre të prejardhjes.

informatave për t'u mundësuar të kthyerve të mundshëm që të marrin vendim të informuar mirë, dhe duke identifikuar nevojat me rastin e kthimit.

Kthimi, pra, fillon me identifikimin e një dëshire të mirëfilltë, vullnetare dhe të informuar mirë të PZHBV-e / refugjatëve.

Vendosja e lidhjeve ndërmjet PZHBV-e / refugjatëve dhe komunës së tyre të prejardhjes

Kontakti i parë duhet të vendoset nëpërmjet administratës komunale në komunën e prejardhjes. Kjo mund të arrihet nëpërmjet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të PZHBV-e / refugjatëve në grupet punuese komunale (GPK-të), apo nëpërmjet vizitave të zyrtarëve komunalë të PZHBV-e / refugjatëve, organizuar nga UNHCR-ja, apo OJQ-të që ofrojnë lidhje ndërkufitare ndërmjet personave të zhvendosur dhe vendit të tyre të prejardhjes. Në praktikë, ky kontakt fillestar shpesh ndihmohet nga pjesëtarët e mbetur të bashkësisë pakicë, të cilët i qasen bashkësisë ndërkombëtare në emër të fqinjëve të tyre më të largët, apo nga PZHBV-të / refugjatët e vendosur në vendndodhje të cilët flasin në emër të grupit të tyre më të madh, apo nga pjesëtarët e të njëjtës bashkësi etnike, të cilët janë të përfshirë në shkëmbimin e informatave të administratës komunale ndërmjet komunës së prejardhjes dhe PZHBV-e / refugjatëve, nëpërmjet GPK-ve. Ky është një hap fillestar, po i rëndësishëm, për t'i përgatitur rrethanat për një kthim të qëndrueshëm. Marrja e përkrahjes zyrtare aktuale për të hyrë në kontakt me PZHBV-të / refugjatët mund t'i lehtësojë kontaktet e ardhshme në nivel lokal, në komunën e tyre të prejardhjes.

Vendosja e lidhjeve ndërmjet PZHBV-e / refugjatëve dhe bashkësisë së tyre të prejardhjes

Lidhjet ndërmjet PZHBV-e / refugjatëve dhe bashkësisë së tyre të prejardhjes mund të vendosen në mënyrë paralele me iniciativat e dialogut me komunën e tyre të prejardhjes. Kjo sërish mund të arrihet në një sërë mënyrash, duke filluar nga vizita Shko dhe Shiko, e cila përfshin dialogun me autoritetet komunale dhe udhëheqësit vendorë të komunës, vizitat në lagjet e prejardhjes dhe takimi me fqinjët e mëparshëm. Këta mekanizma ndihmojnë në hapjen e dialogut ndërmjet PZHBV-e / refugjatëve dhe bashkësive pranuese, dhe ofrojnë një bazë nga e cila bashkësitë pranuese fillojnë të marrin pjesë në përgatitjet për kthimin e PZHBV-e / refugjatëve. Ndërtimi i besimit është i rëndësishëm si për bashkësinë e mundshme për t'u kthyer, ashtu

edhe për bashkësinë pranuese. VSHSH-të dhe VSHI-të duhet të kuptohen si mundësi për t'i filluar proceset e kthimit, por kjo nuk nënkupton edhe mbarimin me kaq. Është më mirë që këto të vështrohen si mjet për vendosjen e komunikimit ndërmjet bashkësive. Strategjitë për t'i filluar bisedat modeste më tutje përshkruhen në pjesën e parë të seksionit [Komponentët e procesit të kthimit të quajtur Dialogu ndëretnik dhe integrimi i bashkësive.](#)

Identifikimi i sfidave materiale dhe rrethanave për kthim

Analizat e kushteve për kthimin e PZHBV-e / refugjatëve në një vend të caktuar janë shumë efektive kur ndërmerren nga të gjithë partnerët pjesëmarrës, të angazhuar në procesin e kthimit (si vendorë, ashtu edhe ndërkombëtarë).

Në identifikimin e nevojave dhe pengesave për kthim, PZHBV-të / refugjatët, OJQ-të, dhe të gjithë të përfshirët në procesin e kthimit mbështeten në profilet apo vlerësimet e fshatrave apo lagjeve të prejardhjes së të zhvendosurve. Profilet e fshatrave, të krijuara nga UNHCR-ja, janë një mjet i rëndësishëm, kur ato janë në dispozicion. Grupet punuese komunale mund të formojnë profile shtesë për t'i shtuar informatat ekzistuese. Vlerësimet e sigurisë së KFOR-it, sa u përket fshatrave dhe lagjeve të banuara nga pakicat në periudhën e paraluftës, janë elemente të rëndësishme të këtij procesi.

Ambienti ndryshon me kalimin e kohës, e për këtë arsye nevojitet fleksibilitet me rastin e kryerjes së analizave. Mund të paraqiten dy lloje të pengesave të dukshme sa i përket kthimit:

Pengesat materiale, siç është mungesa e infrastrukturës apo ekzistimi i një infrastrukture të dobët, nevoja për rindërtimin apo rehabilitimin e shtëpive, çështjet e pagëgjdhura të pronësisë, papunësia dhe mundësitë e dobëta për zhvillimin e ekonomisë.

Sfidat e rrethanave, siç janë siguria, liria e lëvizjes dhe / ose mungesa e mundshme e qasjes në tokën bujqësore, nevoja për ndërtimin e besimit, si për bashkësinë pranuese, ashtu edhe për atë që kthehet, dhe, përveç të tjerave, edhe mungesa e qasjes në shërbimet publike për shkak të ambientit diskriminues.

Identifikimi i pengesave në këtë fazë të procesit të kthimit ndihmon në krijimin e strategjisë më të mirë për një kthim të qëndrueshëm. Grupet punuese komunale ofrojnë një mundësi për të gjithë ata të cilët janë të përfshirë në procesin e kthimit për të ndarë informata në lidhje me nevojat e kthimit. Duhet kërkuar strategji brenda këtij forumi për t'i zhvilluar mënyrat më të mira në mënyrë që procesi i kthimit të jetë i qëndrueshëm.

Mjetet ekzistuese për tejkalimin e pengesave materiale dhe të rrethanave



Mjetet e përshtatshme për mënjanimin e pengesave ndaj kthimit varen nga llojet e sfidave të identifikuar. Pengesat materiale kërkojnë një lloj të ndryshëm të veprimit në krahasim me sfidat e ndërlydhura me rrethanat apo situatat specifike me të cilat ballafaqohet një bashkësi e posaçme. Sfidat e rrethanave kërkojnë një proces të plotë të ndërtimit të besimit, edhe brenda bashkësisë që kthehet, por dhe me bashkësinë pranuese. Ato kërkojnë angazhimin e të dy bashkësive njëkohsisht përmes dialogut. Përveç dialogut të drejtpërdrejtë dhe qartësisht të mirëkuptimit dhe interesave, mundësitë për një rrafsh mund të gjenden duke identifikuar nevojat e përbashkëta dhe interesat e përbashkëta ndërmjet bashkësive, asaj që kthehet dhe bashkësisë pranuese. Për shembull, diskutimi i nevojave mund ta shfaqë një interes të përbashkët për përmirësimin e rrjetit të ujit, i cili i shërben bashkësisë ekzistuese dhe bashkësisë së kthyer.

Pengesat materiale kërkojnë zhvillimin e llojeve të ndryshme të projekteve, të cilat u adresohen nevojave të identifikuar. Adresimi i pengesave materiale në procesin e kthimit gjithashtu mund të jetë një mundësi për tejkalimin e sfidave të shkaktuara nga rrethanat. Një qasje që u adresohet nevojave materiale, gjersa gjithashtu stimulon dialogun

ndëretnik dhe aktivitetet e përbashkëta (kthyesë dhe pritëse), mund të prodhojë rezultate frytdhënëse. Vetë pengesat mund të ofrojnë mundësi për ndërtimin e besimit për kthimin e qëndrueshëm të PZHBV-e / refugjatëve, për angazhimin dhe integrimin e tyre në bashkësinë e tyre të prejardhjes.

Përpjekjet bashkëvepruese të të gjithë aktorëve përkatës në procesin e kthimit (PZHBV-të / refugjatët, bashkësitë pranuese, aktorët ndërkombëtarë dhe vendorë), në identifikimin e sfidave dhe mundësive për t'i tejkaluar ato, janë parakusht për suksesin dhe qëndrueshmërinë e procesit të kthimit.

Zhvillimi i projektit

Pasi të identifikohen nevojat, hap tjetër në procesin e projekteve të kthimit është zhvillimi i koncept dokumenteve, të cilat i planifikojnë projektet e kthimit për t'i përmbushur nevojat e identifikuar të kthimit. Grupet punuese komunale duhet t'i inkurajojnë të gjithë partnerët e interesuar zbatues (OJQ-të / agjencitë) për t'i përpiluar koncept dokumentet për nevojat e identifikuar të kthimit. Me rastin e kërkimit të koncept dokumenteve, grupet punuese komunale do t'i identifikojnë nevojat e gjera të cilat duhet të mbulohen nga projekti (përfshirë këtu ato të bashkësisë pranuese) brenda "sektorëve" të mundshëm në vijim: 1) ndihma për rindërtimin / riposedimin e shtëpive; 2) infrastruktura; 3) punësimi dhe krijimi i të ardhurave; 4) qasja në shërbimet publike dhe të bashkësisë (p.sh., shëndetësi, shërbime sociale, arsimim); dhe, 5) dialogu ndëretnik dhe integrimi i bashkësisë. Propozimet e projekteve do të përgatiten pasi të identifikohet financimi për ndonjë projekt specifik nëpërmjet dorëzimit të koncept dokumentit donatorëve.

Zbatimi i projektit

Partneri zbatues (OJQ-ja / agjencia) ka përgjegjësinë primare për zbatimin e projektit të kthimit. Grupet punuese komunale do të ofrojnë përkrahje për procesin e zbatimit të projektit, përfshirë këtu ofrimin e ndihmës në koordinim ndërmjet palëve të përfshira në procesin e kthimit. Përderisa donatorët janë kryesisht përgjegjës për mbikëqyrje të projektit, grupet punuese komunale do ta vëzhgojnë zbatimin e projektit dhe do ta përkrahin partnerin zbatues për t'iu qasur pengesave të paparashikueshme me rastin e zbatimit të projektit, nëse paraqitet nevoja. Partnerët zbatues janë përgjegjës për t'i informuar

grupet punuese komunale mbi punën e tyre nëpërmjet raportimeve periodike dhe pjesëmarrjes në takimet e grupeve punuese komunale.

Integrimi socio-ekonomik pas kthimit

Administratat komunale do të sigurojnë integrimin administrativ të personave të kthyer në komunë.

Pasi personat e zhvendosur të kthehen në komunën e tyre, ata duhet të trajtohen si banorë të përhershëm të komunës dhe atyre duhet t'u ofrohen të drejtat e njëjta si të gjithë të tjerëve në komunë, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Në përputhje me këtë, komuna duhet të sigurojë zbatimin e plotë dhe jetësimin e legjislacionit ekzistues të UNMIK-ut, i cili i mbron të drejtat e pakicave dhe qasjen e barabartë në shërbimet publike dhe sociale, si dhe mundësitë për punësim në administratë.

Mekanizmat e koordinimit

Grupi punues komunal

Grupi punues komunal është forum vendor për koordinimin e projekteve të kthimit. GPK: (1) ofron një forum për bashkësitë e ndryshme për t'u angazhuar në dialog mbi çështjet e kthimit, (2) luan rolin e mekanizmit kryesor përmes të cilit personat e zhvendosur mund t'i qasen procesit të kthimit dhe të kërkojnë ndihmë me rastin e kthimit, dhe (3) është organi kryesor për koordinimin e projekteve të kthimit me përgjegjësi primare për qëndrueshmërinë e procesit. GPK-ja ndihmon për t'u siguruar që personave të zhvendosur t'u dëgjohet zëri me rastin e formimit të perspektivës së tyre për kthim, dhe u mundëson personave të zhvendosur dhe bashkësive pranuese që të bashkëveprojnë drejtpërdrejtë në një dialog ndërkombëtarisht të ndihmuar dhe transparent me donatorët, organet qeveritare dhe OJQ-të.

Kryesia: Grupet punuese komunale (GPK) kryesohen nga administratori komunal i cili është përgjegjës për të siguruar, se në takime marrin pjesë kryetari apo nënkryetari i kuvendit komunal, si dhe zyrtarë të tjerë të administratës, përfaqësues të bordit komunal të drejtorëve dhe përfaqësues të bashkësisë. Administratori komunal është përgjegjës për t'i mbajtur takimet e GPK-së dhe për të siguruar që të gjithë aktorët përkatës janë të informuar (në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe) dhe të ftuar në takime. GPK-të duhet të takohen dy herë në muaj gjatë orarit të punës në ndërtesën komunale.

Përbërja: GPK-ja përbëhet nga shumë aktorë, përfshirë këtu Shtyllën II të UNMIK-ut dhe autoritetet lokale komunale, UNHCR-në, KFOR-in, policinë civile të UNMIK-ut / SHPK-në, OSBE-në, përfaqësues të personave të zhvendosur dhe OJQ-të.

Vendimarrja: Parapëlqehet që vendimet brenda GPK-së të merren me anë të konsensusit të të gjithë pjesëmarrësve të grupit. Nëse nuk arrihet konsensusi, administratori komunal, në pozitën e kryesuesit të GPK-së, ka pushtetin për ta miratuar vendimin në emër të grupit, duke marrë parasysh konsultimet dhe mendimet e pranuar nga pjesëmarrësit e GPK-së. Nëse ndonjë pjesëmarrës i GPK-së nuk pajtohet me vendimin e marrë, kjo do të regjistrohet me shkrim në procesverbalin e takimit të GPK-së.

Planifikimi veprues: GPK-ja, nëpërmjet administratorit komunal mund të kërkojë krijimin e ekipit të projektit (EP-së) në lidhje me ndonjë projekt specifik të kthimit, apo siç e konsideron të nevojshme GPK-ja. Pjesëmarrja në EP është e rezervuar për ekspertët - OJQ-të, stafin vendor të UNHCR-së, ekspertët teknikë komunalë, etj. Ekipi i projektit është përgjegjës për përcjelljen e zbatimit të projektit të kthimit dhe për t'u ofruar partnerëve zbatues përkrahjen e nevojitur teknike nga komuna. EP-ja do të koordinojë me departamentet përkatëse komunale (siç janë kadastra, arsimi, planifikimi urban, sanimi i ujit etj.), për t'u ndihmuar partnerëve zbatues në zhvillimin dhe zbatimin e projektit të kthimit. EP-të nuk janë organe vendimarrëse. Nëse paraqitet nevoja për të marrë vendime, EP-ja do të kërkojë nga administratori komunal për ta ftuar një takim të jashtëzakonshëm të GPK-së për t'iu adresuar çështjes specifike dhe për ta marrë vendimin. EP-të i raportojnë vetëm GPK-së. Administratori komunal është përgjegjës për përcaktimin e një përfaqësuesi të UNMIK-ut për t'i regjistruar konkluzionet e të gjitha takimeve të EP-ve. Në rastet kur GPK-ja nuk mund të takohet, EP-ja duhet ta informojë njësinë rajonale për kthim. Nëse në EP apo GPK ngriten çështje të cilat nuk mund të zgjidhen në nivelin e GPK-së, kryesuesi i GPK-së do t'i drejtojë ata tek grupi punues rajonal nëpërmjet njësisë rajonale për kthim.

Raportimi: Është përgjegjësi e administratorit komunal të sigurojë mbajtjen e shënimeve mbi konkluzionet e të gjitha takimeve të GPK-së dhe EP-së. Konkluzionet duhet të shpërndahen brenda një jave, nga dita kur është mbajtur takimi. Është përgjegjësi e administratorit lokal për të siguruar që versionet e procesverbalit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe të jenë në dispozicion për shpërndarje në të njëjtën kohë. Procesverbali i takimit duhet t'u shpërndahet: njësisë rajonale për kthim, kryesuesit të zyrës rajonale të UNHCR-së, administratorit rajonal, kryesuesit të zyrës rajonale të OSBE-së, dhe të gjithë pjesëmarrësve në GPK dhe pjesëmarrësve të EP-ve.

Grupi punues rajonal

Grupi punues rajonal

Grupi punues rajonal (GPR) është përgjegjës për koordinimin e procesit të kthimit dhe aktivitetet e integritit brenda çdo rajoni. Ai gjithashtu mbikëqyr përpjekjet e prupeve punuese komunale dhe rishikon projektet e miratuara në nivelin komunal. GPR-ja është përgjegjëse për të siguruar që procesi i kthimit brenda rajonit të kryhet sipas politikës përkatëse të vendosur mbi kthimin dhe bashkësitë.

Kryesia: GPR-ja kryesohet nga administratori rajonal i UNMIK-ut.

Antarësia: Në grupin e anëtarëve përfshihen: përfaqësuesit e GPK-ve - Shtylla II e UNMIK-ut dhe përfaqësuesit komunalë të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (2 persona), përfaqësuesi i njësisë rajonale për kthim, UNHCR-ja, UNMIK-u, Policia e UNMIK-ut / SHPK-ja, KFOR-i, Shtylla III / OSBE-ja, Shtylla IV / BE-në, dhe përfaqësuesit e OJQ-ve. Donatorët dhe përfaqësuesit e bashkësive të zhvendosura dhe pranuese janë të mirëseardhura për të marrë pjesë në takimet e grupeve punuese rajonale.

Rolet dhe përgjegjësitë: GPK-të raportojnë për aktivitetet dhe zhvillimet e GPR-së. Çfarëdo çështjesh që kanë të bëjnë me politikën, e që janë të ngritura nga GPK-ja, duhet që nga administratori komunal, si kryesues i GPK-së, t'i drejtohen GPR-së dhe të zgjidhen në GPR apo t'i referohen grupit për koordinimin e kthimit. Gjithashtu është përgjegjësi e GPR-së, nëpërmjet njësisë rajonale për kthim, të sigurohet që GPK-të brenda rajonit janë duke vepruar, duke u takuar rregullisht (dy herë në muaj), me pjesëmarrje të plotë të aktorëve përkatës.

Raportimi: Është përgjegjësi e administratorit rajonal të sigurojë, që procesverbalet të mbahen në të gjitha takimet e GPR-ve, dhe të shpërndahen brenda javës, nga dita kur është mbajtur takimi. Është përgjegjësi e administratorit rajonal të kujdeset dhe të sigurojë që versionet e procesverbalit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe të jenë në dispozicion për shpërndarje në të njëjtën kohë. Njësia rajonale për kthim ndërmerr funksionin e sekretarit të GPR-ve. Procesverbali i takimeve duhet t'u shpërndahet zyrës për kthim dhe bashkësi (ZKB),

kryesuesit të zyrës rajonale të UNHCR-së, kryesuesit të zyrës rajonale të OSBE-së dhe të gjithë pjesëmarrësve në GPR.

Administratori rajonal është përgjegjës për t'i thirrur takimet e GPR-së dhe për të siguruar që të gjithë aktorët përkatës të jenë të njoftuar (në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe), dhe të ftuar në takime. GPR-ja duhet të takohet një herë në muaj. Grupet punuese rajonale i raportojnë grupit për koordinimin e kthimit mbi aktivitetet e kthimit dhe mund t'i paraqesin pyetjet apo shqetësimet e tyre në grupin për koordinimin e kthimit nëpërmjet ZKB-së për diskutim dhe / apo zgjidhje.

Grupi për koordinimin e kthimit

Grupi për koordinimin e kthimit është trup kryesor që ka për qëllim t'u adresohet çështjeve vepruese të cilat ngriten në procesin e kthimit dhe për të siguruar koordinimin e qasjeve ndërmjet aktorëve kryesorë mbi kthimin (UNMIK-ut, UNHCR-së, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, KFOR-it). Grupi për koordinimin e kthimit do të takohet shpesh (dy herë në javë gjatë sezonës së kthimit) për ta lehtësuar shkëmbimin e informatave mbi përparimin e përpjekjeve të kthimit, dhe për t'u ofruar përkrahje grupeve punuese komunale dhe rajonale. Bashkësia e OJQ-ve gjithashtu do të përfaqësohet në GKK.

Bordi këshilldhënës teknik

Bordi këshilldhënës teknik (BKT) i ofron përkrahje të specializuar grupit për koordinimin e kthimit. BKT-ja përfshin individë me ekspertizë të veçantë teknike në hartimin dhe zbatimin e projekteve, duke përfaqësuar anëtarët kryesorë të grupit për koordinimin e kthimit, bashkësinë e donatorëve, dhe organizatat zbatuese të OJQ-ve. Përpos rolit që ka në dhënien e rekomandimeve grupit për koordinimin e kthimit në lidhje me listën e përpiluar të projekteve prioritare, BKT-ja do t'i ofrojë udhëzime teknike grupit për koordinimin e kthimit për t'i tejkaluar pengesat dhe për ta mundësuar suksesin në procesin e kthimit.

Grupi punues mbi kthimin

Grupi punues mbi kthimin është një forum i nivelit të lartë, i kryesuar nga PSSP-ja dhe i përcaktuar për të ofruar koordinim dhe përkrahje politike për kthimin e personave të zhvendosur dhe refugjatëve në Kosovë. Katër anëtarët kryesorë të grupit punues për kthim janë: UNMIK-u, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, UNHCR-ja dhe KFOR-i. Grupi punues gjithashtu përfshin koordinatorin ndërministror për kthime dhe këshilltarin e lartë të PSSP-së për kthime, si dhe përfaqësues të lartë prej secilës nga të katër shtyllat e UNMIK-ut dhe të Drejtorisë për çështje pronësore dhe bane-sore. Organizatat dhe individët e tjerë marrin pjesë në grup punues në baza të përkohshme, përfshirë këtu përfaqësuesit e bashkësisë pakicë. Grupi punues për kthim mbikëqyr procesin e kthimit, përfshirë këtu përpjekjet e grupeve punuese rajonale dhe komunale, dhe siguron zbatimin efikas dhe të pandryshuar të politikave të kthimit ndërmjet institucioneve kryesore anembanë Kosovës.

Zyra për kthim dhe bashkësi si dhe njësitë rajonale për kthim

Nëpërmes zyrës së vet qendrore në Prishtinë, njësisë rajonale në secilin rajon në Kosovë dhe stafit të saj në zyrën e UNMIK-ut në Beograd, zyra për koordinimin e kthimit (ZKK) është përgjegjëse për të siguruar koordinim të gjithmbarshëm të procesit të kthimit dhe për të ofruar udhëzime politike për procesin e kthimit. Nëpërmjet grupit për koordinimin e kthimit, ZKK koordinon punët që kanë të bëjnë me çështjet e përgjithshme vepruese dhe teknike në nivelin qendror. Funkzioni i udhëzimit dhe koordinimit politik i interpretohet nivelit rajonal nëpërmjet njësiteve rajonale të kthimit të cilat janë formuar për ta përkrahur administratorin rajonal dhe administratorin komunal në kryerjen e detyrave të tyre në këtë proces në gjithë rajonin.

Rolet dhe përgjegjësitë institucionale

Zyra e UNMIK-ut për kthim dhe bashkësi

Nëpërmjet zyrës së saj qendrore në Prishtinë, pesë një-sive rajonale në Kosovë dhe stafit të vendosur në zyrën e UNMIK-ut në Beograd, zyra për kthim dhe bashkësi (ZKB) është përgjegjëse për drejtimin e strukturave të gjithmbarshme të koordinimit, duke siguruar një lëvizje të lehtë të proceseve të gjithmbarshme në ato raste kur paraqitet nevoja, duke ofruar përkrahje për strukturat vepruese.

Në përgjegjësitë e ZKB-së përfshihen:

1. Sigurimi i përkrahjes dhe udhëzimet politike për proceset e kthimit në nivelin qendror, rajonal dhe komunal (përfshirë këtu sigurimin e funksionimit të grupit punues, grupit koordinues për kthim, bordit këshilldhënës teknik, grupet punuese rajonale, punën me administratorët komunalë për të siguruar funksionimin e grupeve punuese komunale dhe të grupeve të tyre lokale punuese).
2. Sigurimi i një qasjeje të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse ndaj kthimit.
3. Koordinimi i përpjekjeve për mbledhjen e fondeve dhe shpërndarjen e azhurnimeve me kohë për nevojat me prioritet të financimit.
4. Ngritja e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet përpjekjeve të njërit rajon me tjetrin.
5. Sigurimi i një pike kontaktuese për donatorët për ta lehtësuar qasjen në informata dhe struktura të kthimit.
6. Përkrahja e lidhjeve të drejtpërdrejta përtej kufijve tek bashkësitë e zhvendosura.
7. Pjesëmarrja aktive në forume të tjera të ndërlidhura me bashkësinë, siç janë: grupet punuese ABC, procesi i standardeve, përkrahja e përpjekjeve për t'i përmirësuar kushtet për realizimin e kthimit.

UNHCR

UNHCR luan një rol kryesor në procesin e kthimit. Aktivitetet e UNHCR-së ndërmerren në përkrahje të stabilizimit të kthimeve dhe bashkësive.

Në përgjegjësitë e UNHCR-së në Kosovë përfshihen:

1. Mbikëqyrja e aktiviteteve të ndërlidhura me kthimin në përputhje me mandatin e saj. UNHCR-ja është një ndër aktorët kryesorë të grupit punues për kthime, si dhe i të gjitha grupeve punuese rajonale (GPR) dhe komunale (GPK).
2. Përgatitja, në bashkëpunim me OSBE-në, e analizave mbi gjendjen e pakicave në Kosovë, me theks të veçantë në aspektet që kanë të bëjnë me kthimin.
3. UNHCR bën koordinimin me autoritetet përkatëse ndërkombëtare dhe vendore, punon me OJQ-të, për t'i zbatuar vizitat "shko dhe shiko", dhe lëvizjet e kthimit; siguron aranzhime të duhura logjistike dhe të transportit për mundësimin e vizitave ndërkufitare dhe të lëvizjeve të organizuara të kthimit.
4. Bën mirëmbajtjen e informatave statistikore dhe të informatave të tjera mbi lëvizjet e kthimit spontan dhe të organizuar; si dhe për nevojat e personave të kthyer, dhe ofron raporte të rregullta.
5. Ofron ndihmë të kufizuar me artikuj joushqimor dhe materiale për strehim emergjent për të kthyerit, menjëherë pas arritjes së tyre spontane ose të organizuar.



- Nëpërmjet partnerëve të saj zbatues, bën shpërndarjen e ushqimit për të kthyerit nevojtarë, për një periudhë fillestare tremujore pas kthimit.
- Nëpërmjet partnerëve të saj zbatues siguron ndihmë juridike, këshilla dhe informata për personat e kthyer dhe bashkësitë e tyre për çështje të ndryshme ligjore, përfshirë këtu çështjet që janë të ndërlidhura me pronësi.
- Përkrah dialogun ndëretnik në favor të kthimit të bashkësive pakicë.
- Brenda kontekstit të kornizës së miratuar për informim, UNHCR ndihmon në mbledhjen dhe shpërndarjen e mëtutjeshme të informatave që janë të rëndësishme për personat e zhvendosur.
- Vëzhgon gjendjen e të kthyerve dhe përcjell çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe problemet.

UNHCR

UNHCR responsibilities within Serbia, Montenegro and Macedonia include:

- Nëpërmjet njetit të saj të zyrave në terren dhe kontakteve me shoqatat e PZHBV-e, OJQ-ve ndërkom-bëtare dhe vendore, si dhe institucioneve qeveritare, mban kontakte me popullatën e PZHBV-e / refugjatëve dhe përcakton nevojat më të ngutshme, jo vetëm humanitare, por edhe ato në lidhje me informatat dhe pritjet për kthim.
- Identifikimi dhe ofrimi i ndihmës për personat që kërkojnë këshillë ose ndihmë lidhur me vizitat shko dhe shiko, apo lidhur me vetëkthimin dhe ofrimin e këshillave apo ndihmës së tillë me ndihmën e OJQ-ve, të cilat janë të angazhuara me informimin dhe aktivitetet e ndërlidhura me kthimin.
- Në bashkëpunim me agjencitë e tjera, përfshirë këtu UNMIK-un dhe autoritetet mikpritëse, ndihmon që PZHBV-e / refugjatëve t'u shpërndahen informata objektive mbi situatën në Kosovë.
- Mirëmbajtja dhe azhurnimi i bazës së të dhënave mbi regjistrimin e PZHBV-e / refugjatëve, përfshirë këtu radhitjen sipas komunës së prejardhjes në Kosovë, përbërjen familjare dhe regjistrimin e sërishëm të të kthyerve.
- Përpjekjet aktive për të ofruar mekanizma koordinimi për të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe vendore, përfshirë këtu edhe ato qeveritare, të cilat janë të angazhuara në procesin e kthimit në Kosovë.
- Organizimi i takimeve rajonale dhe i konsultimeve mbi kthimin me të gjitha palët përkatëse, sipas nevojës, për ta përmirësuar cilësinë e progresit të kthimit.

KFOR-i

KFOR-i është anëtari kryesor i të gjitha strukturave koordinuese të kthimit, përfshirë këtu grupet punuese komunale dhe rajonale, grupet për koordinimin e kthimit dhe grupin punues mbi kthimin.

Në përgjegjësitë e procesit të kthimit përfshihen:

- Ofrimi i vlerësimeve të sigurisë mbi vendet e mundshme të kthimit.
- Ofrimi i përcjelljes së sigurisë dhe i statistikave të posaçme të vendit për vizitat shko dhe shiko, në rastet në të cilat kjo shihet si e përshtatshme nga GPK-të.
- Pjesëmarrja në VSHSH, përfshirë këtu informimin e personave të zhvendosur mbi çështjet të sigurisë.
- Pjesëmarrja në GPR dhe GPK.
- Ofrimi i ambientit të sigurt në vendet e kthimit dhe përreth tyre në bashkëpunim me Policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në.
- Raportimi i incidenteve të sigurisë të motivuara etnikisht dhe hetimi i atyre incidenteve me Policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në.
- Ofrimi i ndihmës shtesë teknike dhe planifikuese, sipas nevojës.

Administrata komunale e UNMIK-ut

Administrata komunale e UNMIK-ut luan një rol kryesor në planifikimin dhe koordinimin e aktiviteteve të kthimit të ndërmarra në komunat e tyre. Procesi i grupit punues komunal mbështetet në udhëheqësinë aktive të administratës komunale të UNMIK-ut për zbatimin efikas të procesit "nga poshtë-lart" për personat e zhvendosur. Administrata komunale e UNMIK-ut është përgjegjëse për të siguruar veprimin efikas të proceseve të planifikimit, të koordinimit dhe dialogut të GPK-ve.

Përgjegjësitë e administratës komunale të UNMIK-ut:

1. Themelimi i GPK-së dhe sigurimi i mbajtjes së rregullt të takimeve me përfaqësim të plotë dhe aktiv të të gjithë aktorëve.
2. Kryesimi i grupit punues komunal.
3. Ofrimi i sigurisë që shqetësimet e PZHBV-e / refugjatëve të dëgjohen në komunë.
4. Sigurimi i pjesëmarrjes aktive të zyrtarëve komunalë dhe anëtarëve të GPK-së në VSHI dhe VSHSH.
5. Sigurimi që departamentet komunale të jenë të ftuara dhe të marrin pjesë në GPK në mënyrë që të jenë të informuara dhe të konsultuara mbi projektet e kthimit që kanë ndikim në fushën e kompetencave të tyre.
6. Sigurimi që aktivitetet e kthimit të GPK-së të raportohen në grupet punuese rajonale.

Përgjegjësitë e GPK-së janë:

1. Ndihma e dialogut ndëretnik, integrimi i bashkësive dhe ndërtimi i besimit ndërmjet bashkësive që kthehen dhe bashkësive pritëse nëpërmjet pjesëmarrjes së zyrtarëve vendorë të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, përfaqësimit të bashkësive shumicë, pakicë dhe të personave të zhvendosur.
2. Ndihma në identifikimin e nevojave të projekteve dhe në zhvillimin e përgjigjeve të veprimit, që rezultojnë në projektet e kthimit në komunë.
3. Përcjellja e përafërt, dhe mbikëqyrja në raste kur paraqitet nevoja, e zbatimit të të gjitha aktiviteteve të kthimit në komunë.
4. Vëzhgimi dhe regjistrimi i interesimit të personave të zhvendosur për t'u kthyer dhe krijimi i ndërlidhjeve me hulumtimin e terrenit, që ka të bëjë me vendet e prejardhjes (p.sh., vlerësimet / aktivitetet, profilet e shpejta të vendeve, krijimi i hartës mbi personat e zhvendosur, vlerësimet e sigurisë, etj.).
5. Përcaktimi i prioriteteve mbi aktivitetet e kthimit.
6. Mbikëqyrje e procesit të zhvillimit të koncept dokumentit.
7. Rishikimi i koncept dokumentit, i cili i paraqitet GPK-së.
8. Përcaktimi i prioritetit, miratimi dhe rekomandimi i projekteve dhe partnerëve zbatues tek grupi punues rajonal.

Administrata rajonale e UNMIK-ut

Administratat rajonale të UNMIK-ut mbikëqyrin procesin e kthimit në fushën e tyre të përgjegjësisë. Zyrat rajonale luajnë një rol kryesor në ofrimin e lidhjes formale ndërmjet grupeve punuese komunale dhe organeve qendrore koordinuese, siç janë grupi për koordinimin e kthimit dhe grupi punues i kthimit. Lidhjet bëhen "teposhtë", duke siguruar që administratorët komunalë të jenë krah për krah me zhvillimet politike dhe sigurojnë iniciativa të cilat pasqyrojnë udhëzimet, dhe "përpjetë", duke siguruar që nevojat dhe aktivitetet me prioritet për kthimin u komunikohen strukturave përkatëse. Si kryesues i administratës civile në rajon, administratori rajonal është kryesues i grupit punues rajonal dhe përgjegjës për mbikëqyrjen zyrtare dhe koordinimin e grupeve punuese komunale. Njësitë rajonale të kthimit janë kryesisht përgjegjëse për udhëzimin dhe përkrahjen e kthimit dhe përpjekjet për integrim, përdërisa planifikimi dhe aktivitetet vepruese drejtohen nga administrata komunale.

Përgjegjësitë e administratës rajonale të UNMIK-ut:

1. Themelimi i grupeve punuese rajonale të cilat takohen rregullisht, me përfaqësim të plotë dhe aktiv të të gjithë aktorëve të përfshirë.
2. Kryesimi i GPR-ve (me njësitë rajonale për kthim që veprojnë si sekretariat për GPR-të).
3. Mbikëqyrja dhe vëzhgimi i GPK-ve, duke pranuar raporte nëpërmjet kryesisë, për t'u siguruar që GPK-të janë funksionale dhe efikase.

Përgjegjësitë e GPR-së janë:

1. Mbikëqyrja dhe koordinimi i punëve të GPK-ve brenda rajonit të vet.
2. Mbajtja e forumeve për shkëmbimin e informatave mbi çështjet që kanë të bëjnë me kthimin.
3. Inkurajimi i pjesëmarrjes aktive të të gjithë aktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë në grupet punuese komunale dhe rajonale, përfshirë këtu OJQ-të.
4. Vëzhgimi dhe sigurimi i mbarëvajtjes dhe qëndrueshmërisë së aktiviteteve të kthimit (siç janë VSHI-të dhe VSHSH-të), të ndërmarra në çdo komunë.
5. Koordinimi dhe mirëmbajtja e listave të projekteve të miratuara dhe me prioritet të kthimit, të cilat kanë nevojë për përkrahje, dhe raportimi i kësaj pune tek grupi qendror për koordinimin e kthimit.
6. Sigurimi që projektet e miratuara i pasqyrojnë parimet e koncept dokumentit të UNMIK-ut mbi të drejtat për kthim të qëndrueshëm, të Doracakut për kthim të qëndrueshëm dhe të çfarëdo dokumenti tjetër që ofron parimet udhëzuese mbi aktivitetet e kthimit.
7. Sigurimi i integritetit të bashkësisë dhe i aktiviteteve të dialogut për ta ofruar një ambient të favorshëm për kthim.

Njësitë rajonale të UNMIK-ut për kthim

Njësitë rajonale për kthim janë përgjegjëse për përkrahjen e grupeve punuese dhe aktiviteteve të kthimit; për vëzhgimin e procesit të kthimit; dhe për ofrimin e udhëzimeve mbi aktivitetet e kthimit.

Përgjegjësitë e NJRK-ve të UNMIK-ut:

1. Përkrahja e administratorit rajonal në detyrat që kanë të bëjnë me grupin rajonal punues, përfshirë këtu, por jo të kufizuar për, çështjet në vijim: ofrimi i funksionit të sekretarisë së GPR-së, mbajtja e orarit të takimeve të GPK-së dhe GPR-së anembanë rajonit.
2. Përkrahja e administratorëve komunalë në detyrat që kanë të bëjnë me grupet punuese komunale, përfshirë këtu, por jo të kufizuar për, sigurimin se administrata vendore, PZHBV-të dhe OJQ-të, si dhe partnerët e tjerë janë të angazhuar në këtë proces dhe në ofrimin e ndihmës GPK-ve (funksionet e sekretarisë për GPK-të mbesin përgjegjësi e komunave).
3. Vëzhgimin dhe raportimin e të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura me kthimin dhe projektet e kryera në rajon.
4. Sigurimin që aktivitetet e ndërlidhura me kthimin të zbatohen në përputhje me udhëzimet e vendosura.
5. Bashkëveprimin me UNHCR-në, KFOR-in dhe organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë mbi çështjen e kthimit.
6. Përkrahjen e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet komunave dhe rajoneve.
7. Lehtësimin e kontakteve ndërmjet aktiviteteve rajonale të kthimit dhe bashkësive të zhvendosura, dhe kontributi në përpjekjet për informim publik, në bashkëveprim me personelin e UNMIK-ut / Beograd dhe personelin e ZKB-së.
8. Sigurimin që të gjitha aktivitetet t'i përfshijnë masat e dialogut dhe ndërtimit të besimit në qasjet e tyre.
9. Përkrahjen dhe vëzhgimin e dialogut ndëretnik dhe të iniciativave të marrëdhëniesve ndërmjet bashkësive.

Zyra e UNMIK-ut për çështje të bashkësisë

ZÇB luan rol të rëndësishëm në ndërtimin e besimit të PZHBV-e / refugjatëve, në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimit të qasjes në shërbimet publike për të gjitha bashkësitë. Nëpërmjet rjetit të vet të zyrave të bashkësive lokale (ZBL) në administratën komunale, ZÇB koordinon çështjet vepruese brenda administratës qendrore dhe lokale të ndërlidhur me bashkësitë pakicë. Në parim është vendosur për ta përkrahur mbrojtjen e interesave të pakicave dhe të bashkësive në administratën civile dhe në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, dhe për ta vëzhguar zbatimin e rregulloreve të cilat kanë të bëjnë me interesat e bashkësisë. Nëpërmjet ZBL-ve, ZÇB-ja ofron mbikëqyrje, vëzhgim dhe raportim, duke u përpjekur që të drejtat, interesat, dhe qëndrueshmëria e bashkësive, përfshirë këtu personat e kthyer, të jenë të mbrojtur plotësisht në aktivitetet e administratave lokale dhe të asaj qendrore.

Në përgjegjësitë e ZÇB-së përfshihen:

1. Pjesëmarrja në grupin për koordinimin e kthimit.
2. Luajtja e një roli aktiv në përkrahjen e procesit të planifikimit, duke siguruar përmbushjen e nevojave me rastin e kthimit dhe përkrahjen e integritetit të të kthyerve, si dhe të pjesëtarëve të tjerë të bashkësive pakicë.
3. Pjesëmarrja aktive në GPR dhe GPK, si dhe në komponentët e tjerë të procesit, siç janë VSHSH-të dhe VSHI-të.
4. Përkrahja e përpjekjeve të kthimit në komuna.

SHTYLLA I e UNMIK-ut

Policia

Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja luajnë një rol në mirëmbajtjen efikase të sigurisë për personat e kthyer dhe PZHBV-të / refugjatët në vizitë, duke zbatuar kthimin e të drejtave pronësore të banimit, dhe duke ndihmuar për ta siguruar lirinë e lëvizjes për pakica.

Në përgjegjësitë e policisë përfshihen:

1. Pjesëmarrja në GPK dhe GPR.
2. Pjesëmarrja në VSHSH dhe VSHI, përfshirë këtu ofrimin e sigurisë për pjesëmarrësit e VSHSH-së kur paraqitet nevoja, dhe informimi i të kthyerve të mundshëm sipas nevojës.
3. Ofrimi i sigurisë për të kthyerit.
4. Ofrimi i sigurisë dhe përmirësimi i besimit të bashkësive në sundimin e ligjit përkitazi me mbrojtjen e bashkësive ekzistuese pakicë dhe të kthyerve.
5. Përkrahja e dialogut ndëretnik dhe hapat për ndërtimin e besimit në ato raste ku paraqitet nevoja, siç është përfshirja e SHPK-së në procesin e kthimit.
6. Zbatimi i masave të tjera ekzistuese të cilat i mbrojnë interesat e pakicave dhe të kthyerve, siç janë vendimet e Drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore, dhe të Komisionit për kërkesa pronësore për dëbimin e banorëve të paligjshëm nga shtëpitë e banimit.

Organet e drejtësisë

Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi është përgjegjës për administrimin e drejtësisë anembanë Kosovës. Aftësia e Departamentit për të ofruar drejtësi të paanshme është element kryesor drejt ndërtimit të besimit të bashkësive dhe personave të kthyer në proceset e drejtësisë.

Në përgjegjësitë e organeve të drejtësisë përfshihen:

1. Sigurimi i qasjes së pakicave dhe të kthyerve në sistemin e drejtësisë.
2. Vazhdimi i punës drejt sigurimit të paanësisë dhe pavarësisë në organet e drejtësisë nëpërmjet gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, për t'i mbikëqyrur rastet e ndjeshme në të cilat përfshihen bashkësitë ndëretnike, apo rastet në të cilat ekziston ndonjë rrezik serioz i animit.

Drejtorja për çështje pronësore dhe banesore

DÇPB-ja gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në përkrahjen e ambientit për kthim të qëndrueshëm. Si subjekt i pavarur administrativ / vendimmarrës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pronësore të cilat lindën si pasojë e periudhës së luftës, ose të skemës diskriminuese pronësore të paraluftës në Kosovë, roli i DÇPB-së është kryesor në përkrahjen e kthimit në vendet urbane. Rregulloret e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 krijojnë bazën për intervenimin e DÇPB-së në Kosovë.

Në përgjegjësitë e DÇPB-së përfshihen:

1. Verifikimi dhe qartësimi i çështjeve të pronës së banimit në raste individuale.
2. Zbatimi i të drejtave pronësore nëpërmjet lëshimit të vendimeve përfundimtare sa i përket pronës dhe të drejtave pronësore, përfshirë këtu lëshimin e urdhërësive për nxjerrjen e banorëve të paligjshëm.
3. Administrimi dhe / ose përcaktimi i statusit të pronës së braktisur banesore apo të uzurpuar, përfshirë këtu ripërcaktimin e njësive të pronave banesore për qëllime humanitare.
4. Regjistrimi i individëve të varfër të cilët i përmbushin kriteret e posaçme për t'u ofruar akomodim tjetër të përcaktuar humanitar.



SHTYLLA III - OSBE-ja

OSBE-ja ka angazhuar kuadro për t'i përkrahur interesat e bashkësive, përfshirë këtu përkrahjen e aktiviteteve të cilat kontribuojnë në përmirësimin e ambientit për mundësimin e kthimit. Roli i saj në ndërtimin e institucioneve, vëzhgimin e mediave, përkrahjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit e bën atë idealisht të vendosur për t'i përkrahur përpjekjet në fushën e kthimit, si në aspektin operativ ashtu edhe atë të vëzhgimit.

Në përgjegjësitë e OSBE-së përfshihen:

1. Pjesëmarrja në GPK-të dhe GPR-të.
2. Përkrahja e dialogut ndëretnik dhe e aktiviteteve për ndërtimin e tolerancës para se të ndodhin kthimet aktuale dhe pas tyre.
3. Vëzhgimi dhe raportimi i shkeljes së të drejtave të njeriut, përfshirë këtu aktet e dhunës ndëretnike,

diskriminimin në qasjen e institucioneve publike dhe shërbimeve publike / sociale, mohimin e të drejtave pronësore, mungesën e lirisë së lëvizjes dhe sigurisë.

4. Përkrahja e zgjedhjeve të barabarta për viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe qasja më e madhe e grupeve të ndieshme në shërbimet publike dhe sociale.
5. Nxitja e ndërtimit të tolerancës nëpërmjet dialogut ndëretnik dhe aktiviteteve të ndërlihdura, si dhe përkrahja e koordinimit nëpërmjet kryesisë së grupit punues ABC për dialogun ndëretnik.
6. Përfshirja e integritimit ndërmjet bashkësive dhe ndërtimi i besimit në programet e tyre për ndërtimin e institucioneve qeveritare dhe sociale, si dhe përpjekjet për vëzhgimin e mediave.

SHTYLLA IV - Bashkësia Evropiane

Shtylla IV e UNMIK-ut, nën udhëheqjen e Bashkësisë Evropiane, është përgjegjëse për rindërtim dhe zhvillim ekonomik.

Në përgjegjësitë e Shtyllës IV përfshihen:

1. Koordinimi i aktiviteteve të rindërtimit dhe sigurimi që pakicat dhe të kthyerit të kenë qasje në ndihmën e rindërtimit, dhe përkrahja e përpjekjeve të komunave për të ofruar konsideratë të barabartë dhe të drejtë për përfituesit e pakicave nga komiteti komunal për strehim.
2. Përkrahja e përpjekjes për t'i ngritur mundësitë ekonomike për pakicat dhe të kthyerit.

3. Sigurimi i trajtimit të drejtë të bashkësive pakicë në administrimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndërmarrjeve publike, Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, si dhe iniciativave të tjera dhe shërbimeve të cilat janë në dispozicion të bashkësive shumicë.
4. Përkrahja e mundësive të punësimit ndëretnik në sektorin privat dhe përkrahja e qasjes së PZHBV-e / refugjatëve.
5. Pjesëmarrja në grupet punuese rajonale dhe takime të tjera të koordinimit sipas nevojës.

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes

IPVQ-të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e kthimit dhe të integritetit të bashkësive pakicë. Ardhmëria e një Kosove shumetnike varet kryesisht nga aftësia e zyrtarëve të qeverisë vendore për t'i angazhuar të kthyerit e mundshëm në dialog dhe për të kontribuar në njohjen publike të së drejtës së tyre për t'u kthyer dhe inkurajuar pjesëmarrjen në strukturat e qeverisë së përkohshme. Kthimi i qëndrueshëm varet nga aftësia e IPVQ-ve për t'u siguruar pakicave dhe të kthyerve qasje në shërbimet publike dhe sociale.

Në përgjegjësitë IPVQ-ve përfshihen:

1. Pjesëmarrja aktive në mekanizmin për koordinimin e kthimit, përfshirë këtu grupin punues për kthim, grupin për koordinimin e kthimit, GPR-të dhe GPK-të.
2. Kontributi në ngritjen e besimit të PZHBV-e / refugjatëve në perspektivën e tyre për t'u kthyer dhe jetuar në një ambient i cili i respekton të drejtat e njeriut, sociale, qytetare dhe politike.
3. Angazhimi aktiv në kontaktin e drejtpërdrejtë me PZHBV-të / refugjatët nëpërmjet VSHI-ve dhe VSHSH-ve.
4. Përkrahja e përpjekjeve për ta ngritur pranimin publik dhe tolerancën ndaj bashkësive pakicë, si p.sh. dënimi i sulmeve, përdorimi i gjuhëve jo-shqipe, prania e dukshme e zyrtarëve në zonat e pakicave.
5. Kontributi në dialogun ndëretnik ndërmjet të kthyerve të mundshëm dhe bashkësive pranuese.
6. Ofrimi i deklaratave zyrtare mbi incidentet e sigurisë të motivuara etnikisht.
7. Përmirësimi i kushteve të jetesës për bashkësitë që mbeten në Kosovë, duke siguruar qasjen e të gjitha bashkësive dhe të kthyerve të mundshëm në shërbimet publike dhe sociale, përfshirë këtu shëndetësinë, ndërmarrjet publike, ndihmën sociale, arsimin dhe reagimin me kohë ndaj incidenteve të sigurisë.
8. Akordimi përkatës i resurseve buxhetore për kthim dhe integrim.
9. Ngritja e pjesëmarrjes së pakicave në strukturat komunale dhe qeveritare.
10. Përkrahja e masave për të ofruar përfaqësim përkatës të pakicave në bordin komunal të drejtorëve, dhe e strukturave të tjera.

Donatorët

Deri më tani, mbledhja e fondeve për procesin e kthimit është drejtuar përmes OJQ-ve të cilat janë financuar paraprakisht dhe të cilat funksionojnë në fusha specifike gjeografike, përmes përgjigjeve ndaj kërkesave vullnetare për financim të aktiviteteve të planifikuara në shkallë të gjerë dhe kërkesave vullnetare për iniciativë të vogla. Bashkësia e donatorëve është ftuar që ta ndihmojë procesin e kthimit dhe ata mbeten përgjegjës ndaj nevojave të shprehura nëpërmjet mekanizmit për koordinim. Struktura e koordinimit është vendosur për të siguruar që propozimet e dorëzuara përmes kanaleve të përfshijnë nevojat me prioritet për të pasqyruar një sërë interesash, duke përfshirë këtu: 1) nevojat e shprehura të vetë PZHBV-e / refugjatëve, 2) kërkesat shumësektorale, 3) aktivitetin ndërkufitar për ta përgatitur kthimin, 3) dialogun ndërmjet bashkësive dhe nevojat e tërë bashkësisë.

Në përgjegjësitë e donatorëve përfshihen:

1. Angazhimi në strukturat e kthimit sipas nevojës, përfshirë këtu grupet punuese rajonale dhe bordin këshilldhënës teknik.
2. Ofrimi i përgjigjes në kohë të duhur ndaj kërkesave për financim.
3. Drejtimi i fondeve të premtuara në fushat të cilat janë të identifikuara si prioritate.
4. Përkrahja e mekanizmave fleksibilë të financimit të krijuar për t'iu përgjigjur nevojave të kthimeve individuale.
5. Inkurajimi i partnerëve zbatues për të marrë pjesë tërësisht dhe për ta koordinuar punën me mekanizmat për koordinimin e kthimit në nivelin komunal dhe rajonal.

Organizatat joqeveritare

OJQ-të luajnë një rol kryesor në planifikimin, ndihmën dhe zbatimin e procesit të kthimit. Aftësia e tyre vepruese, përvoja e gjerë dhe aftësia për të arritur matanë kufijve administrativë të Kosovës i bën ato të jenë partnerët kryesorë në këtë proces. Procesi në këtë Doracak përfshin procesin e zhvillimit të projektit për aktivitetet për të cilat fondet nuk janë në dispozicion. Prahonet që OJQ-të gjithashtu do të kërkojnë t'i zbatojnë aktivitetet me burimet e tyre vetanake të financimit, me një sërë qëllimesh dhe aktivitetesh të definuara paraprakisht. OJQ-të e angazhuara në të dyja llojet e aktiviteteve inkurajohen të marrin pjesë në strukturat rajonale dhe komunale, si dhe në ekipet e projekteve, për t'u siguruar që aktivitetet e tyre janë plotësuese ndaj përpjekjeve të cilat janë duke u planifikuar, dhe për t'u siguruar që resurset e pakëta synojnë prioritetet mbi të cilat është arritur marrëveshja e përbashkët.

Në përgjegjësitë e OJQ-ve përfshihen:

1. Synimi i aktiviteteve që janë në përputhje me parimet udhëzuese të përmbledhura në këtë Doracak.
2. Kontributi aktiv në hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve të kthimit në përputhje me kornizën për kthim të definuar nga çdo GPK, siç është përgjigja ndaj kërkesave për koncept dokumente.
3. Ofrimi i përkrahjes për përpilimin e informatave për ta përkrahur procesin planifikues sipas nevojës (siç janë p.sh. profilet e shpejta të vendit).
4. Ku të jetë e mundur dhe e nevojshme, të ofrohet përkrahja për aktivitete tejkufitare për të ndihmuar në dëgjimin e shqetësimeve të personave të zhvendosur.
5. Përkrahja në identifikimin e përfituesve të ndihmës me rastin e kthimit.
6. Sajimi i intervenimeve të cilat përkrahin një gamë të sektorëve për ta siguruar qëndrueshmërinë e të kthyerve.
7. Ofrimi i azhurmimeve me kohë për GPK-të dhe GPR-të mbi aktivitetet e tyre dhe ndikimi në kthim, si dhe në bashkësitë fqinje, përfshirë këtu aktivitetet e VSHSH-ve, rindërtimin e shtëpive dhe aktivitetet e tjera sektorale.
8. Pjesëmarrja në VSHSH dhe VSHI.
9. Pjesëmarrja aktive në GPR dhe GPK.

Qendra koordinuese për Kosovë dhe Metohi

QKK-ja është përgjegjëse për koordinim ndërmjet autoriteteve të RFJ-së dhe UNMIK-ut mbi çështjen e kthimit të personave të zhvendosur në Kosovë. Si institucion qeveritar, QKK-ja luan një rol të rëndësishëm sa i përket mbrojtjes së personave të zhvendosur në Serbi dhe Mali të Zi, dhe është duke punuar aktivisht në përkrahjen e kthimit të personave të zhvendosur në Kosovë. QKK-ja kohë pas kohe angazhohet në proceset e kthimit në Kosovë si donator / financues i projekteve apo aktiviteteve, dhe mund të marrë pjesë në GPR-të apo GPK-të, sipas nevojës. QKK-ja gjithashtu mund ta ofrojë ekspertizën teknike për organizatat zbatuese në lidhje me projektet e kthimit. QKK-ja mund t'i përkrahë përpjekjet e kthimit, duke ndihmuar lidhjet me personat e zhvendosur dhe shoqatat e tyre, dhe duke inkurajuar përfshirjen e personave të zhvendosur në strukturat e kthimit në Kosovë.

Në përgjegjësitë e QKK-së përfshihen:

1. Ofrimi i përkrahjes për PZHBV-të / refugjatët në vendin e tyre të zhvendosjes, sipas nevojës.
2. Ofrim i ndihmës materiale brenda Kosovës bazuar në prioritetet e përcaktuara nga mekanizmi i procesit të kthimit (si donator).
3. Përkrahja e përpjekjeve të integritit të bashkësive në nivelin komunal dhe nxitjen e angazhimit të pakicave në strukturat vendore.
4. Pjesëmarrja në GPR-të dhe GPK-të, sipas nevojës.

Shoqatat për persona të zhvendosur dhe refugjatë

Shoqatat për persona përkohësisht të zhvendosur dhe refugjatë dhe OJQ-të vendore të cilat punojnë me personat e zhvendosur luajnë një rol të rëndësishëm në dëgjimin e brengave dhe interesave të bashkësive të zhvendosura kosovare. Shoqatat, ndonëse me kapacitet të kufizuar, kanë mundësi të mbledhin informata nga personat e zhvendosur në vende të ndryshme dhe ta ndihmojnë qasjen individuale në informata mbi situatën në Kosovë, në dokumentet personale dhe në procesin e kthimit. Ato janë gjithënjë e më shumë duke luajtur një rol aktiv në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare për ta ngritur informimin e PZHBV-e / refugjatëve dhe për t'u lidhur me mekanizmat e vendosur në Kosovë. Shoqatat ftohen të luajnë një rol edhe më proaktiv në procesin e kthimit, duke i angazhuar strukturat aktivisht dhe duke ofruar përkrahje brenda mundësive të tyre.

Në përgjegjësitë e grupeve përfaqësuese të PZHBV-e / refugjatëve përfshihen:

1. Pjesëmarrjen në ato raste ku shtrihet nevoja në GPK-të.
2. Ofrimin e përkrahjes aktive dhe rekomandimeve mbi metodat e angazhimit të personave të zhvendosur/refugjatëve dhe shoqatave në dialog, dhe iniciativat e integritit me komunitetet shumicë nëpërmjet GPK-ve dhe Grupeve punuese lokale, si dhe nëpërmjet iniciativave të tjera përkrahëse dhe forumeve.
3. Në raste kur është e duhur i qasen organizatave ndërkombëtare për të komunikuar dhe kërkuar pjesëmarrjen e tyre në VShI dhe VShSh.
4. Përkrahjen e personave të zhvendosur për t'iu qasur informatave mbi mekanizmat e kthimit, siç janë anketimet e kryera mbi VShSh-të.
5. Ofrimin e informatave të sakta mbi kushtet për komunitete në Kosovë.
6. Përfaqësimin e drejtë të interesave të komunitetit të tyre në diskutimet mbi kthimin.
7. Ndërmarrjen e hapave aktiv drejt përkrahjes për përmirësimin e kushteve për kthim, duke punuar me asociacionet e komuniteteve shumicë në raste të duhura për të ngritur iniciativat për dialog.
8. Ofrimin e informatave të azhurnuara mbi interesat e personave të zhvendosur për tu kthyer, dhe ofrimin e informatave mbi kushtet e kthimit të personave të zhvendosur (si për shembull lokacioni i tanishëm i personave të zhvendosur/refugjatëve, vendi i tyre i prejardhjes në Kosovë, dhe kushtet e

Komponentët e procesit të kthimit

Qëllimi i këtij seksioni është theksimi i komponentëve kryesorë të cilët konsiderohen thelbësorë për procesin e gjithmbarshëm të kthimit. Nuk ka qenë qëllimi që këto të jenë as gjithpërfshirëse, e as kronologjike. Dialogu ndëretnik, toleranca ndërmjet bashkësive dhe kushtet e gjithmbarshme të pakicave në Kosovë duhet të shihen, në këtë aspekt, si pjesë integrale e procesit të kthimit.

Dialogu ndëretnik dhe integrimi i bashkësive

Edhe pse e drejta për t'u kthyer është një e drejtë fundamentale mbi të cilën nuk mund të ketë negociata, pohimi i thjeshtë i kësaj të drejte nuk siguron krijimin e një ambienti të favorshëm për kthim. Përpjekjet e drejtuara drejt tolerancës, bashkëjetesës dhe zhvillimit të një shoqërie të integruar shumetnike përbëjnë bazën e çfarëdo programi mbi kthimin. Kërkimi i konsensusit mbi konsensusin e kthimit është relativisht pa probleme. Ekzistojnë shumë pak udhëheqës të shumicës të cilët do ta kundërshtonin kthimin në parim. Sfidat shtrihen në realizimin e këtyre parimeve në praktikë.

Ndërtimi i besimit dhe konsensusi në dobi të kthimit duhet të zhvillohet në tri nivele: 1) Në nivel politik mbarëkosovar; 2) Në nivel të komunave; 3) Në nivel të bashkësive, përfshirë këtu bashkësitë shumicë, bashkësitë ekzistuese pakicë dhe PZHBV-të / refugjatët.

1) Niveli politik mbarëkosovar

Udhëheqësit kosovarë të të gjitha grupeve etnike janë në një pozitë unike për të ushtruar ndikim të konsiderueshëm mbi bashkësitë e tyre dhe, për këtë arsye, janë në pozitë ideale për t'i përmirësuar sjelljet ndaj tolerancës dhe bashkëpunimit ndëretnik. Deklaratat pozitive nga udhëheqësit, të përcjellura nga veprimet e fuqishme dhe konkrete, mund të kenë ndikim të fuqishëm në mënjanimin e porositve negative nga sektorët më ekstremë të shoqërisë. Avancimet substanciale mund të priten kur IPVQ-të dhe shoqëria vendore civile të ndërmarrin një rol themelor në këtë proces. Progresi në këtë nivel ofron kornizën në të cilën kthimi mund të përcillet në nivelet komunale dhe vendore. Udhëheqësit e njohur politikë mund të shfrytëzohen për t'u kushtuar më shumë rëndësi brengave të pakicave, posaçërisht të kthimit.

2) Niveli komunal

Grupet punuese komunale mund të ofrojnë një mjet të rëndësishëm për diskutim publik ndërmjet person-

ave të zhvendosur dhe bashkësisë së tyre të prejardhjes. Duke pasur një përbërje të përfaqësuesve vendorë, të organizatave ndërkombëtare dhe të gjitha grupeve etnike, këto grupe punuese janë forum në të cilin mund të mbahen diskutime ndërmjet palëve të interesuara, përfshirë këtu diskutimet ndërmjet PZHBV-e / refugjatëve dhe IPVQ-ve, mbi të drejtën për t'u kthyer dhe mënyrën më të mirë në të cilën kjo gjë mund të realizohet. Procesi i ndërtimit të konsensusit mbi kthimin duhet të jetë sa më i gjerë, duke përfshirë këtu një shtrirje të gjerë të iniciativave të shoqërisë civile. Përveç kësaj, kuvendet komunale kanë për detyrë t'i përfaqësojnë PZHBV-të / refugjatët dhe interesat e tyre, siç e bëjnë këtë edhe bashkësitë e tyre specifike. Përfaqësuesit e pakicave në kuvende dhe në komitete gjithashtu duhet ta ndërmarrin një rol të plotë në shprehjen e shqetësimeve të PZHBV-e / refugjatëve.

Edhe pse çdo bashkëveprim ndërmjet bashkësisë shumicë dhe PZHBV-e / refugjatëve ka mundësi për t'i përmirësuar qëllimet e harmonizimit, kjo gjithashtu mund ta përforcojë ndarjen nëse bashkëveprimi i tillë nuk përgatitet me kujdes. Tema e bisedës duhet të mbahet në nivel vendor, me theks në identifikimin e interesave të mundshëm të përbashkët. Në të njëjtën kohë, nëse bashkëveprimi ndërmjet këtyre grupeve kontrollohet në masë të tepruar, fillimi i procesit të harmonizimit mund të dëmtohet mjaft shumë. Nëse ngritet rezistenca fillestare, sa i përket përparimit në disa komuna për të theksuar rrugën që shpie përpara, kjo tek të tjerat mund të inkurajojë zhvillime të mëtutjeshme në proces.

3) Niveli i bashkësive

Edhe pse ndikohet nga zhvillimet në nivelet politike dhe komunale, angazhimi e fqinjëve të mëparshëm në një bashkësi ekzistuese ka dinamikën e veta të veçanta, kryesisht duke u varur nga marrëdhëniet e paraluftës ndërmjet grupeve etnike dhe përvojën e bashkësisë gjatë luftës, si dhe në ndryshimet demografike pas vitit 1999.

Bashkësitë lokale kanë mekanizmat e tyre për menaxhimin e konfliktit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat duhet të inkuadrohen në proces kurdo që të jetë e mundur. Mbështetja në këshillat e fshatrave dhe përfshirja e familjeve të respektuara janë dy mënyra në të cilat bashkësisat do të autorizohet në procesin e kthimit, në vend se të ndjehen se kjo gjë është duke i imponuar atyre.

Kontakti ndërmjet bashkësisë shumicë dhe PZHBV-e / refugjatëve në nivelin e bashkësisë mund të vendoset nëpërmjet bisedave të inicuar në mënyrë paralele me autoritetet lokale komunale dhe me fshatarët e bashkësive shumicë në vendin e propozuar për kthim. Kontaktet e tilla mund të ndodhin brenda GPK-së, apo brenda ekipeve specifike të projekteve të cilat u raportojnë GPK-ve dhe përfshijnë përfaqësuesit e bashkësive lokale nëpërmjet përpjekjeve të tilla. PZHBV-të / refugjatët me këtë rast u eksponohen në masë mjaft të madhe përfaqësuesve të bashkësisë shumicë.

Planifikimi i përbashkët i kthimeve specifike ofron një mjet për bashkëveprim ndërmjet të kthyerve dhe bashkësisë mikëpritëse. Diskutimet mund të përqëndrohen në pika të ndërlidhjes, gjë që thekson interesat e përbashkëta. Kjo duhet të ndihmojë në uljen e nivelit të zemërimit dhe në krijimin e një atmosfere të besimit, bashkëveprimit dhe integritit.

Mënyra në të cilën janë planifikuar aktivitetet mund ta ngrisë integrimin afatgjatë duke u siguruar që shërbimet të krijojnë lidhje ndërmjet bashkësive. Ofrimi i shërbimeve të shëndetësisë, arsimit fillor, shërbimeve sociale dhe shpërndarjes së ndihmës humanitare do të duhej të përqëndrohej në krijimin e lidhjeve ndërmjet bashkësive. Mënyra në të cilën aktivitetet zbatohen gjithashtu mund ta ofrojë mjetin për inkurajimin e integritit. Për shembull, nëse rindërtimi i shtëpive të të kthyerve bëhet një përpjekje shumetnike - duke punësuar fshatarë shqiptarë të Kosovës për të punuar në shtëpitë e bashkësive të kthyerja jo-shqiptare të Kosovës, dhe të kthyerit për të punuar në projekte të integritit të bashkësive - është një mënyrë për përmirësimin e lidhjeve ndërmjet të kthyerve dhe bashkësive mikëpritëse, dhe krijimit të bazës për bashkëpunim më të madh.

Tejkalimi i pengesave të dialogut në nivel lokal:
Ekzistojnë arsye shumë të ndryshme për kundërshtimin e kthimit në nivelin lokal: disa prej këtyre mund

të jenë relativisht legjitime (p.sh. frika nga pasiguria, traumat e ndërlidhura me luftën), kurse të tjerat mund të mos jenë (p.sh. uzurpimi i pronës). Frika e dëbimit nga qarqet vendimmarrëse dhe e zemërimit të ndërlidhur me kthimin gjithashtu është bërë dukshëm më e qartë. Ngjashëm, një mori kushtesh shpesh i bashkangjiten kthimit: "kthimet mund të ndodhin vetëm nëse..." Këto vërejtje dhe kushte nuk duhet të legjitimizohen, por arsyet të cilat i shkaktojnë ato duhet të hulumtohen dhe të trajtohen sipas nevojës. Hulumtimi i këtyre çështjeve më të ndërlidhura, dhe adresimi i shqetësimeve legjitime do të ndihmojnë në zbutjen e procesit të dialogut ndëretnik.

Një ndër deklaratat që së shumti dëgjohej për kthimin është se çdokush mund të kthehet, nëse nuk ka kryer krime lufte. Duhet të theksohet se në Kosovë ekziston një sistem funksional i ligjit dhe drejtësisë, me pushtet për t'i gjykuar krimet e luftës. Për më tepër, krimet kryhen nga individët, e jo nga grupet etnike, dhe njerëzit e pafajshëm nuk mund të dënohen thjeshtë për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Të gjitha dëshmitë duhet t'i ofrohen policisë, e cila më pas do të kryejë një hetim të mirëfilltë, dhe nëse dëshmitë janë të mjaftueshme, kjo do të rezultojë në një proces penal gjyqësor. Të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e kthimit duhet ta theksojnë zotimin e tyre ndaj ndjekjes penale të krimeve të luftës, dhe të gjitha përpjekjet për t'i lidhur të dyja çështjet për ta parandaluar kthimin duhet të refuzohen.

Nëse paraqiten probleme të paparashikuara, atëherë përfshirja e organeve për zbatimin e ligjit dhe rendit (SHPK-së, policisë ndërkombëtare, KFOR-it), është e nevojshme nëse kërcënohet zbatimi i projektit të kthimit. Në rrethana të tjera, ndërmjetësimi dhe bindja janë më efikase. Për shembull, kur kthimi i qytetarëve ashkali në Vushtri ka hasur në probleme, kryeministri, dr. Rexhepi, ka intervenuar për ta inkurajuar bashkësinë shumicë për t'iu përgjigjur më pozitivisht kthimit. Iniciativa të ngjashme mund të ndërmerren në nivel komunal. Duhet të mbahen takime të rregullta me të gjithë aktorët, posaçërisht me PZHBV-të / refugjatët dhe bashkësitë pritëse, për t'u përballur me këto çështje gjersa ato lindin dhe për t'u siguruar që të mirëmbahet mirëbesimi në proces.

Vlerësimi dhe mbledhja e informatave

Ky seksion identifikon mjetet dhe resurset e planifikimit të cilat janë në dispozicion për t'u ndihmuar palëve të angazhuara në procesin e kthimit. Këto mjete nuk është e domosdoshme të merren dhe zbatohen në mënyrë kronologjike. Për më tepër, këto mund të shfrytëzohen në çfarëdo faze të procesit, sipas rrethanave lokale. Këto gjithashtu duhet të identifikohen si veprime të cilat mund të ndërmerren nga GPK-të në mënyrë që ato të jenë të përgatitura për përgjigje sa më efikase ndaj kërkesave të cilat ngrihen nga PZHBV-të / refugjatët e interesuar për t'u kthyer në vendet e tyre të prejardhjes dhe ata të cilët kërkojnë ndihmë për ta bërë një gjë të tillë. Veprimet e mundshme janë si vijon:

Identifikimi i vendeve të zhvendosjes së PZHBV-e

Për të mbledhur informata mbi vendet e tanishme të personave të zhvendosur nga komuna, kryesuesi i GPK-së mund të kërkojë nga UNHCR-ja dhe anëtarët e tjerë përkatës të GPK-së, të mbledhin dhe / ose transmetojnë informata bazë mbi vendet e zhvendosjes së PZHBV-e së bashku me informatat e tyre mbi fshatin / lagjen e prejardhjes së paraluftës. UNHCR-ja bën përgatitjen dhe paraqitjen e këtyre të dhënave në Hartën e zhvendosjes për GPK-në.

Vlerësimi i vendeve të

banuara nga pakicat në periudhën e paraluftës

Vlerësimi i vendeve në të cilat pakicat kanë jetuar para luftës do të ofronte një bazë relativisht objektive për t'u shfrytëzuar me rastin e planifikimit të një procesi transparent dhe të depolitizuar të kthimit, sapo të shfaqet interesi nga ana e PZHBV-e / refugjatëve për t'u kthyer në një vend specifik.

Fillimisht, kryesuesi i GPK-së formon një ekip për ta zbatuar Profilin e shpejtë të vendit (PSHV - shih Shtojcën 1A dhe B për ta parë formatin) dhe përcakton një udhëheqës të ekipit të UNMIK-ut, i cili bën përpilimin e informatave. Ky ekip duhet të përbëhet nga aktorët kryesorë ndërkombëtarë të përfshirë në GPK. Më pas, ekipi duhet ta shfrytëzojë formatin e PSHV-së për ta anketuar çdo fshat apo lagje nga të cilat pakicat janë larguar gjatë luftës ose pas saj, vendin për të cilin është identifikuar interesi për kthim. Për të ndihmuar në procesin e përpilimit të PSHV-ve, çdo anëtar i GPK-së duhet të mbledhë dhe ndajë të dhënat ekzistuese mbi vendet specifike me ekipin. Sapo të përfundohet, udhëheqësi i ekipit ia paraqet GPK-së PSHV-në e përpiluar.

Vlerësimi i sigurisë së vendeve të mundshme për kthim

Vlerësimet e sigurisë së fshatit mbi vendet e mundshme për kthim ofrojnë udhëzime më vonë në proces për vendimet e ndërlidhura me dhënien e prioritetit këtyre vendeve. Me kërkesën e kryesuesit të GPK-së, KFOR-i, dhe SHPK-ja i kryejnë vlerësimet (shih Shtojcën 7 për ta parë formatin) e të gjitha fshatrave dhe lagjeve të cilat para luftës kanë qenë të banuara nga pakicat, dhe për të cilat është identifikuar interesi për t'u kthyer. KFOR-i dhe SHPK-ja më pas ia paraqesin GPK-së rezultatet e veta sipas vendit. Ky proces ndërmerret duke marrë parasysh që rëndësia e vlerësimeve të sigurisë mbetet e përkohshme dhe duhet të shfrytëzohet vetëm si udhëzim në botëkuptim të gjerë (për shembull, vlerësimi i sigurisë mund të japë leje nisjeje për një vizitë shko dhe shiko në një vend specifik, por gjithashtu edhe të rekomandojë që më tepër punë duhet të bëhet me bashkësinë pranuese para se të ndërmerret kthimi). Rezultatet e vlerësimit janë vetëm një faktor në procesin e vendimmarrjes me rastin e vlerësimit të kushteve për kthim në një zonë të caktuar.



Vizitat shko dhe informo dhe shko dhe shiko

Vizitat shko dhe informo dhe shko dhe shiko janë dy mënyra të rëndësishme për vendosjen e lidhjeve ndërmjet bashkësive shumicë dhe atyre të zhvendosura. Që të dyja llojet e iniciativave duhet të planifikohen me kujdes. Vizitat shko dhe informo duhet t'i përfshijnë anëtarë të bashkësisë shumicë, të cilët janë të përgatitur që të flasin hapur dhe singërisht me PZHBV-të / refugjatët mbi kthimin. Simbolizmi i vizitave të tilla për PZHBV-të / refugjatët mund të jetë i madh. Ngjashëm, vizitat shko dhe shiko, kur të aranzohen siç duhet, mund të japin kontribute të mëdha në ndërtimin e besimit. Ato duhet të mundësojnë bashkëveprim maksimal ndërmjet PZHBV-e / refugjatëve dhe bashkësisë shumicë, duke përfshirë këtu së paku dy lloje të takimeve: pritje zyrtare për PZHBV-të / refugjatët në komunë, me ç'rast ata mirëprehen nga zyrtarët komunalë; dhe takimet me fqinjët e mëparshëm në vendet e mundshme për kthim. Pjesëmarrësit e bashkësisë shumicë duhet të përgatiten me kujdes për takime të tilla, me njohuri të plotë të vizitave të planifikuara dhe qëllimeve të tyre. Përveç kësaj, organizimi i VSHSH-ve me pjesëmarrjen e plotë të SHPK-së përforcon perceptimin që institucionet e tanishme të Kosovës janë këtu për t'i mbrojtur të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë këtu edhe PZHBV-të / refugjatët.



Vizitat shko dhe informo

Si hapa të rëndësishëm për t'iu përgjigjur dëshirave të shprehura të kthimit të mundshëm dhe për sigurimin e dialogut me personat e zhvendosur, GPK-ja do të organizojë "Vizita shko dhe informo" (VSHI). VSHI-ja ka për qëllim t'i informojë banorët e zhvendosur, në vendin e tyre të zhvendosjes, mbi gjendjen e tanishme të komunës, fshatit ose lagjes së tyre, dhe prandaj synon t'iu mundësojë PZHBV-e / refugjatëve që të marrin vendim mbi mundësinë e kthimit.

UNHCR dhe partnerët e saj i organizojnë VSHI-të në vendet në të cilat janë duke banuar bashkësitë e zhvendosura. Zakonisht, këto vizita do të kryhen në vendet e identifikuara nga GPK-të sipas hapave të lartpërmendur, apo nëpërmjet ftesës nga ndonjë bashkësi e personave të zhvendosur. Për shkak të vëllimit të vendeve të zhvendosjes apo numrit të kërkesave nga PZHBV-të / refugjatët, UNHCR-ja mund të ketë nevojë t'iu japë prioritet vendeve të VSHI-ve. Dhënia e prioritetit do të bazohet në informatat e mbledhura nga PSHV-të, vlerësimet e sigurisë, aktivitetet e hartave mbi të zhvendosurit, si dhe në nivelin e interesit të demonstruar për VSHI-në nga bashkësia e zhvendosur. UNHCR do ta azhurnojë dhënie e prioritetit të vet mbi vendet e VSHI-ve gjatë identifikimit të kërkesave të reja për VSHI-të. Pasi të bëhet përcaktimi i vendeve të viz-

itës, UNHCR-ja do të organizojë dhe kryesojë takime me familjet e zhvendosura dhe do t'i ftojë anëtarët ndërkombëtarë dhe vendorë të GPK-së për ta mbajtur një takim informativ dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve. Secili anëtar pjesëmarrës i GPK-së duhet ta përgatisë një informim të shkurtër që më parë, dhe paraqitjet duhet të ndahen dhe të diskutohen me anëtarët e tjerë para fillimit të VSHI-së. Me përfundimin e vizitës, UNHCR-ja do t'ua ofrojë pjesëmarrësve mundësinë për të udhëtuar në shtëpitë e tyre të paraluftës në Kosovë, si pjesë e vizitës shko dhe shiko. UNHCR, më pas, do ta përgatisë dhe shpërndajë GPK-së një raport mbi VSHI-në në takimin e ardhëm. Kryesuesi i GPK-në do të jetë përgjegjës për veprimet e nevojshme përcjellëse, të cilat janë rrjedhojë e VSHI-së.

VSHI-të duhet të përfshijnë anëtarë të bashkësisë shumicë, të cilët janë të përgatitur të flasin në mënyrë të hapur dhe të singertë me PZHBV-të / refugjatët mbi kthimin. Gjithashtu është praktike përfshirja e pjesëtarëve të bashkësisë pakicë të cilët kanë mbetur në vendin e interesuar, apo personave të zhvendosur nga komuna e interesuar. Ata gëzojnë shkallën më të lartë të besueshmërisë me rastin e informimit të PZHBV-e / refugjatëve mbi kushtet e jetesës së bashkësisë së tyre etnike në vendin e prejardhjes.

Vizitat shko dhe shiko

Vizitat shko dhe shiko (VSHSH) janë një mënyrë qenësore e planifikimit për ta matur mundësinë për kthim në ndonjë vend. Personat e zhvendosur ftohën për t'i vizituar shtëpitë e tyre të paraluftës si pjesë e një vizite të organizuar, me ç'rast sigurimi dhe transporti ofrohen për kohën e cila nevojitet për t'i përmbushur qëllimet e vizitës. Nëpërmjet këtij procesi, familjet e zhvendosura do të mund t'i vlerësojnë mundësitë e tyre të kthimit më të mirë, duke marrë parasysh situatën e tanishme në komunën e tyre.

VSHSH-të në disa vende ende përballen me një shkallë të armiqësisë. Rreziku i armiqësisë mund të ulet nëpërmjet përgatitjes së kujdesshme, njohurive mbi prapavijën e vendeve të propozuara për t'u vizituar, dhe përgatitjeve të sigurimit të nevojshëm. Përgatitja duhet të marrë parasysh bashkësinë lokale, dhe PZHBV-të / refugjatët. Të gjithë fshatarët duhet të jenë të informuar paraprakisht mbi vizitën e propozuar, qëllimet dhe parimet që e



frymëzojnë vizitën: në këto raste, takimet në fshatra mund të jenë shumë efikase. Nëse është e mundur, këshilli komunal apo zyrtarët administrativë duhet të inkurajohen që t'i shoqërojnë PZHBV-të / refugjatët gjatë gjithë VSHSH-së, si pjesë e angazhimit të tyre për t'ua ofruar PZHBV-e / refugjatëve lirinë e lëvizjes, dhe në këtë rast duhet nënvizuar legjitimitetin e vizitave në sytë e bashkësisë vendore. Përfshirja e SHPK-së në vend të KFOR-it dërgon një porosi të rëndësishme si për bashkësitë lokale, ashtu edhe për PZHBV-të / refugjatët, për sigurimin e rendit dhe të qetësisë, si dhe përfshirjen dhe përgjegjësinë lokale për procesin e kthimit. KFOR-i, sidoqoftë, duhet të jetë i gatshëm për të ndërhyrë nëse lindin probleme të sigurisë.

Kryesuesi i GPK-së kërkon nga UNHCR-ja t'i organizojë VSHSH-të për familjet e zhvendosura të cilat kanë treguar interesim gjatë VSHI-ve, apo nëpërmjet një kërkesë të posaçme dhe të qartë nga PZHBV-të për një VSHSH. UNHCR-ja është përgjegjëse për organizimin, por mund t'ia delegojë zbatimin ndonjë agjencioni udhëheqës apo ndonjë OJQ-je tjetër partnere. UNHCR-ja është përgjegjëse për përgatitjen e listës së pjesëmarrësve. Asnjë anëtar i GPK-së nuk mund të vëjë veto mbi pjesëmarrjen e mundshme të ndonjë të kthyeri në VSHSH, sidoqoftë, PZHBV-të / refugjatët e interesuar duhet të informohen mbi çfarëdo kundërshtimesh të shprehura nga bashkësia vendore që ka parasysh kërcënimin e mundshëm të sigurisë. UNHCR do të sigurojë transparencë me rastin e përzgjedhjes së personave të zhvendosur të cilët marrin pjesë në VSHSH-të, si dhe do të sigurojë që grupi të jetë përfaqësues i bashkësisë së vet.

Hapi 1: UNHCR, (apo i deleguari i saj) është përgjegjës për kontaktimin e pjesëmarrësve individualë të cilët do të marrin pjesë në VSHSH, si dhe për organizimin e transportit prej vendit të zhvendosjes deri në Kosovë. KFOR-i dhe / ose Policia e UNMIK-ut janë përgjegjës për ofrimin e përcjelljes së pjesëmarrësve brenda Kosovës, sipas nevojës. Me të arritur në komunë, kryetari i këshillit komunal dhe administratori komunal duhet t'i përshëndesin të kthyerit e mundshëm dhe pastaj ta japin një informim të shkurtër. Në këtë takim, të kryesuar nga UNHCR-ja, anëtarët e GPK-ve i informojnë pjesë-

marrësit e VSHSH-ve mbi gjendjen e tanishme të vendit të tyre të banimit të paraluftës. Çështjet që janë me interes të veçantë për PZHBV-të / refugjatët, siç janë mundësitë për rindërtimin e shtëpive, DÇPB-ja, mundësitë e mëparshme të punësimit dhe krijimit të të ardhurave, siguria dhe liria e lëvizjes, ndihma sociale dhe pensionet, arsimi, si dhe struktura dhe menaxhimi i komunës, duhet të përfshihen si pjesë e këtyre informimeve. Si edhe në rastin e takimeve informative të VSHI-ve, të gjitha paraqitjet duhet të përgatiten para VSHSH-së dhe të diskutohen me anëtarët e GPK-së.

Hapi 2: Me përkrahjen e Policisë dhe UNMIK-ut, UNHCR-ja (apo i deleguari i saj) është përgjegjës për vizitat në shtëpitë individuale të pjesëmarrësve. Kjo është një mundësi për PZHBV-të / refugjatët që t'i vizitojnë lagjet e tyre të mëhershme dhe t'i rivendosin lidhjet me bashkësinë e tyre të vjetër. Për ta pakësuar mundësinë e trazirave publike dhe / ose destabilizimin e marrëdhënieve të bashkësisë, anëtarët e GPK-ve duhet të mbajnë kontakt me bashkësinë mikpritëse

para se ta bëjnë paraqitjen e sërishme të personave të zhvendosur në lagjet e tyre të mëparshme. Përveç kësaj, stresi emocional i vizitës në shtëpitë e prejardhjes nuk duhet të nënçmohet. Prandaj, anëtarët e GPK-së, të cilët marrin pjesë në VSHSH, duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë cënueshmërisë së personave të zhvendosur. Përveç policisë civile, OJQ-të, UNMIK-u dhe UNHCR duhet t'i shoqërojnë personat e zhvendosur, nëse kërkohet përcjellje.

Hapi 3: Pas "vizitave në shtëpi," UNHCR-ja (apo i deleguari i saj) do të mbajë intervista individuale me pjesëmarrësit e VSHSH-së (shih Shtojcën 3 për sugjerime mbi intervistat) me ndihmën e UNMIK-ut, me partnerët e mundshëm zbatues dhe me anëtarët e tjerë të GPK-së. Këto sesione duhet të mbahen në baza vullnetare dhe duhet të synojnë që të mbledhin informata përkatëse mbi PZHBV-të / refugjatët dhe kushtet e tyre në zhvendosje. Të dhënat për gjendjen

e tanishme të individit, përvojën e punësimit të mëparshëm dhe aftësitë e tjera, sigurimi i mundshëm i të ardhurave me rastin e kthimit, dhe marrëdhëniet e mëparshme me fqinjët janë informatë e dobishme për zhvillimin e projekteve dhe planifikimin e kthimit të mundshëm. Me rastin e përfundimit të VSHSH-së, UNHCR-ja i mbledh të gjitha informatat mbi sondazhin dhe ato ia paraqet GPK-së në takimin e ardhëm.

Procesi i projekteve të kthimit

Procesi i projekteve të kthimit përshkruan mjetet në dispozicion për ta zhvilluar dhe zbatuar kthimin e ndihmuar të grupeve të personave të zhvendosur në një vend të caktuar. Procesi në tërësi varet nga treguesit e kërkesës për t'u kthyer, dhe në harmonizimin e resurseve ndaj prioritetëve të caktuara brenda procesit të projektit të kthimit. Qëllimi kryesor i këtij procesi është sigurimi që projektet e kthimit të përgatiten dhe t'u jepet prioritet, dhe që ato të financohen. Procesi i besueshëm dhe transparent i zhvillimit të projektit dhe i dhënies së prioritetit këtij projekti është një mjet qenësor për sigurimin e përkrahjes së donatorëve në përpjekjet për kthim.

Nga identifikimi i "nevojave për kthim" ⁸ e gjer tek zbatimimi ekzistojnë elemente të ndryshme të mundshme në procesin e projekteve të kthimit. Sidoqoftë, duhet të theksohet se këto elemente mund dhe duhet të ndodhin paralelisht gjatë zhvillimit të projekteve të ndryshme - me fjalë të tjera, nuk duhet të ekzistojë ndonjë kohë e caktuar në të cilën vërehen boshllëqet dhe përgatiten koncept dokumentet. Në vend të kësaj, procesi i projekteve të kthimit duhet të jetë në dispozicion dhe në çdo kohë t'u përgjigjet nevojave rishtazi të identifikuar të kthimit.

Projektet në të cilat financimi tashmë është siguruar

Siç është përmendur edhe më parë, në disa raste, donatorët tashmë do t'i kenë identifikuar projektet dhe OJQ-të si partnerë zbatues, duke eliminuar nevojën për fazat e hershme të procesit të përmblodhur më poshtë. Projektet e tilla janë të përshpejtuara dhe vetëm duhet t'i paraqiten grupit punues komunal për miratim para vendimit përfundimtar të donatorit mbi financimin dhe zbatimin e projektit. Ky hap është vendimtar, pasi angazhimi i pjesëmarrësve të grupit punues komunal do të jetë qenësor për zbatimin e suksesshëm të pothuaj çfarëdo iniciative për kthim.

Njohja e dëshirës së shprehur të personave të zhvendosur dhe identifikimi i nevojave për kthim

Procesi i projekteve për kthim krejtësisht mbështetet në njohjen dhe reagimin ndaj dëshirave të shprehura të personave të zhvendosur për t'u kthyer. Procesi i identifikimit të nevojave për kthim ndodh në mënyra të ndryshme, dhe shfrytëzon një numër të burimeve të informimit. Personat e zhvendosur mësojnë mbi procesin e ndihmës me rastin e kthimit dhe gjendjen e vendbanimeve të tyre të paraluftës nga pjesëtarët e bashkësisë të tyre të cilët banojnë në Kosovë, pjesëtarë të tjerë të bashkësisë të tyre etnike nga vendet e afërta, persona të zhvendosur në komunë apo në ndonjë vend të afërt me vendin e prejardhjes, nëpërmjet

OJQ-ve, "vizitave shko dhe informo" dhe "vizitave shko dhe shiko", si dhe nëpërmjet mënyrave të tjera jozyrtare (p.sh. mediat apo vizitat personale në vendin e tyre të prejardhjes, apo projektit të kornizës së përbashkët mbi informimin). OJQ-të që punojnë brenda bashkësive të zhvendosura gjithashtu luajnë rol të rëndësishëm duke u takuar me personat e interesuar për t'u kthyer, dhe duke identifikuar nevojat për kthim. Shkëmbimi i informatave gjatë vizitave shko dhe shiko ofron një tregues të mëtejshëm të dëshirave të personave të zhvendosur dhe të nevojave për kthim. Shoqatat dhe organizatat e personave të zhvendosur angazhohen me organizatat ndërkombëtare dhe GPK-të për t'i shfaqur nevojat për kthim të bashkësive apo të individëve të veçantë.

Me rastin e identifikimit të nevojave, personat e zhvendosur, OJQ-të, dhe të gjithë të përfshirët në procesin e kthimit mund t'i shfrytëzojnë vlerësimet dhe informatat e mbledhura, siç janë profilet apo vlerësimet e fshatrave apo të lagjeve nga të cilat njerëzit janë zhvendosur, profilet e vendeve të kthimit, kurdo që ato të jenë në dispozicion; grupet punuese komunale gjithashtu mund të përpilojnë profile plotësuese në raste në të cilat informatat konsiderohen të pamjaftueshme. Vlerësimet e sigurisë, të kryera nga KFOR-i / SHPK-ja lidhur me fshatrat dhe lagjet e banuara nga pakicat në periudhën e paraluftës janë elemente kryesore në këtë proces.

⁸ Termi "nevoja për kthim" shfrytëzohet për ta përshkruar në përgjithësi një boshllëk në të cilin ende nuk janë përmblodhur kërkesat e personave të zhvendosur për t'u kthyer.

Grupet punuese komunale ofrojnë mundësi për të gjithë të përfshirët në procesin e kthimit për të shpërndarë informata lidhur me nevojat e kthimit, dhe për të diskutuar për rajonet në të cilat janë identifikuar nevojat për kthim.

Përgatitja e koncept dokumenteve

Sapo të identifikohen nevojat për kthim, hapi i ardhshëm në procesin e projekteve të kthimit do të jetë krijimi i koncept dokumenteve të cilat i skicojnë projektet e kthimit për t'i përmbushur nevojat e identifikuar për kthim. Grupet punuese komunale do t'i inkurajojnë të gjitha palët e interesuara për t'i krijuar koncept dokumentet për nevojat e identifikuar për kthim. Me rastin e kërkesës së koncept dokumenteve, grupeve punuese komunale u rekomandohet që ta hartojnë një kornizë e cila i identifikon nevojat e gjera të cilat duhet të përmbushen nga projekti (përfshirë këtu ato të bashkësisë pranuese) brenda katër "sektorëve të mundshëm të projekteve. 1) ndihma në rindërtimin / riposedimin e shtëpive; 2) infrastruktura; 3) programi për punësim dhe krijim të të ardhurave; dhe 4) dialogu dhe integrimi ndëretnik, dhe aktivitetet e bashkësisë.

Kryesuesi i GPK-së mund ta përcaktojë një anëtar të GPK-së për ta skicuar kornizën për koncept dokument. Ndihma nga njësisia rajonale për kthim mund të kërkohet nëse paraqitet nevoja. Kryesuesi i GPK-së do t'ua shpërndajë kornizën dhe kornizën e koncept dokumentit (shih shtojcën) të gjithë partnerëve të interesuar në zhvillimin dhe paraqitjen e koncept dokumenteve. Koncept dokumentet më së shpeshti do të krijohen nga OJQ-të e interesuara për zbatimin e projektit të propozuar. Sidoqoftë, koncept dokumentet gjithashtu mund të krijohen nga anëtarët e grupeve punuese komunale (UNMIK-u, UNHCR-ja, KFOR-i, autoritetet komu-

nale, etj.), nga personat e zhvendosur apo përfaqësuesit e tyre. Kryesuesi i GPK-së do ta caktojë një afat përfundimtar kohor për OJQ-të e interesuara, anëtarët e GPK-së, si dhe të tjerët, për të krijuar koncept dokumente si përgjigje ndaj kornizës për koncept dokumente. Strukturat komunale, nëpërmjet GPK-ve, do të jenë në dispozicion për t'u ofruar OJQ-ve dhe të tjerëve informata të cilat konsiderohen përkatëse për të kontribuar në përpilimin e koncept dokumentit për projektin e popozuar.

Rishikimi i koncept dokumenteve dhe dhënia e prioritetit nga grupet punuese komunale

GPK-ja është përgjegjëse për rishikimin e koncept dokumenteve të dorëzuara nga partnerët bazuar në Kriteret për shqyrtimin e koncept dokumenteve nga ana e GPK-ve (shih shtojcën 5). Përqëndrim i posaçëm do t'i kushtohet vlerësimit se a është pasqyruar vullneti i demonstruar (dhe i informuar) i personave të zhvendosur për t'u kthyer, dhe nëse procesi i kthimit, i propozuar në koncept dokument, është i qëndrueshëm. Koncept dokumentet gjithashtu përfshikruajnë projektin në hollësi të mjaftueshme në mënyrë që GPK-të ta vlerësojnë qëndrueshmërinë dhe koston e projektit të propozuar, dhe për ta vlerësuar mundësinë dhe ekspertizën përkatëse të organizatës zbatuese.

Përparësi gjatë procesit të shqyrtimit të koncept dokumenteve do t'u jepet organizatave zbatuese të cilat propozojnë qasje shumësektorale, e cila i përfshin të gjithë sektorët përkatës. Në të njejtën kohë, të gjitha organizatat zbatuese nuk do ta kenë mundësinë apo ekspertizën për të ndërmarrë projekte shumësektorale. Në raste të tilla, organizatat zbatuese inkurajohen që t'u bashkangjiten OJQ-ve të tjera (posaçërisht OJQ-ve lokale) dhe të dorëzojnë koncept dokumente të cilat pasqyrojnë një qasje "partneriteti" ndaj projektit. Përfundimisht,



partnerët zbatues të cilët nuk janë në gjendje të dorëzojnë koncept dokumente të cilat i drejtohen tërë projektit, apo të bashkangjiten në ndonjë partneritet i cili mund ta bëjë një gjë të tillë, duhet t'i dorëzojnë koncept dokumentet të cilat përshkruajnë komponentin e projektit të cilin OJQ-ja do të ishte e gatshme që ta zbatonte. Në raste të tilla GPK-të mund të marrin parasysh lidhjen e paraqitjeve të tilla për ta arritur një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumësektorale ndaj projektit të propozuar.

Siç është përshkruar në hollësi në kornizën e koncept dokumentit, koncept dokumentet të cilat demonstrojnë shfrytëzimin strategjik të komponentëve të projektit për ta përmirësuar qëndrueshmërinë e projektit inkurajohen (p.sh., përpjekjet për ta inkuadruar tërë bashkësinë në program nëpërmjet përfshirjes së komponentëve të infrastrukturës që janë të dobishme si për bashkësinë që kthehet, ashtu edhe për bashkësinë pranuese). Përpos kësaj, koncept dokumentet duhet ta demonstrojnë qartazi një qasje "të nxitur nga kërkesa", duke artikuluar metodat të cilat do të shfrytëzohen për ta përcaktuar nivelin e interesit në bashkësinë e personave të zhvendosur me rastin e zhvillimit dhe zbatimit të projektit. Koncept dokumentet duhet të formatizohen në përputhje me "Kornizën e koncept dokumentit", dhe duhet t'i përfshijnë këto komponente: qëllimet, rezultatet, treguesit, veprimtaritë dhe së fundi, një buxhet i llogaritur dhe afati.

Më pas, pjesëmarrësit e GPK-së do t'i miratojnë koncept dokumentet. Siç është përcaktuar, parapëlqehet që GPK-të të marrin vendime me anë të konsensusit. Në rast se kjo nuk arrihet, pushteti përfundimtar i përket kryesuesit të GPK-së (administratorit komunal). Për më tepër, OJQ-të apo të tjerët të cilët dorëzojnë koncept dokumente do të kenë një rol në diskutimin e GPK-së mbi dokumentin, por do të mbeten si vëzhgues gjatë procesit të miratimit dhe dhënies së prioritetit, bazuar në mundësinë për konflikt të interesave.

Grupet punuese komunale do t'i shqyrtojnë koncept dokumentet në baza të vazhdueshme (derisa ato arrijnë), për të përcaktuar nëse ndonjë projekt i propozuar është duke iu qasur nevojave të identifikuar në përputhje me politikën e kthimit të artikuluar në koncept dokumentin për kthim të qëndrueshëm të majit të vitit 2002. Posaçërisht, kon-

cept dokumentet duhet ta diskutojnë kërkesën për një projekt të tillë nga ana e përfituesve të mundshëm, si dhe procesin i cili do të shfrytëzohet për përzgjedhjen e përfituesve. Bazuar në shqyrtimin e koncept dokumenteve, grupet punuese komunale i miratojnë projektet e mundshme. Në raste në të cilat koncept dokumente të shumëta dorëzohen për një komunë apo për një vend të vetëm, GPK-ja do t'u japë prioritet projekteve të propozuara për t'i pasqyruar parimet e lartpërmendura udhëzuese. Veç kësaj, ky proces ndodh në baza të vazhdueshme, përderisa pranohen koncept dokumente të reja. Me rastin e vlerësimit të koncepteve të ndryshme për vendet e njëjta, përparësi do t'u jepet koncept dokumenteve të cilat propozojnë qasje shumësektorale që i mbulojnë të gjithë sektorët përkatës.

Shqyrtimi rajonal dhe dhënia e prioritetit

Grupet punuese rajonale përpilojnë një listë me prioritetet të koncept dokumenteve në nivel komunal. Lista e koncept dokumenteve me prioritet të nivelit komunal do t'i përcillet nivelit rajonal, ku lista diskutohet dhe shqyrtohet nga grupi punues rajonal.

Grupet punuese rajonale përpilojnë një listë me prioritetet rajonale të projekteve të propozuara, bazuar në informatat e ofruara nga grupet punuese komunale dhe në kritere specifike: proporcionaliteti etnik, proporcionaliteti gjeografik, cënueshmëria, qëndrueshmëria, dhe efektshmëria (kostoja për përfitues). Me rastin e përgatitjes së listës së projekteve, grupi punues komunal përqëndrohet në nivelin në të cilin projekti i propozuar është në përputhje me politikën dhe parimet e kthimit, dhe në veçanti, në përmasën në të cilën projekti u përgjigjet kërkesave të personave të zhvendosur.

Përgatitja e listës së projekteve me prioritet të Kosovës

Listat e projekteve i përcillen grupit për koordinimin e kthimit. Grupi për koordinimin e kthimit mban përgjegjësi për zhvillimin (dhe azhurnimin) e një liste të projekteve me prioritet për tërë Kosovën. Për ta arritur këtë qëllim, grupi për koordinimin e kthimit do të mbështetet në bordin këshilldhënës teknik (BKT-në). Antarësia e BKT-së, përveç antarëve të grupit për koordinimin e kthimit, përfshin edhe përfaqësuesit e OJQ-ve të cilat janë organizata zbatuese dhe bashkësinë e donatorëve. Anëtarësia e BKT-së¹⁰

¹⁰ Kriteret e njëjta do të vlejnë: proporcionaliteti etnik, proporcionaliteti gjeografik, cënueshmëria, qëndrueshmëria, dhe efektshmëria (kostoja për përfitues).

do të përbëhet nga individë me ekspertizë të veçantë teknike në projektimin dhe zbatimin e projekteve. Grupi për koordinimin e kthimit do t'i vendosë kriteret për shqyrtimin e projekteve të cilat do të zbatohen nga ana e BKT-së. BKT-ja do t'i shqyrtojë koncept dokumentet dhe listat e projekteve rajonale, dhe do t'i ofrojë rekomandime grupit për koordinimin e kthimit në lidhje me listën e përpiluar të projekteve me prioritet. Grupi për koordinimin e kthimit përpilon dhe azhuron listën e projekteve me prioritet, duke u bazuar në rekomandimet e dhëna nga BKT-ja.

Qarkullimi i listës së projekteve me prioritet

Lista e projekteve me prioritet është mjeti primar për ta bërë përgatitjen e ofertës për financim nga donatorët e projekteve për kthim. ZKB-ja, UNHCR-ja dhe anëtarët e tjerë të grupit për koordinimin e kthimit, ua qarkullojnë donatorëve të mundshëm dhe organizatave zbatuese listën e projekteve me prioritet. Përpjekjet e të gjithë të përfshirëve në procesin e kthimit, sa i përket kërkimit të fondeve për çështjen e kthimit, duhet të jenë në përputhje me listën e projekteve me prioritet, dhe duhet të koordinohen me ZKB-në.

Kërkesa dhe përgatitja e propozimeve të plota

Donatorët e interesuar në projektet e përfshira në listën e projekteve me prioritet do të kërkojnë propozime të plota në përputhje me kërkesat e tyre. Në rastet në të cilat koncept dokumenti për projektin në listën me prioritet është krijuar nga organizata zbatuese, donatorët do të inkurajohen të punojnë nëpërmjet organizatës e cila e ka dorëzuar koncept dokumentin e miratuar. Propozimet e plota të projekteve duhet të jenë në përputhje me koncept dokumentin e miratuar nga grupi punues komunal, dhe me politikën e kthimit të caktuar në koncept dokumentin për kthim të qëndrueshëm.

Zhvillimi i projekt propozimeve shumësektorale

Projekt propozimet e plota do të kërkohen dhe zhvillohen vetëm pasi GPK-ja ta ketë miratuar koncept dokumentin dhe donatori të ketë shfaqur interesim për ta financuar atë projekt. Në rastet kur organizatat zbatuese tanimë kanë në dispozicion mjete financiare, do të kërkohet nga ato që drejtpërdrejt ta dorëzojnë një projekt propozim të hollësishëm shumësektoral për GPK-në dhe GPR-në. Projekt propozimet e plota duhet të jenë në përputhje me kriteret e ndihmës së përfituesve të kthimit dhe me udhëzimet e projekteve shumësektorale ku theksohen kërkesat për ndihmën në

rindërtimin e shtëpive, ndërtimin e programit të infrastrukturës, programin për punësim apo krijim të të ardhurave, dialogun ndëretnik dhe aktivitetet e bashkësisë. Personat e zhvendosur inkurajohen të punojnë me OJQ-të e tjera, vendore apo ndërkom-bëtare, të cilat kanë përvojë të veçantë në një sektor. Ata gjithashtu duhet të punojnë në konsultim me administratën lokale.

Shqyrtimi përfundimtar i propozimeve të plota

Pasi të jetë përgatitur propozimi i plotë dhe të jetë zgjedhur paraprakisht nga ndonjë donator, grupi punues komunal do të kërkojë nga donatorët dhe partnerët zbatues që ta dorëzojnë propozimin për shqyrtim përfundimtar, para se të jepet miratimi përfundimtar dhe të ofrohet financimi nga donatori. Ky hap do të ndihmojë për t'u siguruar që propozimi përfundimtar të jetë në përputhje me udhëzimet e krijuara për projektet e kthimit, dhe do të jetë element i rëndësishëm për ta siguruar përfshirjen dhe ndihmën e grupit punues komunal me rastin e zbatimit të projektit. Roli i GPK-së në këtë fazë, sidoqoftë, është vetëm ta shqyrtojë propozimin, dhe të ngrisë çështje apo të bëjë sugjerime të cilat donatori dëshiron t'i adresojë me partnerin zbatues, dhe jo ta ofrojë një vlerësim të hollësishëm të projektit. Nëse propozimi shkakton bren-ga të konsiderueshme, ato duhet t'i drejtohen grupit për koordinimin e kthimit dhe ZKB-së për t'i diskutuar me donatorin.

Propozimi financohet

Pas shqyrtimit përfundimtar të propozimit të plotë nga grupi punues komunal, donatori bën zgjedhjen e partnerit zbatues dhe siguron financim për projektin e kthimit.

Zbatimi i projekteve të kthimit

Partneri zbatues mban përgjegjësi primare për zbatimin e projektit të kthimit. Grupi punues komunal do të ofrojë përkrahje në procesin e zbatimit të projektit, nëpërmjet koordinimit të palëve të projektit të angazhuara në procesin e zbatimit të kthimit. Grupi punues komunal do të ofrojë përkrahje për procesin e zbatimit të projektit, nëpërmes koordinimit të palëve të përfshira në procesin e kthimit. Donatori është kryesisht përgjegjës për mbikëqyrjen e projektit. Grupi punues komunal do ta bëjë vëzhgimin e zbatimit të projektit, dhe mund të ftohet për ta ndihmuar partnerin zbatues në tejkalimin e pengesave gjatë zbatimit të projektit. Partnerët zbatues janë përgjegjës për ta informuar grupin punues komunal mbi punën e tyre duke marrë pjesë në takimet e grupeve punuese komunale, së paku një herë në muaj, dhe duke i ofruar donatorit kopje të raportit të përgatitur.

Zbatimi i projekteve shumësektorale të kthimit

Pasi donatori të jetë pajtuar që ta financojë projektin e kthimit (apo në rastet në të cilat projekti vetë-financohet) dhe projekti të jetë shqyrtuar dhe miratuar përfundimisht nga GPK-ja dhe GPR-ja, GPK-ja ndërmer rrolin vëzhgues dhe koordinues gjatë zbatimit. GPK-ja mbron politikën e UNMIK-ut për kthim. Në kuadër të strukturës së GPK-së, përgjegjësia primare për vëzhgimin e zbatimit të projektit mbështetet në kryesuesin e GPK-së. Vëzhgimi ndihmohet nëpërmjet pjesëmarrjes dhe raportimit të rregullt të partnerëve zbatues në takimet e GPK-së. Nëse më tepër se një OJQ është e përfshirë në proces, duhet të arrihet marrëveshja dhe të nënshkruhet memorandumi i mirëkuptimit nga të gjitha palët, duke përkrahur kështu rolet dhe përgjegjësitë.

Si vëzhgues i zbatimit të projektit, posaçërisht kur janë të përfshirë disa partnerë zbatues në një projekt të vetëm të kthimit, GPK-ja duhet të ndihmojë dhe të ofrojë përkrahje për realizimin e projektit. Për të siguruar koordinim efikas, GPK-ja mund ta vendosë një komitet më të vogël (grup punues lokal) i cili përbëhet nga aktorët e përfshirë në projekt.

Nga anëtarët e GPK-së gjithashtu pritet që ta ndërmarrin një rol përkrahës brenda fushave të tyre përkatëse. Për shembull, kur të paraqitet nevoja, kryesuesit e GPK-ve (administratorët komunalë) do të punojnë për t'u siguruar që administrata lokale i

ofron shërbimet komunale në përkrahje të vendeve të kthimit dhe zbatimit të projekteve.

Nëse GPK-ja has në probleme të konsiderueshme me rastin e vëzhgimit të punës së ndonjë partneri zbatues dhe nëse ato nuk mund të zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me partnerin zbatues, GPK-ja duhet t'ia paraqesë problemin kryesuesit të GPR-së. Sipas mendimit të kryesuesit të GPK-së, problemi mund më tutje t'i paraqitet ZKB-së nëse besohet se donatori duhet të informohet dhe të kërkohet ndërhyrja e tij.



Kthimi i të zhvendosurve

Partnerët zbatues mbajnë përgjegjësi për zgjedhjen e të kthyerve të mundshëm dhe për t'u siguruar që kthimi të jetë i qëndrueshëm në aspektin afatgjatë. Formulimi "nga poshtë-lart" i projektit dhe procesi për t'i dhënë projektit prioritet luajnë rolin e mbrojtësit kundrejt zbatimit të projektit pa pasur zotime të fuqishme nga përfituesit apo përndryshe nga personat e zhvendosur për t'u kthyer. PZHBV-të / refugjatët të cilët parashikohen si përfitues të projektit të miratuar duhet të jenë në vendndodhje në mënyrë që zbatimi të fillojë. Së paku një anëtar nga secila familje përfituese duhet të marrë pjesë në rindërtim, apo së paku të jetë i pranishëm në atë vend, në mënyrë që familja të përfitojë nga projekti.

Në rastet në të cilat kushtet që e rrethojnë zbatimin e projektit ndryshojnë dramatikisht, kthimi mund të shtyhet për më vonë, apo të suspendohet përkohësisht. ZKB-ja, nëpërmjet rekomandimeve nga kryesuesit e GPR-së, mund ta ndalë zbatimin e projekteve të kthimit. Nëse paraqiten rrethana të tilla të jashtëzakonshme, ZKB-ja do të sigurohet që baza e saj për suspendimin e projektit të jetë e artikular qartë dhe të konsultohet me të gjithë aktorët e përfshirë lidhur me kushtet e nevojshme në mënyrë që projekti të vazhdohet.

Përgjegjësia për ta siguruar kthimin e personave të zhvendosur ndahet. UNHCR-ja mban përgjegjësi për të ndihmuar me logjistikën e transportimit të personave të zhvendosur dhe refugjatëve. KFOR-i, Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja duhet të ofrojnë përcjellje, nëse kjo është e nevojshme.

UNMIK-u do t'i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për t'u siguruar që zyrtarët komunalë (ndërkombëtarë dhe vendorë, ku të jetë e nevojshme) të jenë të pranishëm për t'i pranuar të kthyerit në ditën e tyre të kthimit. Duhet të përgatitet një takim i shkurtër informativ si pjesë e ceremonisë mikpritëse për t'iu përgjigjur pyetjeve të

mundshme të të kthyerve, dhe të jetë ky një hap i parë për t'u ndihmuar atyre që të integrohen në ambientin e ri. Duhet të ofrohen informata bazë lidhur me komunën dhe strukturat komunale, si dhe me partitë e saj qeverisëse. Ku të jetë e mundur, bashkësitë pranuese dhe bashkësitë më të afërta duhet të përfshihen në këtë pranim.

UNHCR-ja do të ofrojë ndihmë themelore humanitare, siç është ushqimi dhe artikulat e tjerë të thjeshtë joushqimor, përfshirë këtu bataniet dhe çarçafët për ta përkrahur kthimin në tre muajt e parë të kthimit të tyre. Pastaj, partnerët zbatues duhet të sigurohen që kushtet për vetëmbajtje ekzistojnë në projektimin e projektit apo që vetë OJQ-ja ta ndërmarrë sigurimin e nevojave të ndihmës humanitare ushqimore dhe joushqimore pas periudhës së parë tremujore. Nevoja për një ndihmë të tillë duhet të jetë element i kornizës së projektit të përfshirë në kërkesën për projekte.

Kthimi individual

Termi kthim individual (gjithashtu i quajtur edhe kthim "spontan") këtu përdoret për t'iu referuar llojeve të ndryshme të kthimit, përveç lëvizjes së ndihmuar të ndonjë grupi të personave të zhvendosur në ndonjë vend të posaçëm. Në disa raste familjet nuk japin njoftim paraprak mbi kthimin e tyre në shtëpinë e prejardhjes. Në raste të tjera, familjet individuale pranojnë lloje të ndryshme të ndihmës me rastin e kthimit. Kthimet individuale të të gjitha llojeve duhet të përkrahen pasi ato paraqesin një nivel të lartë të besimit, pavarësisë dhe zotimit nga personi i kthyer. Këto duhet të inkurajohen pasi pasqyrojnë një mundësi më të madhe që të kthyerit përsëri të integrohen në mënyrë të suksesshme në bashkësinë pranuese. Sikur familjet që kthehen nëpërmes projekteve të organizuara të kthimit, edhe familjet që kthehen individualisht në përgjithësi kërkojnë ndihmë me rastin e kthimit. Megjithatë, ofrimi i ndihmës është shpesh sfidues për shkak të natyrës së paparashikueshme të ardhjes së tyre dhe përhapjes gjeografike të vendeve në të cilat ata kthehen. Për shembull, projektet e infrastrukturës në përgjithësi mund të ndërmerren në baza të bashkësisë, e jo si reagim ndaj kthimit të një familjeje të vetme.

Në mënyrë që t'u përgjigjemi kërkesave për ndihmë të këtij lloji të kthimit, UNMIK-u është duke punuar me UNDP-në (Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim) dhe UNHCR-në për ta vendosur një shërbim fleksibil, i cili do të ofronte financimin për ta ndihmuar kthimin individual. Nevojat dhe struktura specifike e këtij fondi ende duhet të caktohen, dhe niveli i përkrahjes së donatorëve, si dhe kërkesat të cilat donatorët mund t'i vendosin mbi këtë mekanizëm duhet të merren parasysh. Varësisht nga zgjidhja e këtyre çështjeve, qëllimi i UNMIK-ut është që fondi fleksibil të jetë në dispozicion për shfrytëzim të GPK-ve si përgjigje ndaj kthimeve individuale.

Procesi specifik për një përkrahje të tillë duhet të zhvillohet derisa të përcaktohet struktura e fondit fleksibil. Megjithatë, një qasje e mundshme do të ishte

që pjesëmarrësit e GPK-së ta njoftojnë GPK-në mbi kthimin individual të familjeve pakicë. GPK-ja, më pas, mund të kërkojë një OJQ të parapërcaktuar për t'i vlerësuar familjet e të kthyerve, duke marrë parasysh kriteret e përfituesve të ndihmës së kthimit. Nëse familja e kthyer ka të drejtë për të pranuar ndihmë, GPK-ja do të kërkojë më pas nga partneri zbatues, i cili menaxhon fondin fleksibil, që të ofrojë ndihmë në përputhje me procedurat e fondeve. Përkrahja për kthimet individuale mund ta përfshijë rindërtimin e shtëpive, krijimin e të ardhurave / ndihmën përkrahëse ekonomike dhe, nëse kthimi ndodh në një kontekst ku opcionet e tilla janë në dispozicion, përfshirjen e familjes në një projekt të vazhdueshëm të kthimit që përfshin programet për infrastrukturë dhe bashkësi.¹¹

Raportimi mbi aktivitetet e kthimit

Gjatë procesit të zbatimit, GPK-të i raportojnë GPR-ve mbi aktivitetet e kthimit dhe përparimin e projekteve të kthimit. Kur ndonjë projekt i kthimit përfundon, është me rëndësi që GPK-ja ta hartojnë një raport të hollësishëm mbi projektin, përfshirë këtu seksionin "mësimet e mësuara". GPR-të, në bazë të llojeve të ndryshme të Raporteve të përfunduara të projekteve të kthimit, gjithashtu do ta përgatisin një Raport rajonal krahasues mbi projektet e kthimit në fund të çdo sezoni të kthimit. Këto dokumente duhet të përbëhen jo vetëm nga mësimet e mësuara, por gjithashtu edhe nga pritjet për vitin e ardhëm (nevojat e parashikuara financiare.) Duke u bazuar në këto informata, ZKB-ja do të përgatisë raporte mbi aktivitetet e kthimit, projektet e përfunduara të kthimit, dhe do t'i theksojë nevojat e mbetura.

¹¹ Programe të tjera të cilat përkrahin kthimin individual siç janë programet e UNHCR-së QIP-së, BPRM-së, KCRS-së, IMRA-së, si dhe të tjerat. Mekanizmi i paraqitur duhet ta përmblushë boshllëkun e tanishëm.

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

E DREJTA PËR KTHIM TË QËNDRUESHËM - 17 maj 2002

Koncept dokument

I. HYRJE

Me këtë fletëkoncept synohet të vendosen parimet themelore me të cilat duhet të drejtohet qasja e UNMIK-ut ndaj procesit të kthimit të PZhBV-ve (personave të zhvendosur brenda vendit) dhe të refugjatëve. Me këtë dokument nuk synohet të sigurohet plani operativ i hollësishëm për kthimin e organizuar e as që bëhet përpjekje për të përshkruar përgjigjet operacionale për kthimin spontan. Parimet që i përmban dokumenti kanë të bëjnë njësoj me të gjithë të kthyerit qoftë spontanisht ose të ndihmuar.

Meqë procesi i kthimit dallon nga një rajon në tjetrin, çdo administratë rajonale, do të zhvillojë një plan të implementimit rajonal duke u mbështetur në qasjen që theksohet në këtë dokument. Meqenëse kthimi nuk është proces linear, këto plane rajonale do të jenë gjithmonë dokumente pune. Mirëpo, parimet thelbësore që drejtojnë procesin e kthimit në Kosovë do të mbeten të njëjta.

Meqë qasja e UNMIK-ut ndaj kthimit fokusohet në individin në këtë proces, ky dokument rekomandon qasje me bazë në të drejtën. Së këndejmi, parimet kahzuese të propozuara bazohen mbi të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe të standardeve humanitare dhe janë zhvilluar në konsultim me UNHCR-në.

II. OBJEKTIVAT

Kthimi dhe integrimi janë prioritetet kryesore afat-mesme të UNMIK-ut. Rrethanat e sigurisë për pakicat janë në përmirësim e sipër dhe liria e lëvizjes është në përmirësim gjithashtu. KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut po shkojnë kah qasja që mbështetet mbi vlerësimin fleksibil të kërcënimit për të arritur zhbërjen graduale të enklavave të mbrojtura dhe për të promovuar integrimin dhe pajtimin në nivel lokal. Me fillimin e këtyre zhvillimeve të rëndësishme dhe premtuese dhe me themelimin e suksesshëm të qeverisë multietnike, shtohen gjasat për kthim. Si rezultat i kësaj, kthimi është thelbi i agjendës politike të Kosovës.

Nevojitet një qasje e unifikuar në tërë misionin për të arritur shpërthime në kthimin e pakicave gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 2002, për të ndikuar në ndryshimin e klimës dhe që do të rezultojë në përmirësimin e klimës dhe për të ndërtuar mundësinë për numër më të dukshëm të të kthyerve gjatë viteve 2003 e 2004.

Megjithatë, duhet theksuar se nuk ka kufizim kohor në të drejtën për kthim. Kthimi nuk është proces që nxitet politikisht, por në radhë të parë ai varet nga përcaktimi i individit për t'u kthyer. Ky parim i përcaktimit individual mbrohet si nga e drejta për t'u kthyer ashtu edhe nga parimet e të drejtave të njeriut në përgjithësi.

UNMIK-u, në partneritet me UNCHR-në dhe aktorët e tjetër kyç, duhet të veprojë duke ndihmuar procesin e kthimit dhe duke krijuar kushtet e favorshme për qëndrueshmërinë e këtij procesi. Kjo paraqet qasje bilaterale ku UNMIK-u dhe partnerët e tij do të:

- kontaktojnë me PZhBV-të dhe refugjatët duke u ofruar informata reale dhe të qëlluara mbi kushtet në Kosovë, dhe ndërkohë të ndërmarrin masa për përmirësimin e këtyre kushteve për të mundësuar kthimin e PZhBV-ve.
- punojë për të siguruar që kushtet në terren për të kthyerit të jenë të qëndrueshme, duke promovuar edhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare.

Një qasje e tillë do të udhëhiqet nga respekti për parimet e të drejtave themelore të njeriut, gjë që më së miri mund të karakterizohet si e drejtë për kthim të qëndrueshëm. Ky koncept pastaj favorizon një sërë parimesh drejtuese për aktorët e ndryshëm të kyçur në zbatimin e procesit të kthimit dhe në procesin e integritit.

UNMIK-u do të vazhdojë ta mirëpresë kyçjen në përgjithësi të Beogradit në procesin e kthimit, duke qenë autoritet nikoqir i rajonit për shumicën e PZhBV-ve në Kosovë. Por, duhet theksuar se çdo kyçje do të udhëhiqet nga parimet e paraqitura këtu për t'u shmangur politizimit të procesit të kthimit dhe për të siguruar që të drejtat e të zhvendosurve janë primare.

Kthimet në numër të madh mund të bëhen vetëm nëse vendosen mekanizmet efektiv për integrimin e pakicave në shtrukturat e shoqërisë kosovare. Advokimi aktiv dhe përkrahja për kthimet dhe integrimin e pakicave nga të gjithë liderët politikë dhe të komunitetit, sidomos nga zyrtarët vendorë të zgjedhur, janë faktor i rëndësishëm për zhvillimin e shoqërisë kosovare.

III. PARIMET

Parimet kryesore për kthim parashtrohen në Deklaratën e Parimeve, për të cilën është arritur marrëveshja përbrenda UNMIK-ut, si dhe me UNHCR-në dhe KFOR-in dhe ka kaluar nga KPA-ja (Këshilli i Përkohshëm Administrativ) në vitin 2001 (Shtojca A). Konceptet kyçe në këtë deklaratë janë nocioni i përcaktimit vullnetar dhe të qëndrueshëm individual. Këto koncepte manifestohen në të drejtën për kthim të qëndrueshëm. Duke promovuar këtë qasje të bazuar mbi parimet e të drejtës në procesin e kthimit, UNMIK-u duhet të udhëhiqet nga parimet vijuese thelbësore të veprimit:

E drejta për t'u kthyer

- E drejta për t'u kthyer vlen njësoj për anëtarët e të gjitha komuniteteve, pa dallim përkatëse etnike, kulturore, fetare ose gjuhësore.
- Të gjitha kthimet duhet qenë vullnetare, të mbështetura mbi përcaktimin e lirë dhe të shprehur nga individ.
- Është prioritet të mbështetet kthimi në vendet e origjinës.
- Në përgjithësi, koncepti i ndërrimit të lokacionit, duke përfshirë edhe propozimet për grupime vendbanimesh të reja, nuk çojnë kah qëllimet afat-gjata të afirmimit të shoqërisë multietnike në Kosovë, dhe nuk do të mbështeten nga UNMIK-u.
- Kthimet strategjike ose kthimet e motivuara nga shteti nuk janë në interes të të kthyerve, meqë këto mund të rezultojnë në rritjen e izolimit të tyre dhe në zvogëlim të lirisë në qarkullim të lirë. Prandaj, zgjedhja e lokacioneve për të kthyerit duhet të mbështetet në shprehjen e dëshirës së PZHBV-ve për t'u kthyer në vendet e tyre të mëparshme e jo në kalkulimet politike.
- Nuk mund të ketë kushtëzime politike ose të tjera për kthimin nga komunitetet pranuese. Kthimi nuk

mund të lidhet ose të i lihet peng zgjidhjeve të çështjeve politike, sociale ose humanitare. Gjithashtu, kthimi i një komuniteti nuk mund të kushtëzohet me kthimin reciprok të komunitetit tjetër.

- Përderisa mund të jetë e kuptueshme që vendet mikpritëse perëndimore vazhdojnë me riatdhësimin gradual të anëtarëve të popullatës shumicë të Kosovës, nga ato do të kërkohej të ndalojnë kthimin e detyrueshëm të pakicave. Vendet nikoqire do të inkuajohen të zhvillojnë pako të riintegrit gjë që do të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e kthimeve vullnetare.

Qëndrueshmëria

- Realisht, PZHBV-të dhe refugjatët do të dëshirojnë të kthehen vetëm nëse mund të jetojnë në paqe dhe të marrin pjesë plotësisht në shoqëri. Prandaj, çdo proces i kthimit duhet të jetë i qëndrueshëm për të pasur sukses.
- Qëndrueshmëria parasupozon të drejtën individuale për qasje në shërbimet publike dhe shoqërore. Në kontekstin e Kosovës, këto të drejta kërkojnë që komunitetet e pakicave dhe të kthyerit të kenë qasje të barabartë në arsim (në gjuhën e tyre kurdo që ka mundësi), në përkujdesjen shëndetësore dhe shërbimet mjekësore, në mbrojtje sociale ose asistencë sociale për të varfërit, si dhe në shërbimet komunale publike.
- Krijimi i qëndrueshmërisë do të kërkojë involvimin aktiv të Qeverisë dhe të ministrive të saj, e në veçanti të atyre institucioneve që sigurojnë qasje në shërbimet e rëndësishme. Qeveria e ka njohur domosdoshmërinë për përkrahjen e procesit të kthimit dhe ka treguar se ajo synon të marrë përsipër këtë obligim në politikën e saj që do të publikohet së shpejti. Në përputhje me këtë, Qeveria duhet të ndajë fonde të mjaftueshme përbrenda mjeteve buxhetore në dispozicion për të garantuar ofrimin e këtyre shërbimeve komuniteteve dhe për të kthyerit.
- Ashtu siç është qenësore, në afat të shkurtër, t'u garantohet pakicave të kthyer qasja në skemat e asistencës sociale, është poaq e rëndësishme shansa e barabartë në mundësinë për punësim si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, në mënyrë që të arrihet qëndrueshmëria e tyre afatgjate dhe zhvillimi. UNMIK-u dhe autoritetet qeveritare kanë përgjegjësi të sigurojnë përfaqësim të arsyeshëm të të gjitha pakicave në sektorin publik dhe të sigurojnë pengimin e diskriminimit si në vendin e punës ashtu edhe gjatë procesit të punësimit.
- Një aspekt tjetër kyç i së drejtës për zhvillim të qëndrueshëm është e drejta individuale mbi pronën private. Kjo e drejtë manifestohet jo vetëm në të drejtën themelore për tu strehuar, por edhe në nevojën që qeveria të sigurojë masa efektive për ndalimin e privimit të paligjshëm të pronës. Meqë shumë të zhvendosur i kanë shtëpitë e tyre të zëna në mënyrë kundërligjore nga pjesëtarë të komunitetit shumicë, UNMIK-u do të sigurojë funksionimin efektiv të mekanizmave të DÇBP-së (Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore) për paraqitjen e kërkesave, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pronësore dhe sigurimin e kthimit ekspeditiv të pronës pronarit ligjor.
- Një aspekt i rëndësishëm i të drejtave pronësore sipas standardeve humanitare ndërkombëtare është sigurimi i ndihmës adekuate për rindërtim, gjë që do t'iu mundësonte të kthyerve potencialë nevojtarë të fillonin ndërtimin e shtëpive të tyre të shkatërruara ose të dëmtuara. Ndihma e këtij lloji u nevojitet atyre, shtëpitë e të cilëve janë dëmtuar ose shkatërruar.
- Fundamentale për t'i gëzuar plotësisht këto të drejta dhe shkallën deri në të cilën komunitetet e pakicave mund të integrohen dhe të marrin pjesë në shoqëri është qarkullimi i tyre i lirë. UNMIK-u dhe KFOR-i do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar lirinë e qarkullimit për të gjithë të kthyerit dhe komunitetet në Kosovë.

- Për të siguruar qëndrueshmërinë e qarkullimit të lirë, është qenësore që komuniteti shumicë të heqë dorë nga dhuna dhe taktika e cenimit, gjë që shpesh e kufizon mundësinë e pakicave për të qarkulluar lirisht. Qeveria dhe liderët e të gjitha niveleve politike dhe të komuniteteve duhet të punojnë me komunitetin e shumicës për vendosjen e të kthyerve, në mënyrë që të krijohet një ambient shoqëror dhe politik për të kthyerit.

IV. PROCESI

Meqë qasja e integruar dhe e unifikuar ndaj procesit të kthimit ka gjasa të sigurojë më shumë besim midis të kthyerve potencialë, kërkohet involvimi dhe bashkëpunimi aktiv jo vetëm i UNCHR-së, i shtyllave të UNMIK-ut, i administratave rajonale dhe komunale, i Policisë së UNMIK-ut dhe i SHPK-së, i KFOR-it, i agjencive ndërkombëtare dhe i OJQ-ve, por edhe i përfaqësuesve të komuniteteve të shumicës dhe të pakicës. Përveç kësaj, Qeveria multietnike dhe krijimi i dy posteve kyçe të Koalicionit "Povatak", një koordinator ndërministror për kthimin pranë Kabinetit të Kryeministrit dhe një këshilltar i lartë për kthimin pranë Kabinetit të PSSP-së, do të bëjnë të mundur strategjinë e integruar dhe gjithpërfshirëse.

IPVQ-ja (Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes) në të gjitha nivelet duhet të angazhojë aktivisht komunitetin shumicë, ku bëhet kthimi për ta ndihmuar integrimin dhe pajtimin. Këto përpjekje duhet të mbështeten në mënyrë aktive nga UNMIK-u. Gjersa pajtimi i plotë nuk mund të bëhet për shkak të mungesës së përgjegjësisë së plotë për krimet e kaluara, hapat e parë mund të ndërmerren për ta ndihmuar dialogun serioz në nivelin lokal. Iniciativat e tilla duhet t'i paraprijnë kthimit dhe pastaj t'i bashkohen atij procesi në rrugë e sipër.

Meqë kthimi i vazhdueshëm është proces nga poshtë lart, duke filluar nga dëshirat e shprehura të PZhBV-ve, UNMIK-u, në bashkëpunim me UNCHR-në, duhet të krijojë një pasqyrë të qartë të qëllimeve të të kthyerve potencialë përmes angazhimit të shtuar dhe kontakteve të drejtpërdrejta me Shoqatën e PZhBV-ve dhe me vetë PZhBV-të. Mbështetur në këto konstatime, planifikimi fillestar i kthimit të organizuar do të fillojë në nivel lokal në grupet punuese komunale dhe rajonale mbi kthimin. Këto trupa të koordinimit dhe të planifikimit i raportojnë Grupit Punues të Kthimit (GPK), të cilin e drejton PSSP-ja në nivel qendror. GPK-u ka autoritet të miratojë projekte mbi kthimin e rekomanduar dhe të caktojë resurse për mbështetjen e tyre.

Si parim, duhet t'i jepet prioritet financimit nga donatorët për të ndihmuar kthimin e pakicave dhe projektet e integritetit dhe për të vijuar me të kthyerit. Për këta të fundit do të kërkohet fleksibilitet gjatë planifikimit dhe caktimit të mjeteve.

V. KONKLUZË

Roli i UNMIK-ut ose i çdo autoriteti qeveritar nuk është për të caktuar lokacionin e kthimit as t'u diktojë PZhBV-ve dhe refugjatëve si dhe kur mund të kthehen, por për ta ndihmuar përmirësimin e kushteve në mënyrë që PZhBV-të dhe refugjatët të kenë mundësinë të ushtrojnë vendimin individual për t'u kthyer.

Pa marrë parasysh se a vendosin PZhBV-të dhe refugjatët për t'u kthyer në Kosovë ose për t'u integruar në vendin ku janë të zhvendosur, vetë procesi duhet të sigurojë që të respektohen të drejtat e individuale dhe që ata të kenë mundësinë të vendosjes për tu kthyer në shtëpitë e tyre me dinjitet. Kjo qasje e bazuar mbi të drejtat ofron formulën e cila siguron që procesi i kthimit në Kosovë t'i plotësojë ato standarde. Në fund, parimet e paraqitura këtu ndihmojnë për të siguruar që ata individë që kthehen të mund të mbeten këtu të sigurtë dhe në mënyrë të qëndrueshme.

Zyra e kthimit dhe e komuniteteve
Zyra e PSSP-së
17 maj 2002

DEKLARATA E PARIMEVE

1. **E drejta për t'u kthyer** qoftë në formë spontane ose të organizuar (e ndihmuar) është e drejtë themelore e njeriut, e cila duhet të respektohet.
2. Kthimi duhet të jetë **vullnetar** dhe duhet të mbështetet në vendimin e lirë dhe të informuar të individit. Vendimi për t'u kthyer mund të jetë vendim individual dhe familjar, prandaj të gjithë PZhBV-të, duke përfshirë edhe gratë, duhet t'u sigurohen informacione të sakta mbi gjendjen në vendit të tyre të mëparshëm, në mënyrë që të mund të bëjnë zgjedhje të informuar. Kujdes i veçantë duhet kështu bërë brenda të PZhBV-ve femra për t'u siguruar që ato kanë qasje në informacionin mbi kriteret që i konsiderojnë të rëndësishme.
3. Me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244, UNMIK-u është përgjegjës për të siguruar kthim të sigurt dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur **në shtëpitë e tyre** në Kosovë dhe nga KFOR-i kërkohet të krijojë një mjedis të sigurt, në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur të mund të kthehen **në shtëpitë e tyre**, të sigurtë dhe dinjitoz. Prandaj, kthimi i tyre **në vendet e tyre të mëparshme** duke krijuar kështu një zgjidhje të qëndrueshme të zhvendosjes së tanishme. Resurset duhet përqendrohen në kushtet e lokacionit të mëparshëm.
4. Kthimi i PZhBV-ve duhet të organizohet në kushte të **sigurisë dhe të dinjitetit**, duke kërkuar forcimin e përpjekjeve për të pasur siguri fizike të komuniteteve serbe në lokacionet e kthimit në Kosovë. Përveç masave të sigurisë, kjo kërkon edhe dialog me komunitetin shumicë si dhe qasje ndaj gjendjes sa i përket ndihmës.
5. **Qëndrueshmëria** e kthimit të PZhBV-ve duhet të sigurohet me masa që synojnë krijimin e kushteve minimale në trevat e vendosjes, qasje në shërbimet publike përfshirë edhe shëndetësinë dhe arsimin dhe në shërbimet e tjera publike si dhe rritjen e mundësive shoqërore dhe ekonomike për t'u ndihmuar të kthyerit të rindërtojnë një jetë stabile të komunitetit. Për ta ndihmuar bashkëjetesën dhe për t'i evituar pakënaqësitë e padëshirueshme ndaj komuniteteve të të kthyerit, çështja e qëndrueshmërisë kërkon një qasje ndaj gjendjes e cila i kushton vëmendje të duhur nevojave për ndihmë shumicës fqinje dhe komuniteteve të tjera të pakicave.
6. Të kthyerit dhe komuniteti vendor kanë nevojë t'u sigurohet **liria e lëvizjes** adekuate, së paku të kenë qasje në tokat e tyre dhe në shërbimet themelore (shëndetësi, arsim dhe punësim) dhe mbajtja e lidhjeve shoqërore dhe familjare edhe jashtë fshatit ose enklavës. Duhet të bëhen përpjekje dhe të merren masa, përfshirë edhe dialogun me komunitetin e shumicës, që me kalimin e kohës të tejkalojë qështjen e enklavave dhe të krijoj kushte për bashkëjetesë.
7. Planifikimi i përbashkët për kthimin duhet të organizohet për **trevat gjeografike multi-etnike** në gjithë Kosovën, duke mos u kufizuar vetëm në një lokacion ose trevë. Shpjeguesia e kthimit në secilin trevë do të varet tërësisht nga rrethanat dhe kushtet në secilin lokacion të veçantë i cili mirret për shqyrtim nga ana e grupeve punues si rajonale ashtu dhe lokale gjatë aktiviteteve dhe duhen caktuar kornizat ekzakte kohore për lëvizjet e pë masat dhe lëvizjet e organizuara.
8. Veprimet e kthimit duhet të drejtohen në formë të **profilit të ulët, inkrementale dhe në mënyrën e regulltë**. Kthimet e organizuara duhet të ndihmohen në mënyrë të kujdesshme, duke marrë parasysh gjendjen specifike të sigurisë në vendin specifik të mëparshëm të personave. Kjo nënkupton që kthimi duhet të bëhet në faza që janë në përputhje me qasjen hap pas hapi. Ky proces duhet të mundësojë fleksibilitet, kohë të mjaftueshme për planifikimin e kthimit pa krijuar vonesa të panevojshme dhe nevojitet të shmangët krijimi i tensioneve gjë që do të ndikonte negativisht në kthimin e vërtetë. Koha e masave dhe e lëvizjeve të kthimit të organizuar janë shumë të rëndësishme dhe përfundimisht do të përcaktohen nga grupet punuese rajonale dhe lokale të kthimit duke i

pasur parasysh të gjithë faktorët relevantë. Kthimi i familjeve ose grupeve specifike do të varet plotësisht nga krijimi i mbizotërimit të kushteve të pranueshme në lokacionin e veçantë të kthimit.

9. Procesi i kthimit duhet të jetë **gjithpërfshirës dhe transparent**, duke kërkuar konsultime të shpesh-ta me përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve të interesuara, përfshirë edhe popullatat fqinje dhe parapëlqehet të shkojnë së bashku me dialogun ndërmjet komuniteteve dhe duke mbështetur masat e ndërtimit të besimit reciprok midis të të gjitha komuniteteve të pakicave dhe shqiptarëve të Kosovës. Kjo përfshin edhe vëmendjen e duhur që i kushtohet gjendjes dhe shqetësimeve të të gjitha komuniteteve përfshirë edhe fqinjët e parë
10. Kthimi duhet të udhëhiqet në mënyrë njerëzore, duke kërkuar sigurimin e **ndihmës themelore humanitare** për të siguruar qëndrueshmërinë e komuniteteve të të kthyerve gjatë periudhës së riintegritimit fillestar, me vëmendje të veçantë ndaj individëve dhe familjeve e ndjeshme. Do të miratohet një **qasje e gjendjes** për ta marrë parasysh planifikimin e ndihmës së tillë dhe të nevojave humanitare për të siguruar që ndihma humanitare të shërbejë për nevojat e komuniteteve fqinjsore, për të siguruar që ndihma humanitare të shërbejë më shumë për bashkëjetesë sesa për të sforcuar ndarjet ose për të krijuar pakënaqësi të reja midis komuniteteve fqinje të pakicave dhe të shumicës.
11. Organizimi i kthimit të sigurt, të rregullt dhe të qëndrueshëm kërkon **vlerësim të plotë të lokaliteteve të kthimit potencial**; organizim ky që duhet bërë nga Zyra e PSSP-së, UNHCR, KFOR-it, OSBE-ja, Policia UNMIK-u, administratat rajonale dhe komunale të UNMIK-ut, përfaqësuesit komunalë dhe përfaqësuesit e popullatës së PZhBV-ve.
12. Masat që kanë për synimin krijimin e kushteve të cilat janë të domosdoshme për kthim dhe për sigurimin e mbështetjes dhe ndihmës së kërkuar për të kthyerit pasi të kthehen aplikohen pa marrë parasysh nëse ata kthehen me vetiniciativë apo në mënyrë të organizuar.



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TE VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS
ASSOCIATION OF KOSOVO MUNICIPALITIES
ASOCIACIJA KOSOVSКИH OPŠTINA

Programi i Qeverisë, sektori i komuniteteve

8. INTEGRIMI I TË GJITHA KOMUNITETEVE ETNIKE NË SHOQËRINË KOSOVARE

Kosovarët duhet të kenë qasje të njëjtë dhe duhet të jenë pjesmarrës të plotë në të gjitha nivelet e qeverisjes në Kosovë. Qeveria e Kosovës duhet të jetë qeveri e të gjithë kosovarëve dhe duhet të shërbejë si model për rithurjen e një strukture multietnike në Kosovë. Për ta bërë këtë, Qeveria duhet të kujdeset që qëllimet e Ministrive dhe mandatet e dhëna nga Korniza Kushtetuese të plotësohen për të gjitha komunitetet. Qeveria duhet të kujdeset që komunitetet të jenë pjesmarrësit aktiv në të gjitha nivelet e qeverisë dhe në të gjitha sektoret.

Qeveria duhet të japë një shembull duke i mbështetur haptazi iniciativat për përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik, duke filluar me mbështetjen publike të aktiviteteve të Organizatave joqeveritare dhe të mbështesë punët që me qëllim i merr nga të gjitha komunitetet. Qeveria duhet të arrijë të kosovarët e zhvendosur dhe të iniciojë një dialog për çështjet e kthimit, dhe duhet haptazi të mbështesë projektet që lehtësojnë kthimin e minoriteteve. Qeveria duhet t'i sigurojë minoritetet se personat e zhvendosur nuk do të kthehen nëpër enklava por në shtëpitë e tyre. Ministria duhet të kujdeset që të dëgjohet zëri i minoriteteve në definimin e prioritetëve të Qeverisë.

Të drejtat e minoriteteve, riintegrimi dhe kthimi i tyre

Të drejtat e minoriteteve

Qeveria do të kujdeset që parimet, ligjet dhe masat zbatuese do të mbrojnë dhe avansojnë të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve siç është garantuar në Kapitullin 3 dhe 4 të Kornizës Kushtetuese. Objektivat e njëjta imperative të Qeverisë duhet të jenë mbështetja për bashkëjetesë të të gjitha komuniteteve, avansim të plotë në ekonomi dhe në pjesëmarrjen në jetën sociale dhe politike.

Ministritë do të kujdesen dhe avansojnë pjesëmarrjen proporcionale të të gjitha komuniteteve në të gjitha nivelet e degëve ekzekutive në Qeveri. Shërbimi civil duhet të udhëheq stafin civil të punësuar në atë mënyrë që ai të reflektojë standardet e vërteta profesionale; punët pozitive, të bazuara në standardet e mirënjohura ndërkombëtare dhe evropiane, do të përkujdeset që procesi të rrisë pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe gruas në të gjitha nivelet bazuar në mandatin e dhënë sipas Kornizës Kushtetuese.

Si një pjesë integrale e këtyre përpjekjeve, Ministritë duhet të punojnë aktivisht në gjetjen dhe zbatimin e zgjidhjeve të shumë problemeve praktike, përfshirë sigurimin dhe transportimin që për momentin pamundësojnë pjesëmarrjen e plotë të pjesëtarëve të minoriteteve në shërbimet publike.

Qeveria, në bashkëpunim me organizatat lokale dhe ndërkombëtare, do të zhvillojë dhe zbatojë programe që ngrisin bashkëpunimin, tolerancën dhe riintegrimin me komunitetet minoritare. Në këtë drejtim, zyra e Kryeministrit do të punojë në sigurimin e sinqertë të funksionimit të këshillave ndërmjetësuese komunale.

Qeveria, e veçanërisht zyra e Kryeministrit do të bashkëpunojë dhe koordinojë me komuna për tu siguruar që të gjitha rregulloret e Qeverisë zbatohen nëpër komuna. Në të vërtetë Qeveria do të konsultohet me kryetarët e komunave për të ndihmuar arritjen e marrëveshjes së tyre për zbatimin e rregulloreve të strukturave komunale. Zyra këshillimore për komunitete dhe koordinatori ndërmintor për kthimet dhe komunitetet do të sigurojë koordinimin e të gjitha përpjekjeve mes departamenteve për arritjen e objektivave të lartpërmendura. Të dy zyrat do të bashkëpunojnë me nivelet ndërkombëtare dhe lokale (përfshirë edhe Paktin e stabilitetit) për të kuptuar më mirë gjendjen e komuniteteve në Kosovë, për të shkëmbyer pikëpamjet dhe përvojën dhe për të mësuar nga përvojat e homologëve rajonal.

Kthimi

Përderisa çështja e kthimit mbetet autoritet i rezervuar për Kryeadministratorin (PSSP-në), Qeveria pranon se rezoluta e saj do të varet nga mbështetja e plotë dhe marrëveshja e strukturave qeveritare. Kjo kërkon që komunitetet ekzistuese dhe komunitetet e kthyer të kenë qasje të plotë dhe të barabartë në shërbimet e ofruara nga ministritë. Përveç kësaj, procesi i kthimit duhet të përfshijë pjesëmarrjen aktive të komuniteteve mazhoritare. Sidoqoftë lejimi i këtyre nuk duhet të jetë një kusht për kthime.

Qeveria gjithashtu pranon se, në përputhje me marrëveshjen e koalicionit të 28 shkurt 2002, përfitimi i besimit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur duhet të jetë një prioritet i lartë dhe faktor kyç në arritjen e konsolidimit social dhe politik në shoqërinë kosovare. Përveç kësaj, pranimi i Kosovës në rajon dhe mbështetja politike dhe financiare e komunitetit ndërkombëtar do të varet kryesisht nga progresi i bërë në këto çështje.

Qeveria mbetet e gatshme që t'i ndihmojë UNMIK-ut, UNHCR-së, KFOR-it dhe të gjitha agjencioneve përkatëse për avansimin dhe mundësimin e kthimit të komuniteteve minoritare. Për të pasur një proces të qetë të rivendosjes, Qeveria shpreson se të gjitha kthimet do të bëhen në baza vullnetare e jo të nënshtrohen çfarëdo manipulimi politik apo ndonjë motivi tjetër. Të kthyerit duhet të vendosen në vendet ku kanë jetuar më herët. Kjo do të avansonte bashkë ekzistencën, tolerancën dhe riintegrimin mes komuniteteve ekzistuese dhe të të kthyerve. Për t'u zbatuar një gjë e tillë, vendet ku duhet të paraqiten të kthyerit duhen të përgatiten në mënyrë që të kthyerve t'iu mundësohet krijimi i një jete të mirë, dhe që të kthyerit të bëhen pjesëmarrës në shoqërinë kosovare. Kthimet duhet të jenë kontinuele për të gjithë ata që kanë pasurinë e tyre me qëllim të preventimit të migrimëve të ardhme apo ndonjë problemi tjetër.

Qeveria së bashku me personat e zhvendosur do të demonstrojnë me aktivitet zotimin e saj ndaj procesit të rivendosjes dhe të riintegrimit të të kthyerve dhe vullnetin e tyre për t'i shqyrtuar brengat dhe dëshirat e të kthyerve. Qeveria do të organizojë aktivitete, përfshirë edhe kampanja informative për avansimin e tolerancës dhe kooperimit, dhe do t'i ftojë të gjithë kosovarët që të respektojnë demokracinë, rendin e ligjin.

Në konsultim me UNMIK-un, Qeveria do të kontaktojë donatorët për projektet bashkësponsoruese me Qeverinë për të përmirësuar kushtet e personave të zhvendosur dhe kthimin e refugjatëve. Zyra e Kryeministrit do të udhëheqë procesin, duke përdorur funksionin koordinues dhe zyrën e Koordinatorit për kthime dhe komunitete.

Prishtinë 02.05.2002



INSTITUCIONET E PËRKOZHSHME TE VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS
ASSOCIATION OF KOSOVO MUNICIPALITIES
ASOCIACIJA KOSOVSКИH OPŠTINA

Deklarata e Asociacionit të Kuvendeve Komunale mbi integrimin dhe kthimin

Në mbledhjen e Asociacionit të Kuvendeve Komunale që u mbajt sot, më 12 prill 2002 u diskutua mirëkuptimi në mes të autoriteteve lokale dhe Qeverisë për strategjinë e principeve të përbashkëta që kanë të bëjnë me çështjen e minoriteteve, siç janë integrimi dhe kthimi.

Ne do t'i përmbahemi këtyre parimeve:

1. E drejta e të gjitha minoriteteve të të gjitha komunave që të sigurohen për perspektivat e tyre në të ardhmen. Këto parime gjithashtu do të vlejnjë edhe për shqiptarët e zhvendosur, e veçanërisht për ata të veriut të Mitrovicës dhe të Shtërpcës, të cilët e meritojnë t'iu ofrohet siguria dhe perspektiva.
2. Që të gjithë personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, duhet t'iu jepet shansi për kthimin në shtëpitë e tyre nëse ata e dëshirojnë një gjë të tillë. Ky shans duhet të jetë një veprim vullnetar i individëve e jo të bëhet një kolonizim i ri.
3. Që të gjithë të kthyerve t'iu jepet shansi që të ndërtojnë jetën e tyre dhe të kontribuojnë në shoqërinë tonë kolektive.
4. Që të gjithë kosovarët, pa marrë parasysh etnitetin e tyre, të kenë të drejtë posedimi të pronësisë së tyre ligjore.

Ne gjithashtu kemi arritur një mirëkuptim lidhur me bashkëpunimin:

1. Çështja e minoriteteve të kthyer të trajtohet si çështje madhore e interesit për Kosovën, gjersa vlerësimi i lëndëve personale të të kthyerve të i dorëzohet organeve kompetente.
2. Koordinimi mes Qeverisë dhe Organeve komunale lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet.
3. Qeveria do të jetë bartëse e aktiviteteve të integritit vullnetar dhe kthimit të minoriteteve në pasuritë e tyre.
4. Komunat do t'i respektojnë vendimet e marra nga Qeveria dhe do të konsultojnë të gjitha palët e interesuara për ato çështje.
5. Krijimi i një kooperimi të ngushtë me zyrat për komunitete të UNMIK-ut si dhe me zyrat këshilluese.

6. Që në organet komunale të zbatohet modeli i mundësive të njëjta për të gjithë
7. Që mos të ketë vendime lidhur me kthime dhe integrimi pa u konsultuar paraprakisht lidhur me këtë me Qeverinë e Kosovës.
8. Fondet publike të ndahen në një mënyrë të njëjtë dhe proporcionale për të gjitha komunitetet në komunat kosovare
9. Në bashkëpunim me Qeverinë kosovare, Zyrën për kthime dhe Zyrën për këshilla të komuniteteve do të organizohet një kampanjë publike lidhur me koordinimin e aktiviteteve për këto çështje
10. Kohë pas kohe, në mbledhjet e Asociacionit të komunave do të ftohen të gjithë aktorët e interesuar për të elaboruar mbi një strategji për trajtimin e çështjeve të komuniteteve

Në emër të Qeverisë

Dr. Bajram Rexhepi
Kryeministër

Në emër të Asociacionit

z. Lutfi Haziri
Kryetar



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TE VETQEVERISJES ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT ASSOCIATION OF KOSOVO MUNICIPALITIES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA ASOCIACIJA KOSOVSkih OPŠTINA

**PROPOZIM PËR REZOLUTËN MBI TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE ANËTARËVE
TË TYRE DHE MBI KUSHTET E KTHIMIT TË ZHBV DHE TË REFUGJATËVE**

Miratuar në Korrik të 2002

Qeveria:

- Nisur nga parimet themelore të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (1999), veçanërisht të pjesës që ka të bëjë me krijimin e kushteve për jetë të sigurtë për të gjithë;
- Nisur nga parimet themelore të Kornizës Kushtetuese (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9) veçanërisht lidhur me të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarët e tyre (Kapitulli 4),
- Bazuar në dispozitat e Konventës së Gjenevës mbi Refugjatët (1951), siç është ripërcaktuar nga KB Parimet Udhëzuese mbi Zhvendosjen Brenda Vendit (Internale).
- Me besimin se multietniciteti dhe pengimi i rivendosjes së shtypjes janë perspektiva të Kosovës së re demokratike;
- Duke u nisur nga e drejta e patjetërsueshme për lirinë e lëvizjes;
- Të bindur se, respektimi rregullave ndërkombëtare mbi të drejtat e patjetërsueshme të refugjatëve dhe personave të zhvendosur paraqet kushtin thelbësor për përparim të shoqërisë së Kosovës;
- Duke marrë parasysh gjendjen aktuale në Kosovë në lëmin e të drejtave të komuniteteve etnike, në veçanti kur flitet për të drejtën e tyre të lëvizjes së lirë dhe të kthimit.
- Me qëllim të uljes së tensioneve ndër-etnike dhe të krijimit të një ambienti të sigurtë për të gjithë;

**Bazuar në seksionin 9.1.26 (a) i propozon rezolutën në vijim Kuvendit të Kosovës për aprovim:
REZOLUTË XX/2002**

**MBI TË DREJTËN E KOMUNITETEVE DHE TË ANËTARËVE TË TYRE MBI KUSHTET E KTHIMIT TË TË
ZHVENDOSURVE DHE TË REFUGJATËVE**

- I. Të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim race, gjinie, feje e përkatësie etnike, kanë të drejtë të gëzimit të pronës së tyre në mënyrë të ligjshme.
- II. Organet kompetente të Kosovës, IPVQ, UNMIK-u, KFOR-i, thirren fuqimisht të implementojnë provizionet ligjore, duke siguruar lëvizje të lirë të të gjithëve pa diskriminim;

- III. Qytetarët e Kosovës, pa dallim race, gjinie, feje, përkatësie etnike, kanë të drejtën e lëvizjes së papen-guar në të gjithë territorin e Kosovës;
- IV. Organet kompetente të Kosovës, IPVQ, UNMIK-u, KFOR-i, thirren fuqimisht të zbatojnë dispozitat në fuqi në territorin e Kosovës, të cilat sigurojnë barazinë në shfrytëzimin e të drejtës për lëvizje të lirë në gjithë territorin e Kosovës.
- V. Shumica e qytetarëve të Kosovës, që jetojnë në liri, duhet të japin kontribut aktiv drejt krijimit të kushteve të njëjta për ata që nuk kanë mundësi të shfrytzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të lirë dhe të plotë, duke përfshirë edhe të drejtën për t'u kthyer në shtëpitë e tyre.
- VI. Qeveria e Kosovës fton Kuvendin e Kosovës që të bashkëpunojë ngusht me të gjitha strukturat e pushtetit në Kosovë me qëllim të krijimit të parakushteve për realizimin e synimeve të kësaj Rezolute,
- VII. Qeveria fton Kuvendin e Kosovës që të mandatojë Komitetin e Kuvendit mbi të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, të punojnë për krijimin e parakushteve për kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur me qëllim që të implementohet kapitulli i V-të i kësaj rezolute dhe provizionet relevante të Rezolutës 1244 të Kornizës Kushtetuese dhe të përkushtimit të popullit të Kosovës për një shoqëri multietnike në Kosovën e lirë dhe demokratike.

Standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e pakicave dhe PZHBV-e

Sipas standardeve ndërkombëtare, refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit kanë të drejtë fundamentale që të kthehen në shtëpitë e tyre, në mënyrë spontane apo të organizuar dhe të ndihmuar, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Këto standarde formojnë bazën e UNMIK-ut për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe strategjinë për kthimet në Kosovë.

UNMIK-u është duke shqyrtuar disa dokumente kryesore për t'i përcaktuar standardet e zbatueshme për pakicat, të kthyerit dhe personat e zhvendosur. Instrumentet e OKB-së për të drejtat e njeriut, parimet udhëzuese të trajtimit të personave të zhvendosur, deklarata e Asamblesë së Përgjithshme dhe standardet e përgjithshme evropiane zbatohen me rregulloret e UNMIK-ut dhe me Kornizën Kushtetuese. Më poshtë jepet lista e shumicës së dokumenteve që udhëzojnë të kthyerit dhe procesin e riintegritimit. Secili dokument shoqërohet me një përshkrim të dispozitave dhe zbatimeve përkatëse.

Karta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut

Secili nga të tri dokumentet që e formojnë Kartën Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut thekson se të drejtat, sipas kësaj karte, duhet të gëzohen në mënyrë të barabartë, pa diskriminim. Neni 2 i Deklaratës universale mbi të drejtat e njeriut (DUDN), Marrëveshja ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike (MNDCP) dhe Marrëveshja ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (MNDESK), që të gjitha këto përbëjnë ndalimin e përgjithshëm kundër dallimeve të bëra bazuar në disa faktorë, përfshirë këtu racën, ngjyrën, gjininë, prejardhjen kombëtare, fenë, gjuhën, pasurinë, prejardhjen sociale ose lindjen. Përveç kësaj, MNDCP-ja (neni 27) përmban një dispozitë të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave në përdorimin e kulturës, fesë dhe përdorimin e gjuhës së vet. Këto standarde janë interpretuar për të kërkuar nga qeveria marrjen e hapave aktivë për të garantuar dhe ndihmuar gëzimin e njëjtë të të drejtave të tilla.

Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (KNEFDR)

KNEFDR-ja ua jep shteteve një numër të gjerë të obligimeve për ta eliminuar diskriminimin në të gjitha format e tij, që paraqitet brenda shoqërisë, apo që manifestohet si pjesë e politikës qeveritare. Sipas konventës, shtetet duhet të ndërmarrin hapa për t'i eliminuar praktikat diskriminuese dhe strategjitë. Neni 2 parasheh që qeveritë duhet ta shqyrtojnë politikën dhe legjislacionin e tyre për të siguruar se ato përputhen me parimet e përgjithshme të mosdiskriminimit dhe të gëzimit e barabartë të të drejtave të njeriut. Përveç kësaj, KNEFDR-i obligon shtetet që t'i mbrojnë të drejtat e pakicave për të pasur qasje në shërbime publike dhe në institucione, si dhe për të përkahur barazinë e tyre në organizatat private. Për ta arritur apo zhvilluar ndonjërin prej këtyre qëllimeve, duhet të ndërmirren masa të posaçme, si programe afirmative të punës, për ta siguruar besnikërinë ndaj parimeve të mosdiskriminimit.

Neni 5 (d), (e) dhe (f) i KNEFDR-së shtjellon natyrën e të drejtave të garantuara (politike apo ekonomike, sociale dhe kulturore) dhe i rendit shërbimet themelore në të cilat pakicat duhet të kenë qasje. Ndër këtë renditje, të drejtat për liri të lëvizjes, kthim, nacionalitet, pronë, strehim, zgjedhje të lirë të punësimit, arsimim dhe shërbime publike / sociale, më së ngushti lidhen me nevojat e bashkësive pakicë të Kosovës dhe me të kthyerit e mundshëm. Gëzimi i këtyre lirive të veçanta gjithashtu formon konceptin kryesor të qëndrueshmërisë dhe të asaj se si të vlerësohet një mjedis i pranueshëm i kthimit. Komisioni i ekspertëve të eliminimit të diskriminimit racor ka lëshuar një sqarim të nenit 5, ku thuhet se PZHBV-të e pakicave dhe refugjatët në veçanti duhet të kenë të drejtë të kthehen lirshëm, bazuar në kushtet e sigurisë dhe në qasje të sinqertë ndaj shërbimeve publike, përfshirë këtu ndihmën për bonifikimin dhe rehabilitimin e pasurisë. (Rekomandimet e përgjithshme XXII, 1996).

Deklarata e OKB-së mbi të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare apo etnike, fetare apo gjuhësore

Kjo deklaratë e Asamblesë së Përgjithshme i fton shtetet që të marrin hapa pozitivë për ta mbrojtur ekzistimin dhe identitetin e pakicave dhe aftësitë e tyre që t'i gëzojnë në mënyrë efikase të drejtat e tyre. Ky është një mekanizëm praktik për ta arsyetuar krijimin e programeve energjike qeveritare dhe të mekanizmave legjislativë për ta ndihmuar gëzimin e barabartë të të drejtave. Duke vlerësuar situatën e pakicave në Kosovë, neni 2, në mënyrë më të dukshme, mbron të drejtat e pakicave në pjesëmarrje efikase në jetën shoqërore, publike dhe kul-

turore, në krijimin e politikës për çështjet e pakicave dhe në marrëdhëniet ndëretnike dhe brenda etnike. Në nenin 4, thuhet se duhet të merren masat e duhura për t'u mundësuar pakicave pjesëmarrje të plotë në progresin dhe zhvillimin ekonomik. Garancionet e tilla janë standarde për riintegrimin e suksesshëm të bashkësive të Kosovës në shoqëri si tërësi.

Shtetet gjithashtu kanë obligim që ta krijojnë një mjedis përmes të cilit pakicat etnike, fetare dhe gjuhësore mund t'i shprehin karakteristikat e tyre tipike aq sa lejojnë ligjet ndërkombëtare. Ndihma e këtij parimi përfshin dispozitën e një planprogrami arsimor, i cili ofron mësim për historinë, traditat kulturore dhe gjuhët e pakicave.

Konventa Evropiane mbi të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale (KEDN) dhe standardet evropiane kundër diskriminimit

Në mënyrë shumë të ngjashme sikur DUDN-ja dhe MNDCP-ja, edhe KEDN-i u garanton pakicave gëzimin e të drejtave të barabarta përmes një dispozite të përgjithshme jo diskriminuese (neni 14), dhe përmes Protokollit 12 rishtazi të miratuar. Aty ku standardet evropiane të të drejtave të pakicave dallojnë nga standardet e dhëna në instrumentet e të drejtave të njeriut të OKB-së, urdhëresat e lëshuara nga Bashkësia Evropiane sqarojnë se çfarë obligimesh ekzistojnë sipas atyre dispozitave të përgjithshme. Në veçanti, Urdhëresa e Këshillit 2000/43/EC mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave, pa marrë parasysh prejardhjen racore ose etnike, autorizon disa mbrojtje të gjera për pakicat, përfshirë këtu kërkesat për miratimin e mekanizmave korrektues dhe zbatues.

Nga konceptet e përkrahura me këtë urdhëresë zgjerohet një trajtim i barabartë në diskriminimin indirekt që mund të paraqitet në sektorët publikë apo privatë. Ndër fushat që ky definim ka ndikim janë procedurat e ndërmarrjeve qeveritare dhe private për qasje në punësim, huazim të përvojave, projekte afariste, kushte të punësimit, trajnime profesionale, ritrajnime, arsimim, kujdes shëndetësor, strehim dhe sigurim social.

Parimet ndërkombëtare udhëzuese të OKB-së mbi zhvendosjen e brendshme

Këto parime veprojnë si udhëzues të OKB-së ndaj qeverive për dispozitat e ndihmës humanitare, ndihmës për zhvillim dhe mbrojtjen e të zhvendosurve. Bazuar në ligjin ndërkombëtar humanitar dhe në standardet e të drejtave të njeriut, të nënshkruara nga Komisioni për të drejtat e njeriut, këto parime autorizojnë personat e zhvendosur për ndihmën e nevojitur për t'u kthyer, rivendosur dhe riintegruar të sigurt në bashkësitë e tyre të prejardhjes. Prandaj, këto parime i bëjnë të qatra elementet kryesore që do ta lejonin një kthim të qëndrueshëm dhe një jetë të standardeve humane përdërisa të mbeten të zhvendosur.

Sa u përket pakicave, parimet i obligojnë autoritetet shtetërore që të ofrojnë ndihmë të barabartë humanitare dhe mbrojtëse për personat e zhvendosur pa asnjë lloj diskriminimi në baza racore, etnike, kombëtare, gjuhësore, fetare, gjinore apo identiteti politik (parimi 4). Ky parim jo diskriminues është veçanërisht i rëndësishëm sa i përket obligimit të shteteve që ta ndihmojnë lirinë e lëvizjes për PZHBV-të (parimi 14), dhe qasjen e sigurt në ushqim, strehim, veshmbathje të nevojshme, kujdes shëndetësor dhe shërbime sanitare (parimi 18.2). Parimi 25 qartazi tregon se qeveria duhet ta marrë përgjegjësinë për sigurimin e një ndihme të tillë.

Neni 5 i parimeve udhëzuese ka të bëjë me obligimin e autoriteteve qeveritare për të krijuar kushte të sigurt për kthim vullnetar. Ky obligim kërkon që të bëhen përpjekje të veçanta (parimi 28) për t'i riintegruar PZHBV-të e kthyer në shoqëri pa diskriminim (parimi 29). Përpjekjet e tilla gjatë strehimit duhet ta përfshijnë ndihmën për të kthyerit që ta rikthejnë pronën e tyre të humbur gjatë zhvendosjes [parimi 29(2)].

Konventa e OKB-së kundër diskriminimit në arsimim

Siç është garantuar edhe nëpërmjet masave të tjera ndërkombëtare, kjo Konventë mundohet të sigurojë që të gjithë fëmijët të kenë qasje në arsimim pa marrë parasysh statusin e tyre të pakicës apo gjininë. Kjo, jo vetëm që i mbron të drejtat e pakicave që të kenë objekte apo planprograme të veçanta mësimore, por gjithashtu mundëson qasjen e barabartë në fondet publike, bursa, standarde për shkollim dhe iniciativa mbi politikën kombëtare arsimore. Kjo konventë plotëson dhe përkrah dispozitat e paraqitura në Konventën mbi të drejtën e fëmijës, neni 28, i cili gjithashtu përcakton që arsimimi duhet të jetë në dispozicion reciprok për të gjithë fëmijët.

Shtojca 1A: Formati i përmbledhjes së profilit të vendit të kthimit

Profili i vendit të kthimit

(Emri i vendit të kthimit me Pinkod) Përmbledhje e profilit

Komuna / Rajoni

Muaji / Viti

Popullata	Popullata para luftës/ pas luftës*	Popullata shumicë/ pakicë *	Shifrat e personave të zhvendosur sipas vendit	Largimi i pakicave sipas vitit	Kthimit i pakicave sipas vitit	
	300/250	200/50	100 Beograd 200 Podgoricë	5- 2000 10-2001	0-2000 49-2001	
Siguria	Krimet e motivuara etnike të raportuara gjatë viteve 2000-1-2	Prania e KFOR-it	Stacioni policor	SHPK-ja: Patrullimet e përziera Numri i pakicave	Vlerësimi i KFOR-it mbi sigurinë	
	10-2000 2-2001 0-2002	2 pika statike kontrolli 2 rrugë të patrullimit në këmbë	1 Nën-stacion policor	Po 10	Kat 1	
Liria e lëvizjes	Disponuesh- mëria e transportit publik	Transportimi me përcjellje në dispo- zicion sipas nevojës	Targat KS në dispozicion	Qasja në tregun e qytetit	Qasja në ndërtësën komunale	Përdorimi i lirë i guhëve të pakicave në vendet publike
	Po	Nuk ka nevojë	Po	Po	Po	Po
Strehimi	Numri i përgjithshëm i shtëpive para luftës / pas luftës *	Numri i shtëpive të shumicës/ pakicave *	Numri i shtëpive të dëmtuara të shumicës/ pakicave *	Numri i shtëpive të okupuara të shumicës/ pakicave *	Shtëpitë e rindërtuara të shumicës /pakicës nëpërmjet ndihmës së donatorëve	Shtëpitë e zbrazëta të shumicës/ pakicave
	235/156	200/100	23/15	0/15	20/10	0/0
Infrastruktura	Shkollat fillore dhe të mesme	Spitalet / Ambulancat	Linjat telefonike	Linjat e rrymës	Kanalizimi i ujit / ujërave të zeza	Rrugët
	2 shkolla të mesme 3 shkolla fillore	Po	Po	Jo	Jo	Po
Qasja e pakicave në shërbime publike	Shkollimi fillor dhe i mesëm	Shëndetësia	Ndihma sociale	Ndihma humanitare	KEK-u	PTK-ja
	2 shkolla të mesme 3 shkolla fillore	1 Ambulancë	Po	Po	Po	Po
Punesimi i pakicave	Institucionet publike	Ndërmarrjet në pronësi shtetërore	Org ndërkomb dhe OJQ-të	Numri i përgjithshëm i të punësuarve	Numri i përgjithshëm i të papunësuarve	
	5	12	X	7	32	
Projekte të përfunduara Të financuara nga B.N.	Rindërtimi i shtëpive nga OJQ-të	Projektet e infrastrukturës nga OJQ-të	Projektet ekonomike /të krijimit të të ardhurave	Projektet për ndërtimin e kapaciteteve	Aktivitetet e dialogut ndëretnik	
	24 SIDA 69 THË	Ujërat e zeza SDA	Kujdesi për mikrokredi	Trajnimi i kuadrove OSBE	Dita e tregut shumetnik	

Shtojca 1B: Formati i profilit të vendit të kthimit

UNHCR ka një agjenci kryesuese që e kryen këtë detyrë në çdo rajon

Profili i bashkësisë:

SHIKIM I SHPEJTË

Fshati:

Komuna:

Pinkodi:

[konsultoni atlasin e Kosovës të botuar nga QHIB]

Vështrim i gjendjes:

[rurale / urbane, e vogël / e madhe, e izoluar, etj]

LeL / situata e sigurisë:

[kufizime të mëdha / vogla, lëvizje e lirë]

Situata ekonomike:

[% e familjeve me të ardhura, rezerva të pasurisë]

Integrimi social:

[shumë i mirë / i mirë / i dobët / rrezik i lartë]

Qasja në shërbime:

[shumë e mirë / e mirë / e dobët]

Profili i popullatës:

Gjithsej:

Shqiptarë Serbë Romë Egj / Ashk Të tjerë

Para luftës:

2002:

arritjet e reja:

largimet e reja:

Analizë e cenueshmërisë (rreziku bashkësia pakicë të largohet):

[në zgjerim / stabil / i ndieshëm / në zvogëlim]

Botim:

[Data]

[Versioni #]

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM / PJESET KRYESORE

1.1 Vështrimi i vendit / situatës

Në këtë seksion, bisedoni / shkruani për kushtet para luftës dhe pas luftës. Ofroni një përmbledhje në lidhje me rajonin, duke përfshirë këtu të gjitha grupet etnike. Kjo do t'u mundësojë lexuesve që ta kenë një përmbledhje gjithëpërfshirëse. Çështjet që duhet mbuluar:

- *Vendi brenda zonës së përgjegjësise*
- *Vështrimi i zonës: malore, kodrinore, e rrafshët, e thatë, tokë e pasur, e izoluar gjatë dimrit.*
- *Grupet etnike në bashkësi, para luftës dhe pas luftës, dhe vendi brenda rajonit.*

1.2 Vështrimi i përgjithshëm / Pjesët kryesore

Çështjet kryesore të cilat e preokupojnë bashkësinë, qëndrueshmëria / cënueshmëria e pjesëtarëve të pakicave për t'u detyruar që të largohen në zhvendosje, trendet, mundësitë dhe rreziqet aktuale.

1.3 Problemet / mundësitë

- *Zhvendosja e përgjithshme e popullatës*
- *Shkatërrimi i shtëpive*
- *Infrastruktura publike është e papërshtatshme*
- *Nevojiten më tepër vegla mjekësore*
- *Probleme në komunikim me zyrat e komunës*
- *Femrat janë të papunësuar*
- *Mungesë e aktiviteteve të rinisë*
- *Siguria për bashkësinë serbe*
- *Testimi i cilësisë të ujit të bunareve*
- *Infrastruktura publike (kanalizimi, rrjeti i ujit, linjat telefonike dhe linjat e reja elektrike)*
- *Infrastruktura bujqësore*

1.4 Zgjidhjet e mundshme

- *Zgjidhje aktive*
- *Zgjidhje afatshkurtëra*
- *Zgjidhje afatgjata*

2. DEMOGRAFIA

2.1 Kthimet / Largimet

- *Profili i moshës, fëmijët, adoleshentët, popullata e moshuar*
- *Meshkujt kundrejt femrave*

2.2 Kthimet

Mendimi praktik duhet të mbizotërojë në këtë seksion. Këto informata duhet të përfshihen vetëm nëse janë të rëndësishme. Duhet siguruar që pengesat e kthimit të theksohen.

Shënim:

- *Numri i njerëzve që presin të kthehen*
- *Ku janë të vendosur momentalisht?*
- *Çfarë është demografia e personave që dëshirojnë të kthehen, mosha, etj, numri i familjeve?*
- *Arsyja e dëshirës për t'u kthyer; për të jetuar, renovuar apo meremetuar shtëpinë dhe për t'u kthyer në vendbanimin e ri*
- *Aftësia për të punuar apo për të gjetur punë*

2.3 Largimet

Shënim:

- *Numri i njerëzve që presin të largohen*
- *Ku janë të vendosur momentalisht?*
- *Çfarë është demografia e personave që dëshirojnë të largohen, mosha, etj, numri i familjeve?*
- *Arsyja e dëshirës për t'u larguar; a e kanë shitur shtëpinë e tyre, mungesa e mundësive për të punuar*
- *Aftësia për të punuar apo për gjetur punë në vendin e ri?*

2.4 Vizitat shko dhe shiko

Shënim:

- *Kur planifikohen vizitat?*
- *Kush, çka, kur, ku, si?*
- *Konsensusi i bashkësisë lokale?*
- *Perceptimi i problemeve*
- *Zgjidhjet e mundshme*

Përmbledhje e faktorëve që ndikojnë në lëvizje, qoftë ajo të shkohet apo të mos shkohet.

2.5 Rekomandimet në lidhje me kthimet

3. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZHVENDOSJE

3.1 Liria e lëvizjes dhe siguria

Ofro analizë cilësore përse ekziston çështja e lirisë së e lëvizjes.

Shënim:

- *Vendi i pikave më të afërta të kontrollit:*
- *KFOR-i i caktuar:*
- *Transporti me përcjellje në dispozicion nga organizatat ndërkombëtare: (qarkullon prej - deri në, sa shpesh, kostoja, numri i udhëtarëve)*
- *Ndihma që ofrohet dhe që ndikon në lirinë e perceptuar të lëvizjes.*
- *Transporti privat në dispozicion: (qarkullon prej - deri në, sa shpesh, kostoja, numri i udhëtarëve)*
- *Forma mbizotëruese e transportit:*
- *Qasja ndaj karburanteve:*
- *Fshatarët udhëtojnë prej - deri në: (arsyeja)*
- *Zonat problematike gjatë udhëtimit: (rajonet problematike, p.sh. kalimi nëpër disa fshatra shqiptare).*
- *Patrullat e përziara etnike*
- *Vendet e stacioneve policore*
- *Statistikat e dhunës ndëretnike*

3.2 Integrimi në shoqëri

shkalla e integritit të pakicave në shoqëri, politikë, dhe në jetën ekonomike të zonës më të afërt.

Marrëdhëniet ndëretnike, ndjenjat, ngjarjet e mëhershme të cilat mund të ndikojnë në kthimin e ardhshëm. Qëndrimi i autoriteteve përkatëse (si të pakicave, ashtu edhe të shumicës) mbi pranimin e njëri-tjetrit.

Perceptimi / rastet aktuale në të cilat integrimi në shoqëri ndërmjet bashkësive ndëretnike është i dukshëm, me theks të veçantë në bashkëveprimin e popullatës së kthyer me bashkësitë lokale dhe të përhapura.

3.3 Banimi / Strehimi

Shtëpitë serbe të cilat kanë qenë në gjendje të keqe janë rindërtuar nga IRC-ja. Gjithashtu janë shpërndarë dyer dhe dritare për riparime të vogla. Çdo familje ka në pronësi ndërmjet 5 - 10 hektarë tokë bujqësore (sidoqoftë, siç është cekur edhe më lart, ata janë në gjendje të kultivojnë 0.5 hektarë). Kanë gjithsej dy traktorë dhe dy automjete private (por nuk kanë qasje në benzinë / naftë) dhe një kombajnë në fshatrat e vogla serbe të Slivovës. Nuk ekziston asnjë mulli lokal. Sidoqoftë, në vitet e kaluara, agjencitë ndërkombëtare kanë ndihmuar në transportimin e drithërave në Llaple Sellë (afër Prishtinës) për bluarje. Çdo familje aktualisht ka nga një lopë për prodhimin e qumështit për jetesë.

Shënim:

- *Dëmtimi i shtëpive*
- *Aktivitetet e kaluara / të tanishme sa i përket rindërtimit (llojet e riparimeve, dritaret, dyert, hapësirat e banueshme)*
- *Agjencitë që ofrojnë ndihmë në strehim*
- *Shtëpitë dhe toka e uzurpuar*

- *Shitja e shtëpive*
- *Raportet evropiane të ndërtimit*
- *Ankesat për të cilat dihet / ndërmjetësimi në vazhdim / gjykimi në vazhdim / zgjidhjet*

Informatat nga ky seksion duhet të shfrytëzohen me kujdes, këtu duhet të përfshihen vetëm çështjet e rëndësishme.

3.4 Analiza ekonomike

Sigurimi i tokës në pronësi, automjeteve, traktorëve (komunalë) dhe bagëtisë.

Burimet kryesore të të ardhurave [shiko punësimin, paratë e dërguara nga jashtë, pensionet / pagat nga Serbia, përkrahja brenda bashkësisë, etj.]

Profesionet kryesore / shkathësitë e banorëve.

Analizë e lëvizjes së dërgesave (shiko vështirësitë e konsumatorëve për të gjetur artikuj me shumicë në vendet në të cilat autobusët nuk e mundësojnë këtë, cilat mallra janë duke lëvizur nga njëri vend në tjetrin, burimet e furnizimit me një vështrim në prodhimtarinë lokale e cila zëvendëson importet, tregëtia ndëret-nike, qasja në tregjet e afërta, etj).

Bujqësia (shiko si mund të sigurohet toka e kultivuar, vendi i tokës që është e paarrtshme për shkak të sigurisë / uzurpimit, prodhimit, vëllimit të shitjes)

Afarizmi / veprimet bankare / kreditë (trajtoni çështjen e qasjes, burimeve të kredisë, cilat para janë duke u shfrytëzuar aktualisht: euro, dhrahmi)

Punëdhënësit (numri i punëtorëve të mëparshëm, sa pranojnë para të dërguara nga jashtë, punëtorët e pakicës / shumicës në administratë apo të dhëna të tjera treguese.)

Kostoja e jetesës

4. QASJA NDAJ SHËRBIMEVE PUBLIKE

4.1 Ndihma sociale

Trendet - boshllëqet - pengesat që duhet të vihen në pah

Analizë e trendeve (Ndryshimi i çregjistrimeve, kërkesave, verifikimit të problemeve, distanca gjerë në zyrat e shërbimit të ndihmës sociale, qasja në vendin e zyrës).

Ekzistojnë përafërsisht 14 familje rome dhe serbe, të cilat aktualisht pranojnë ndihmë sociale nga UNMIK-u. 30 familje të tjera, kryesisht PZHBV të cenueshëm, janë duke pranuar ndihmë në formë ushqimore (Programi botëror për ushqim). Fshati Preoc, gjithashtu ka pranuar të njëjtën ndihmë humanitare si Çagllavica dhe Llapla Sella.

Shëno ndryshimet në sigurimin e ndihmës që ofrohet dhe ata të cilët së shpejti do të shlyhen, si dhe ndikimi i kësaj në bashkësi p.sh., përfundimi i programit të rjetit të sigurisë dhe ndikimi në bashkësinë / mekanizmat përballuese.

4.1.1 Ndihma humanitare

Më:				
Ndihma e ofruar	Agjencioni ndihmues	Përshkrimi i ndihmës	Rajonet të ndihmohen	Përkatësia etnike e atyre që ndihmohen
Qershor 2001	Save the Children	Artikuj ushqimor	Preocë, Çagllavicë	12 familje rome, 14 familje serbe

4.2 Shëndetësia

Forma mbi shfrytëzimin e objekteve shëndetësore (mjekësore) (Sugjerim i ri Shto hartën e vendit me zonën e shërbyer)

Analizë e objekteve shëndetësore (vendi i shërbimeve, radioskopia, ultrazëri, etj, distanca nga klientët, mbulesa e shërbimeve emergjente / ambulancës, furnizimi me ushqim i punëtorëve të shëndetësisë, boshllëqet.)

4.3 Arsimimi

Detajet lidhur me shkollën:

- Vendi
- Përshkrimi i objektit
- Mundësia e qasjes për fëmijët
- A janë duke marrë pjesë të gjithë fëmijët?
- Klasët e mbuluara
- Periudha në të cilën shkolla është e hapur
- Mësimdhënësit
- Nivelet e mbuluara
- Cilat shkolla dhe ku janë të vendosura ato nëse kërkohet arsimimi i lartë?

Analizë e hartës [Ndryshimet në përcjelljen e nxënësve, ndërrimet / grumbullimi, objektet e përziera]

4.4 Shërbimet komunale

Uji / ujërat e zeza (Burimi: ujë ujësjetllësi / bunari / tjetër, funksionon / nuk funksionon, testimi i fundit i cilësisë, ujërat e zeza janë të kanalizuar apo shfrytëzohen nevojtoreset, sistemi septik apo derdhja në lumë, funksionon apo jo, afërsia nga bunarët...)

Mënyra e hedhjes / mbledhjes së mbeturinave (mbledhen apo nuk mbledhen, ku hedhen)

Mesatarja e rrymës që pranohet, që furnizohet nga cili vend, a i paguajnë njerëzit faturat ?

4.5 Komunikimi publik

Komentet lidhur me shkallën e integritimit apo izolimit të bashkësisë me zonat e tyre fqinje, me pjesët e tjera të Kosovës / Serbisë dhe Malit të Zi, IRMJ-së, dhe me vende më të largëta.

Lidhjet telefonike

Interneti

Gazetat që lexohen në bashkësi / frekuenca e furnizimit

Televizioni / radio

Publikimet që veçanërisht synojnë pakicat / PZHBV-të / të kthyerit

4.6 Informatat / dokumentacioni / ndihma ligjore

Identifiko boshllëqet, rajonet problematike (ku pakicat nuk janë duke pranuar informata mbi shërbimet qeveritare / komunale, afatet e fundit, informata mbi ndryshimet në përcjellje apo gjëra të tjera - a kanë ekzistuar faturat e shërbimeve komunale në të kaluarën, këmbimi i monedhave...)

5. KOMENTET / PËRSHTYPJE TË PËRGJITHSHME

Çfarëdo që agjencioni kryesues dëshiron të shtojë që është me rëndësi dhe që nuk është përmendur gjetiu.

Shtojca 2

Vlerësimi i sigurisë së fshatit (VSF)

1. Hyrje. Vlerësimi i sigurisë së fshatit (VSF) është raport me shkrim i përgatitur për grupin punues komunal (GPK-ja) nga KFOR-i që vepron në atë komunë. Raporti është vlerësim gjithëpërfshirës për situatën e sigurisë në një fshat specifik (ose bashkësi të fshatrave të lidhura ngushtë), që është duke u diskutuar në seancat e GPK-së. Me rastin e përfundimit, batalioni i KFOR-it për manovrim bën paraqitjen e VSF-së së bashku me një rekomandim se a do të përkrahet kthimi i propozuar nga ambienti lokal i sigurisë. Së bashku me VSF-në, vlerësimet e tjera të kryera nga anëtarë të ndryshëm të GPK-së janë pjesë e vlerësimit të gjithmbarshëm të GPK-së.

2. Të përgjithshme. Batalioni i KFOR-it për manovrim ka rolin kryesor për përgatitjen e raportit përfundimtar, me përkrahjen e policisë civile. Njësia e KFOR-it për manovrim do të kërkojë ndihmën e resurseve shtesë të GPK-së (p.sh. UNHCR-së, OJQ-ve) dhe resurseve të përkrahjes së përgjithshme (PP-së) të KFOR-it (p.sh. çështjeve civile, policisë ushtarake, veprimeve psikologjike, qendrës për veprim ndaj minave, dhe inteligjencës në nivel të brigadës, si dhe aftësitë analitike). Drejtimi i VSF-së është një proces trehapësh: planifikimi, hulumtimi, dhe përgatitja përfundimtare:

- Faza e planifikimit fillon kur GPK-ja kërkon nga batalioni i KFOR-it për manovrim që të përgatisë VSF-në për ndonjë fshat specifik. Shtabi i BSHK-së së KFOR-it për manovrim "miraton" kërkesën e GPK-së duke përcatuar edhe formalisht batalionin e duhur dhe duke përkrahur resurset me anë të shfrytëzimit të urdhërave fragmentare (FRAGO). Sipas nevojës, GPK-ja i drejton pjesëmarrësit e duhur të GPK-së (UNHCR-në, OJQ-të, përfaqësuesit e PZHBV-e, etj.) që të ofrojnë ndihmë me rastin e kërkesës së njësies së KFOR-it për manovrim. Gjatë fazës së planifikimit, batalioni i manovrimit, policia civile, dhe resurset përkrahëse bashkëpunojnë për ta zhvilluar një kornizë kohore dhe një plan për përgatitjen e raportit. Me fjalë të tjera, të gjitha palët e përfshira në procesin e VSF-së bashkëveprojnë për të përcaktuar se çfarë pune duhet të kryhet, për të vendosur se kush është përgjegjës për ta bërë atë, dhe për të arritur marrëveshje mbi afatet kohore dhe caqet përfundimtare. Kjo fazë mbaron kur batalioni i manovrimit e informon GPK-në (apo administratorin komunal) dhe ata pranojnë datën në të cilën raporti do të përfundojë.
- Faza e hulumtimit fillon kur batalioni i manovrimit, policia civile, dhe resurset përkrahëse fillojnë të mbledhin informata dhe ta përkrahin raportin. Gjatë gjithë fazës së hulumtimit, të gjitha palët duhet të takohen sipas nevojës për të siguruar harmonizimin e përpjekjeve dhe për t'i ndarë informatat. Kjo fazë mbaron kur të jenë mbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme.
- Faza përfundimtare përgatitore fillon kur batalioni i manovrimit fillon të punojë në versionin përfundimtar të VSF-së. Ai përfundon kur batalioni i manovrimit ia paraqet GPK-së (apo administratorin komunal) VSF-në e përfunduar.

3. Formati i raportit: VSF-ja e përfunduar përbëhet prej 8 pjesëve, siç është përshkruar më poshtë. Qëllimi nuk është diktimi i "formatit" aktual për raport (p.sh. në formë tregimi, paraqitje në "powerpoint," apo ndonjë kombinim i përshtatshëm i të dyjave); më tepër, qëllimi është që të ofrohet një strukturë e standardizuar e "pyetjeve dhe çështjeve bazë" të cilat duhet të merren parasysh dhe të vlerësohen.

A. Përmbledhja ekzekutive. E bashkëpunuar nga batalioni i KFOR-it për manovrim dhe policia civile.

- Ofron një përmbledhje të zbulimeve dhe rekomandimeve me rëndësi të mbuluara në VSF.
- Ofron përgjigje ndaj pyetjes: "Cilat janë arsyet kryesore për të cilat njerëzit janë larguar nga fshati." Hollësitë janë të mbuluara në seksionin e raportit që ka të bëjë me aftësinë e pranimit.

- Gjithashtu, përmbledhja ekzekutive i qaset ekzistimit (apo mungesës) së burimeve të tjera të informimit, si dhe rëndësisë së tyre të tanishme ndaj aspekteve të sigurisë në fshat (p.sh. "libri mbi betejat" i KFOR-it, profilet e fshatrave të kryera nga UNHCR, raportet e "Misionit verifikues të Kosovës", apo raportet e OJQ-ve dhe të organizatave të tjera).
- Së fundi, përmbledhja ekzekutive "vlerëson" fshatin përkitazi me faktin se a do të përkrahet kthimi nga aspekti i sigurisë:
 - **E gjelbër:** Ekzistojnë probleme të vogla të sigurisë, por nuk pritet që ato të kenë ndikim të madh në kthim. Kthimi mund të kryhet siç është parashikuar nga GPK-ja.
 - **E verdhë:** Ekzistojnë probleme të rëndësishme të sigurisë të cilat ka gjasa të kenë ndikim në kornizën ideale kohore dhe në procesin e kthimit, por problemet kanë gjasa të arsyeshme të zgjidhen brenda një periudhe të pranueshme kohore.
 - **E kuqe:** Ekzistojnë probleme të mëdha të cilat nuk ka gjasa të zgjidhen në kohë të duhur për realizimin e kthimit siç është paraparë nga GPK-ja. Arsye tjetër për vlerësim të "kuq" mund të jetë kur siguria për të kthyerit ka gjasa të kërkojë një numër më të madh të ushtarëve të KFOR-it dhe / ose të policëve të policisë civile për të ruajtur paqen.

B. Faktorët gjeografikë. Kryhet nga batalioni i KFOR-it për manovrim, me ndihmë të organizatave të tjera siç koordinohet nga batalioni i KFOR-it nëpërmjet GPK-së ose shtabit të BSHK-së së KFOR-it.

- Përshkruan si aspektet e ndryshme gjeografike mund të ndikojnë në sigurinë e fshatit. Kjo nuk do të thotë që të gjithë faktorët e përshkruar më poshtë vlejné, mund të ketë edhe faktorë të tjerë.
- Kontrollon afërsinë e fshatit me kufirin, dhe nëse kjo ndikon në sigurinë e fshatit.
- Vlerëson nëse ekzistojnë linja të mëdha të kontrabandimit apo kriminalitetit të cilat kalojnë nëpërmjet fshatit apo afër tij.
- Vlerësimi i rrezikut nga minat / mjetet e paeksplojuara: a ekziston rrezik nga minat / mjetet e paeksplojuara për të cilat dihet, brenda fshatit apo në afërsi të tij? Rreziqet mund të jenë në formë të fushave ekzistuese të minuara, për të cilat dihet, koncentrimet e minave / mjeteve të paeksplojuara që nuk janë spastruar apo janë spastruar pjesërisht, dhe hapësirat të cilat kanë pasur incidente të shpeshta të objekteve të minuara apo të mjeteve të tjera eksplozive. Ofro detajet ashtu siç jepen nga Qendra për aksion ndaj minave (QAM) e KFOR-it dhe G-2-shi. QAM-i dhe G-2-shi gjithashtu do ta dinë nëse është planifikuar ndonjë punë për spastrimin e minave / mjeteve të paeksplojuara gjatë 6 muajve të ardhshëm.
- Përfshije një "hartë vektoriale" të fshatit siç përgatitet nga ekipi topografik i KFOR-it.

C. Aftësia e pranimit. Kjo pjesë e raportit plotësohet nga batalioni i KFOR-it për manovrim, por shumica e kontributeve për këtë seksion do të arrijnë nga UNHCR-ja, OJQ-të, dhe çështjet civile të KFOR-it, si dhe resurset e intelgjencës të cilat punojnë në hapësirën e synuar. Kjo është një pjesë e procesit të VSF-së në të cilin GPK-ja duhet t'i drejtojë UNHCR-në dhe OJQ-të zbatuese për t'i ndihmuar KFOR-it. Burimi tjetër kryesor i informatave "historike" do të jetë zyra G-2 e KFOR-it. Vlerësimi i aftësisë së pranimit përfshin:

- Identifikimin e "pikave të nxehta" të mundshme ndër bashkësinë pranuese që mund të ndikojë në siguri me rastin e realizimit të kthimit. Në këtë proces çështje qenësore është identifikimi i arsyeve për shkak të të cilave njerëzit janë larguar nga fshati ... dhe si këto arsye mund të ndikojnë në sig-

urinë e të kthyerve. Kjo ka gjasa t'i përfshijë bisedat si me bashkësitë pranuese, ashtu edhe me ato që kthehen. Kur të kthyerit aktualisht nuk jetojnë brenda ndonjë sektori të KFOR-it, procesi i bisedimit me ata është i komplikuar. Në këtë rast, zyrat e UNHCR-së dhe të OJQ-ve të tjera mund të ofrojnë ndihmë të jashtëzakonshme.

- Vlerësimi i sjelljes së popullatës pranuese ndaj kthimit. Si do të ndikojnë perceptimet e tyre në kthimin në fshat? Thekso çfarëdo sjelljesh të veçanta "negative" apo "pozitive" në publik apo çfarëdo grupesh specifike të njerëzve në fshat (p.sh. ndonjë pakicë tjetër, persona të tjerë të zhvendosur, njerëzit specifike apo partitë politike, etj).
- A përkrahet kthimi nga udhëheqësia lokale fshatare? Vetëm me fjalë, apo edhe me vepra?
- Emrat e aktorëve kryesorë në kuvendin komunal dhe qëndrimet e tyre individuale sa i përket kthimit. Aktor kryesor është çfarëdo anëtar i kuvendit komunal i cili duhet të ketë shprehur interesim në kthimin e planifikuar.
- Nuk duhet ofruar përgjigje vetëm ndaj pyetjes "pse" u larguan, por gjithashtu edhe "kur" u larguan.

D. Faktorët e krimit dhe dhunës. Kryhet nga policia civile dhe SHPK-ja me ndihmën e policisë ushtarake të KFOR-it e cila vepron në komunë, njësia e KFOR-it për manovrim, dhe G-2-shi i KFOR-it.

- Identifikon dhe përshkruan trendet e krimit apo aktivitetet e ekstremistëve në fshat, dhe ndikimet e mundshme të aktiviteteve të tilla me rastin e kthimit.
- Nëse kthimi i pakicave tanimë ka qenë duke ndodhur, apo në vende në të cilat pakicat jetojnë në fshat, ky seksion u qaset tensioneve ekzistuese ndëretnike siç është shfaqur nga dhuna dhe krimi ... si dhe nga çfarëdo dëshmishë të tjera të dhunës / krimit të ndërlydhura me kthimin (p.sh. kërcënimi në baza etnike ...).
- Raporti do të vëjë në pah nëse ekzistojnë fshatarë të rëndësishëm të përfshirë në krime apo ekstremizëm, cilat janë aktivitetet në të cilat ata janë të përfshirë, dhe si aktivitetet e tyre mund të ndikojnë në kthimin. Emrat nuk do të publikohen në VSF.

E. Statusi i forcave policore dhe resurset e tjera të sigurisë. Kryhet nga policia civile, policia ushtarake, dhe batalioni i manovrimit.

- Cila është "prania tipike e policisë" në fshat? Për shembull ... a ekziston ndonjë nënstacion? A krijohet prania e policisë nga patrullimet? A veprojnë patrullimet në këmbë në fshat? Sa janë të shpesh-ta patrullimet? A angazhohet popullata nga patrulluesit? A është prania e policisë e rrallë, rutinore, apo vetëm në rast nevoje?
 - A janë patrullimet shumëetnike (dhe a përmbajnë etnicitetin e të kthyerve)?
 - Cila është sjellja e fshatarëve ndaj policisë - në përgjithësi a ndihmojnë apo e pengojnë aftësinë e policisë për të ofruar rend dhe qetësi / A ekziston ndonjë trend?
 - A ka policia civile plane të ardhshme të cilat mund të ndikojnë në mënyrën në të cilën kryhet puna e policisë në fshat (p.sh., ndryshimet e vendeve të stacioneve, krijimi apo humbja e ndonjë nënstacioni, më tepër polici shumëetnike)?

- Çfarë është prania e KFOR-it në fshat? A ekziston prania e përhershme e KFOR-it, apo prania krijohet përmes patrullimeve? A veprojnë patrullimet në këmbë në fshat? Cila është frekuenca e patrullimeve? A e angazhojnë ushtarët popullatën? A është prania e ushtarëve e rrallë, rutinore apo vetëm në rast nevojë?
 - Cila është sjellja e fshatarëve ndaj KFOR-it - në përgjithësi, njerëzit a e ndihmojnë KFOR-in apo e pengojnë atë? A ekziston ndonjë trend?
 - A ka KFOR-i ndonjë plan të ardhshëm i cili mund të ndikojë në mënyrën në të cilën kryhen veprimet e sigurisë në fshat (p.sh., heqja e pikave të kontrollit, ndërprerja e pranisë së përhershme, më pak patrullime, ndryshimi apo largimi i përhershëm i njësive)?

F. Liria e lëvizjes (LEL). Kryhet nga batalioni i manovrimit. Në hapësirat në të cilat ka popullatë pakicë, liria e lëvizjes mund të vlerësohet duke biseduar me pjesëtarët e bashkësisë pakicë. Sidoqoftë, në vende në të cilat pakicat ende nuk janë kthyer, vlerësimi i lirisë së lëvizjes do të jetë më tepër problematik dhe do të projektohet bazuar në vlerësimin e "aftësisë së pranimit" të bashkësisë pranuese, siç është diskutuar në paragrafin 3 c më lart. Çështjet e vlerësuara nën LEL përfshijnë:

- A do të kenë personat e kthyer qasje në shërbime publike, mallra, transport masiv, shkolla etj.?
- A mund të ecin nëpër rrugë apo të vozisin veturat e tyre nëpër fshat pa pasur frikë nga kërcënimi apo nga masat e tjera të ndëshkimit?
- Përkrah problemet e njohura apo të mundshme.

G. Çështje të tjera. Batalioni i KFOR-it për manovrim ka përgjegjësinë për ta harmonizuar këtë seksion bazuar nga informatat e cilësdo palë të përfshirë në procesin e VSF-së.

- Shfrytëzoje këtë seksion për të identifikuar çështje të tjera të cilat besoni se mund të ndikojnë në kthimin në këtë fshat.

H. Përfundimet dhe rekomandimet. Punohet në bashkëpunim të batalionit të KFOR-it për manovrim dhe policisë civile, me informata nga palë të tjera të cilat marrin pjesë në procesin e VSF-së.

- Ky seksion thekson çështjet kryesore të sigurisë të cilat identifikohen gjatë kryerjes së VSF-së. EDHE MË ME RËNDËSI - ofron rekomandime si duhet të trajtohet çdo çështje e sigurisë.
- Përfundimet dhe rekomandimet duhet të jenë në përputhje me informatat të cilat jepen në përmblidhjen ekzekutive të raportit.

Përgatitur nga BSHK (L)

Shtojca 3

SUGJERIME MBI INTERVISTAT E VIZITAVE SHKO DHE SHIKO

Qëllimi i intervistave VSHSH është që të mbledhen informata mbi historikun e personave të zhvendosur, si dhe mbi nevojat e infrastrukturës lokale në mënyrë që të identifikohen projektet zhvillimore dhe nevojat e planifikimit për kthimin e mundshëm.

Për t'i arritur këto qëllime, pyetësorët e nevojshëm për VSHSH-të do të bazohen në katër pjesët në vijim:

1. Vlerësimi social i të khtyerit të mundshëm ku përfshihen informatat në vijim:

- Forma për vlerësimin social për rindërtimin e shtëpive
- Përbërja e ekonomive shtëpiake
- Strehimi i tanishëm
- Prona e ekonomisë shtëpiake
- Të ardhurat e gjithmbarshme mujore të ekonomive shtëpiake
- Vlerësimi paraprak i dëmtimit të shtëpisë

2. Vlerësimi i kushteve të zhvendosjes:

- Statusi i ekonomisë shtëpiake (anëtarët e familjes, mosha, cenusshmëria etj.)
- Statusi i rezidencës
- Statusi i punësimit (për të gjithë anëtarët e familjes)
- Arsimimi (çështja gjuhësore, vijimi i fëmijëve në shkollë)
- Shëndetësia
- Integrimi në bashkësinë lokale (pjesëmarrja në jetën sociale, çështjet gjuhësore dhe fetare, etj.)
- Të ardhurat e gjithmbarshme mujore të amvisërisë

3. Pyetësori mbi qëndrueshmërinë e jetesës ku përfshihen informatat në vijim:

- Kushtet e tanishme të jetesës dhe strehimit
- Situata financiare (të ardhurat)
- Kualifikimet e përgjithshme të arsimimit / trajnimit (pavarësisht nga puna e tanishme)
- Pranimi i ndihmës humanitare
- Fleta e punësimit (aktivitetet e krijimit të të ardhurave për fillimin dhe përforcimin e afarizmit)

4. Infrastruktura lokale (vlerësimi i dëmeve)

- Mbledhja e informatave të përgjithshme mbi vendin
- Informatat mbi fshatin: (shtëpitë e dëmtuara, rrugët, furnizimi me ujë / kanalizimi, rryma, shëndetësia dhe objektet shkollore)
- Përmbledhja e vendit (identifikimi i kostos së dëmtimit dhe rindërtimit)

5. Fleta mbi përfituesit e zhvendosur të pakicave

- Të dhënat personale dhe ato mbi vendin
- Seksioni 1: Realizueshmëria e kthimit
 - 1.A: Çështjet e sigurisë
 - 1.B: Kthimi i qëndrueshëm
 - 1.C: Strehimi
- Seksioni 2: Rindërtimi i shtëpive

Shtojca 4

KORNIZA E KONCEPT DOKUMENTIT Projektet e kthimit

I. INFORMATAT BAZË

Fleta përmbledhëse duhet të përmbaj informatat në vijim

- Emrin e organizatës aplikuese
- Titullin e projektit
- Identifikimin e hapësirës së intervenimit: komunën, fshatin/lagjen
- Informatata kontaktuese (emri, adresa, telefoni, faksi, e-mail adresa)
- Data e dorëzimit
- Shuma e gjithëmbarshme e fondeve të kërkuara.

II. PËRSHKRIMI I PROBLEMIT (1 faqe)

Përqëndrimi i këtij seksioni është mbi situatën në të cilën aktivitetet do të adresohen e jo në kapacitetet dhe aktivitetet e brendshme institucionale të organizatës.

Përshkruaj:

- Problemet specifike në të cilat do të adresohet projekti;
- Shkaktarët e problemeve;
- Kush influencohet (përfshirë përfituesit e synuar) dhe si;
- Çështjet relevante të ambientit të politikës dhe të ambientit punues; programet egzistuese, aktivitetet, organizatat të cilat kontribuojnë në adresimin e problemeve;
- Ofro analiza të pjesëve pozitive, dobësive, dhe/ose zbrastësirave në iniciativat ekzistuese;
- Identifiko sfidat të cilave do ti adresohet projekti;
- Trego se kush është konsultuar me rastin e krijimit të koncept dokumentit (p.sh. strukturat komunale/departamentet relevante, personat e zhvendosur/refugjatët, etj.); dhe
- Përfshijë informata mbi diskutimet e mëparshme të ndërmarrura brenda GPK-së, të cilat kanë shpjer drejt projektimit të koncept dokumentit.

III. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT (3-5 faqe)

Caqet dhe objektivet e projektit

Caqet dhe objektivet: Ky duhet të jetë një formulim i ndikimit që do të arrihet (p.sh. sqaro çfarë do të jetë gjendja/statusi/ndikimi me përfundimin e këtij projekti, dhe jo se çfarë do të jenë proceset/hapat/aktivitetet të cilat do të ndërmerren). Këto duhet të ndërliiden drejtpërdrejtë me problemet specifike të identifikuara dhe të prioritetuara në Seksionin II më lartë.

Përfituesit: Ky seksion duhet të përshkruajë cilat aktivitete kanë shpjer drejt identifikimit të dëshirës së vërtetë të përfituesve potencial për tu kthyer (p.sh. VShI-të dhe VShSh-të të cilat janë ndërmarrur, puna ndërkufitare e kryer nga OJQ-ja, kontakti i vendosur me personat e zhvendosur). Duhet të përshkruhet se kush janë anëtarët e grupit të synuar (p.sh. përfituesit) që do të përfitojnë/marrin pjesë në projekt, dhe numri i parashikuar. Organizatat duhet të përfshijnë përshkrimin e tyre të karakteristikave të grupit të synuar siç janë: gjinia, etniciteti, vendi i prejardhjes, vendi i zhvendosjes, data dhe rrethanat (p.sh. gjatë apo pas luftës) e largimit, dhe karakteristika të tjera me rëndësi.

Strategjia e projektit

Përshkruaj strategjinë dhe qasjen e gjithmbarshme të projektit. Kjo duhet të qartësojë mënyrën se si implementimi i projektit do të adresohet kufizimeve kyçe të identifikuar në analizat e problemit. Ofro një arsyetim tërësor të zgjedhjes së mënyrës së intervenimit dhe strategjive, përfshirë identifikimin dhe analizat e qasjeve alternative.

Strategjia e projektit duhet të pasqyrojë vlerësimin e kryer mbi situatën e sigurisë dhe lirinë e lëvizjes në lokacionin potencial të kthimit, si do të ketë ndikim në procesin e kthimit dhe çfarë masa parashikohet të ndërmerren për të tejkaluar ato pengesa, poqëse identifikohen. Gjithashtu duhet të mirren parasysh nevojat për ndihmë të përkohshme/emergjente të cilat mund të paraqiten në momentin e realizimit të kthimit.

Paraqit strategjinë e projektit për çdo objektiv të regjistruar në Seksionin III A më lartë. Kjo duhet të përmbajë diskutimin e strategjisë së projektit, qasjen/metodologjinë dhe aktivitetet esenciale të çdo intervenimi. Posaçërisht, strategjia duhet të përshkruajë qasjen e cila do të shfrytëzohet për të identifikuar përfituesit.

Kur të përshkruhet strategjia e projektit, duhet të integrohen tri elementet në vijim.

Qasja multi-sektoriale: Nuk pritët që një OJQ të ketë nevojë ti adresohet të gjitha këtyre aspekteve në një projekt të vetëm, por në prezantimin e koncept dokumentit, OJQ-ja duhet të deklarojë se kush apo si mund të adresohen aspektet e tjera nga partnerët e tjerë. (shiko tekstin në katrorin në të djathtë.)

Partneritetet: Përshkruaj partneritetet e pritura me GPK-në, OJQ-të e tjera, organizatat, shoqatat, bizneset e sektorit privat dhe/ose institucionet qeveritare. Këtu duhet të përfshihet arsyetimi i marrëdhënies, aktivitetet të cilat duhet të zbatohen me partnerët (apo vetëm me një partner tjetër p.sh një OJQ bashkëvepruese partnere implementuese).

Korniza kohore: Në koncept dokument nuk është e nevojshme që të ofrohet ndonjë plan i hollësishëm mbi implementimin. Sidoqoftë, me rastin e përgatitjes së seksionit mbi Strategjinë e projektit të Koncept dokumentit, duhet të keni një ide të përgjithshme mbi atë se cilat aktivitete do të ndërmerren, korniza kohore, dhe nga kush.

Komponentët e projektit multi-sektorial

Strehimi/akomodimi.

Infrastruktura - nëse nuk është e mjaftueshme, çfarë masash të përkohshme do të nevojiten.

Mbijetesa ekonomike - punësimi, krijimi i të ardhurave, masat e egzistencës.

Shëndetësia, arsimimi dhe shërbimet e komunitetit - disponueshmëria dhe qasja në ndihmën shëndetësore dhe arsimim, si dhe qasja në shërbimet qytetare komunale, egzistenca/ nevoja për qendra të komunitetit

Dialogu ndëretnik, marrëdhëniet me komunitetin dhe projektet balancuese - aktivitetet të cilat në procesin e kthimit angazhojnë komunitetet lokale kthyes dhe ato pritëse.

Qëndrueshmëria

Përshkruaj se çka do të lë si rrjedhojë projekti me rastin e përfundimit të implementimit, dhe se si do të dëshmojë projekti se kjo është arritur. Përshkruaj se si projekti i propozuar do të adresojë nevojat multi-sektoriale të popullatës në kthim, në mënyrë që të arrihet qëndrueshmëria. Për shembull, një OJQ mund të zgjedh të jetë partnere me ndonjë OJQ tjetër në mënyrë që të përmbush vargun e nevojave për ndihmë. Përshkruaj përkrahjen financiare dhe format e tjera të përkrahjes që nevojiten për të vazhduar aktivitetet të cilat janë të ndërlidhura me projektin apo benefitet pas përfundimit të projektit.

IV. Kapaciteti organizativ (maksimum 1 faqe)

Shkurtimisht përshkruaj ekspertizën dhe përvojën e organizatës suaj në fushat/sektoret e propozuara të intervenimit. Kjo duhet të përfshijë përvojën tuaj në Kosovë dhe me përfituesit e synuar.

V. Resurset financiare (maksimum 1 paragraf)

Shkurtimisht deklaro resurset financiare dhe të tjera të cilat nevojiten për të ndërmarrur këtë projekt. Nuk është e nevojshme që të ofrohet ndonjë buxhet i hollësishëm, por një tregues mbi nivelin e financimit të nevojitur. Është me rëndësi që në këtë seksion të shfaqen nevojat e financimit për secilin sektor që projekti i kthimit synon të adresoj dhe arsyetimin e tij.

Shtojca 5

Kriteret për konsiderimin e Koncept dokumenteve nga GPK-të

Listë kontrolluese

Të gjitha koncept dokumentet që miratohen nga GPK-të duhet të paraqesin qartë:

- Që projekti i përgjigjet ndonjë nevojë të identifikuar nga personat e zhvendosur (proces i bazuar në nevojë);
- Që procesi i propozuar i kthimit në Koncept dokument është i qëndrueshëm.

Identifikimi i problemit dhe demonstrimi i njohurisë

- ✓ Baza për vlerësimin e personave të zhvendosur është e besueshme dhe e bindshme.
- ✓ Përshkruhet angazhimi i mëparshëm me përfituesit.
- ✓ Problemi përshkruhet saktësisht: kush, çka, si, pse.
- ✓ Masat për të siguruar qëndrueshmërinë pasqyrohen qartë.
- ✓ Nevojat prioritare definojnë dhe arësyetohen.
- ✓ Paraqitet njohuria mbi ambientin: njohja dhe analiza e kthimit dhe integritit (p.sh. situata para luftës/para largimit, ambienti lokal i kthimit, pengesat materiale dhe të rrethanave, veglat për të tejkaluar sfidat e identifikuar).
- ✓ Përmledhen konsultimet e mëparshme me administratën lokale dhe partnerët relevant të përfshirë.
- ✓ Njohuri mbi aktivitetet e tjera të ndërlidhura të cilat kanë ndikim në rezultatin e projektit.

Përshkrimi i projektit

- ✓ Koncept dokumenti i propozuar është në përputhshmëri me Koncept dokumentin e UNMIK-ut mbi Kthimin e qëndrueshëm dhe me Manualin mbi kthimin e qëndrueshëm.
- ✓ Paraqitje e qartë që Koncept dokumenti është zhvilluar duke marrë parasysh angazhimin e plotë të përfituesve të procesit të kthimit.
- ✓ Strategjia e propozuar dhe qasja(et) drejtpërsëdrejti i adresohen nevojave të popullatës së synuar (komuniteteve pranuese dhe kthyes).
- ✓ Aktivitetet për të implementuar strategjinë projektohen dhe synohen mirë për të arritur objektivet e projektuara.
- ✓ Përshkruhet një qasje e besueshme e identifikimit të përfituesve dhe të përzgjedhjes.
- ✓ Objektivet janë të përshtatshme ndaj nevojave të popullatës së synuar.
- ✓ Rezultatet e pritura dhe ndikimi i parashikuar përshkruhen qartë.
- ✓ Përfshihet një strategji e besueshme për angazhimin e komuniteteve të afërta në dialog ndëretnik.
- ✓ Paraqitet një qasje efektive për arritjen e kthimit të qëndrueshëm.

Kapaciteti organizativ

- ✓ OJQ-ja (agjencioni) implementuese ka përvojën në fushat e intervenimit të propozuar në koncept dokument (jo medoemos në Kosovë, por në rrethana të ngjashme, p.sh. në Bosnjë, etj.).
- ✓ Statusi/marrëdhënia e organizatës në Kosovë mendohet të jetë pozitive dhe efektive, dhe është në gjendje të filloj aktivitetet e projektit në kohë të duhur.

Kapaciteti organizativ

- ✓ Buxheti i propozuar dëshmon të ketë kosto efektive me sa i përket rezultateve dhe aktiviteteve të propozuara. Vlerësimet në vijim do të shfrytëzohen për të matur efektivitetin e koston. Devijimi domethënës nga kostot e vlerësuara kërkojnë arësyetim të bindshëm.
 - Shpenzimet e rindërtimit të shtëpive për familje kushtojnë jo më tepër se 14,000 Euro (kostoja mesatare për rindërtim të gjithëmbarshtëm shtrihet ndërmjet 10,000-14,000 Euro)
 - Standardet e shtëpive të rindërtuara janë në përputhshmëri me Udhëzimet e rindërtimit të shtëpive
 - Projekti i krijimit të të ardhurave për familje nuk kushton më tepër se 2,000 Euro.
- ✓ Gjithashtu duhet të përfshihen vlerësimet e infrastrukturës dhe marrëdhëniet me komunitetin si komponentë të projektit. Kostoja efektive e këtyre inputeve do të matet kundrejt një mesatare të nxjerrur ndërmjet numrit të gjithëmbarshtëm të përfituesve dhe koston së përgjithshme të projektit.

Shtojca 6

Vlerësimi i rrezikut të vizitës për të përkrahur Vizitat shko dhe shiko apo Vizitat e lirisë së lëvizjes

1. **Hyrje.** Vlerësimi i rrezikut të vizitës (VRrV-ja) është një raport i shkurtër me shkrim i cili përgatitet për Grupin punues komunal (GPK-në) nga KFOR-i me përkrahjen e Policisë civile dhe organizatave të tjera sipas nevojës. VRrV-ja është e kufizuar vetëm në datën apo datat e caktuara në të cilat personat e zhvendosur do të vizitohen shtëpitë e tyre të mëparshme-ky është dallimi kryesor ndërmjet VRrV-së dhe Vlerësimit të sigurisë së fshatit që është më gjithëpërfshirës. Koha e cila nevojitet për të kryer hulumtimet e nevojshme dhe për të përgatitur Vlerësimin e rrezikut të vizitës në përgjithësi zgjat nga 1-3 ditë. KFOR-i ka rolin kryesor me rastin e përgatitjes së VRrV-së.
2. **Formati i raportit:** Duke shfrytëzuar formatin e skicuar më poshtë, VRrV-ja e përfunduar përbëhet nga shtatë pjesë. Përgatitet në formë të tregimit, apo në formën e "pyetjeve dhe përgjigjeve".
 - a. Informatat prijëse
 - Data(t) e vizitës dhe emri(at) i lokacionit(eve) që do të vizitohet.
 - Emërtimi dhe numri i telefonit të njësitit të KFOR-it që përgatit VRrV-në.
 - Emri i OJQ-së e cila organizon vizitën. Emri dhe numri i telefonit të personit kryesor nga OJQ-ja e cila është e përfshirë në vizitë.
 - Emrat, etnicitetet, dhe moshat e personave që marrin pjesë në vizitë.
 - Niveli i rrezikut pas zbatimit të të gjithë faktorëve zbutës-i lartë, i mesëm, i ulët
 - b. Lokacioni(et) që duhet vizituar
 - Cilat janë lokacionet specifike të cilat duhet të vizitohen (emri i qytetit, numrit të pikës kontrolluese, qendra e mbledhjes në rrjet koordinativ UTM)?
 - Sa larg (në kilometra) jeton popullata e personave të zhvendosur nga vendi i cili vizitohet?
 - A ka ndodhur diçka me rëndësi në fshat/lagje apo afër atij vendi gjatë luftës?
 - Çka ka ndodhur saktësisht (varreza masive, djegja e kishës, njerëz të zhdukur)?
 - A ekzistojnë rreziqe të njohura nga minat apo armatimet e pa eksploduar (të pastruara apo të papastruara) brenda 500 metrave nga vendi i cili është duke u vizituar? Kërko këto informata nga Qendra e aksionit ndaj minave e KFOR-it.
 - Nëse po, ku kanë qenë/janë të pozicionuara?
 - Nëse jo, deklaro "nuk ka rreziqe të njohura nga minat apo armatimet e paeksploduar.
 - c. Përgatitjet e udhëtimit për personat e zhvendosur
 - Nisja nga (emri i qytetit), largimi më (data/koha), udhëtimi zbatohet me anë të (mjeti i udhëtimit), arritja e përfaqësuar (koha). Qëndrimi në lokacion (numri i orëve apo ditëve).
 - Kush është duke shoqëruar personat e zhvendosur në lokacion (emri i organizatës).
 - d. Mjetet e komunikimit gjatë vizitës
 - Çfarë do të jetë mjeti primar dhe rezervë i komunikimit ndërmjet të gjitha automjeteve të cilat marrin pjesë në vizitë (radioja, telefoni mobil, etj.)? Këshillë: nëse shfrytëzohen radiot, të gjitha automjetet duhet të jenë në gjendje të komunikojnë me njëra tjetrën.

- e. Ngjarjet (për çdo ngjarje, ofro një përshkrim si dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit)
- A ekziston ndonjë ditë tregu në fshat/lagje?
 - A ekziston ndonjë ngjarje sportive në fshat/lagje?
 - A ekziston ndonjë ngjarje politike/kulturore e cila ndodh në fshat/lagje gjatë asaj dite?
 - Çfarëdo ngjarje të tjera të njohura?
- f. Qëndrimi i popullatës lokale. Para se njerëzit të cilët janë duke ndihmuar të përgatisin apo të mbledhin informata për Vlerësimin e rrezikut të angazhojnë drejtpërdrejtë popullatën e komunitetit pritës (p.sh. nëpërmjet intervistave), ju lutemi verifikoni tek Grupi punues komunal apo OJQ-ja e cila organizon vizitën për të përcaktuar çfarëdo ndjeshmëri të veçanta apo reskriksionesh të cilat mund të ekzistojnë. Po qe se ekzistojnë restriksionet, ato duhet të mbahen në nivel minimal pasi që mund të ndikojnë drejtpërdrejtë në vlefshmërinë e informatave të cilat mbledhen për të përkrahur procesin e vlerësimit të rrezikut.
- A e din UNHCR-i apo OJQ-ja se a ka pasur kontakte popullata lokale me ndonjë banor të mëparshëm të grupit etnik që merr pjesë në vizitë?
 - Cila ka qenë metoda dhe natyra e kontaktit (p.sh. telefonatat miqësore, apo VShSh-të armiqësore)?
 - Kur është vënë kontakti i fundit dhe cila ka qenë organizata e cila e ka organizuar atë?
 - A ka qenë dikush nga udhëheqësia lokale apo komunale në kontakt të drejtpërdrejtë me njerëzit të cilët janë caktuar të marrin pjesë në vizitë (po apo jo)?
 - Cila ka qenë natyra e kontaktit (p.sh. miqësore apo armiqësore)?
 - Si është vendosur kontakti (p.sh. nëpërmjet telefonatës, Vizitës shko dhe informo)?
 - Kur është vendosur kontakti i fundit dhe kush e ka organizuar?
 - Çfarë është qëndrimi i popullatës lokale ndaj kthimit të grupit etnik që merr pjesë në vizitë (përkrahës, kundërshtues, në përmirësim, degradues, neutral, i ndarë në baza partiake, etj.)
 - A është qyteti i ndarë në masë të konsiderueshme në drejtime politike (p.sh. PDK dhe LDK)? Nëse po, a ka kjo ndarje potencialin për të rezultuar në dhunë apo kërcënim përgjatë vizitës së personave të zhvendosur?
 - A ekziston ndonjë person specifik i shprehur nga popullata lokale i cili nuk duhet të kthehet? Po qe se ekziston kush dhe për çfarë arsye.
 - Cilat janë fshatrat/lagjet më të afërta me lokacionin e vizitës dhe etniciteti i tyre? (shënim: nëse distanca është më e vogël se 1 km, atëherë këto fshatra/lagje duhet të përfshihen në vlerësim).
 - Çfarë është qëndrimi i njerëzve të cilët jetojnë në fshatrat e afërta/lagjet ndaj kthimit?
- g. Çështjet apo brengat e tjera. Listo dhe diskuto çfarëdo çështje apo brenga shtesë të cilat nuk janë të mbuluara gjëtu në Vlerësimin e rrezikut të vizitës. Për çdo pikë, ofro rekomandime mbi atë se si mund të zgjidhet plotësisht apo të zbutet rreziku.

3. Vlerësimi i rrezikut. Pas mbledhjes dhe vlerësimit të të gjitha informatave të nevojshme, dhe pas zbatimit të zgjidhjeve apo masave lehtësuese në hapësirat problematike, përgatitësi duhet të ofroj një vlerësim të gjithëmbarsuem të rrezikut të mbetur.¹¹

Përgatitur nga MNB(E)

¹¹ Nëse VShSh-të janë duke u kryer në baza të rregullta, vetëm KFOR-i dhe Policia civile/SHPK-ja duhet të informohen, VRRV-ja e re mund të pritët vetëm nëse mendohet që ka ndryshuar situata.